

**Miratohet
rebalanci**
Buxhet
pensionistësh

Fq.4



**TRYEZË
E VARFËR**
Të ngopesh
me bukë
dhe patate

Fq.7



**Çaushesku
pak para
ekzeku-
timit**

Fq.18



Koha

www.koha.mk



**KOHA për
sport**

Fq.12-15

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3484 · e hënë, 15 tetor 2018

9°C | 23°C

15 DEN

EDITORIAL

**Avancime
kushtetuese
edhe për
bizneset
shqiptare**



Në ndryshimet e ardhshme kushtetuese do të duhej të përfshihen edhe disa çështje kryesore që lidhen me statusin e shqiptarëve në sferën e ekonomisë, si dhe me vendimmarrjen e tyre në këtë sferë, përfshirë bashkë me një sërë rregullativash që formalizojnë raportin në mes të investimeve...

Fq.2

RAJON

**Zgjedhjet e
parakohshme,
të pashma-
ngshme**

Fq.17

AKTUALE

**Ballkani
përmbytet
me dizelët
e vjetër të
Gjermanisë**

Fq.9



SOT DIHET FATI I MARRËVESHJES, TË PASIGURTA 80 VOTA

ME NJË KËMBË NË PARLAMENT



Se me të vërtetë VMRO nuk ka diskonim të mbështet ndryshimet kushtetuese, dëshmoi edhe hedhja poshtë e propozimeve të dy anëtarëve të Komiteti Ekzekutiv, të cilët kanë kërkuar të parashtrihen amendamente kushtetuese për Marrëveshjen e Prespës, si dhe Mickovski të bisedojë me Zaevin për amnistinë për deputetët e akuzuar për 27 prillin e përgjakshëm të vitit të kaluar

Fq.3

Industria në telashe, mungojnë punëtorët

Shkup, 14 tetor - Kompanitë në Maqedoni vitet e fundit në vazhdimësi ankohen se nuk mund të gjejnë fuqi punëtore të kualifikuar për nevojat e tyre. Mungojnë në terren punëtorë ndërtimorë në industrinë e tekstilit, si dhe saldatorë, vozitës, kuzhinierë, e kështu me radhë. Me fjalë të tjera, gati se nuk ekziston ndonjë degë industriale që i mungon fuqi punëtore e kualifikuar. Gjithashtu, edhe pagat më të lar-

ta që ofrojnë investitorët e huaj ka ndikuar që punëtorët të kalojnë në punë tek punëdhënësit që ofrojnë rroga më larta.

Njohësit e tregut të punës në vend thonë se ikja e punëtorëve cilësorë jashtë shtetit pas një rrogë më të madhe, mungesa e harmonizimit midis asaj çka ofron sistemi arsimor nga njëra anë, dhe nevojat e biznesit nga ana tjetër, janë vetëm disa nga arsytet pse...

Fq.5



EDITORIAL

AVANCIME KUSHTETUESE EDHE PËR BIZNESET SHQIPTARE



Emin AZEMI

Në ndryshimet e ardhshme kushtetuese do të duhej të përfshihen edhe disa çështje kryesore që lidhen me statusin e shqiptarëve në sferën e ekonomisë, si dhe me vendimarrjen e tyre në këtë sferë, përfshirë bashkë me një sërë rregullativash që formalizojnë raportin në mes të investimeve dhe tregut, në mes të kuadrove dhe kompanive, në mes të kompetencave të komunave dhe investimeve të diasporës, e kështu me radhë.

Tani siç qëndrojnë punët, bizneset shqiptare kanë shanse të vogla të jenë të barabartë me ato maqedonase, sidomos pas pavarësimit të të ashtuquajturave agjenci dhe inspektorate shtetërore, të cilat u bënë të pavarura vetëm për shkakun se në krye të disa ministrive përkatëse ishin kuadro shqiptarë. Politika maqedonase e asimilimit perfid kishte shpikur këtë formë të pavarësimit të agjencive (bie fjala, Agjencia e ushqimit dhe Veterinarisë dhe shumë të tjera), vetëm e vetëm që ministrat shqiptarë të mos kenë qasje në dallaveret që i bën makineria e burokratëve maqedonase në segmente të caktuara ku bëhet kontrolli, licencimi, aprovimi i produkteve.

Të dhënat nga terreni flasin për një ndërhyrje arbitrare në kompetencat e ministrave shqiptarë, duke shpikur lloj-lloj postesh zëvendëskryeminstresh dhe drejtorë agjencish, përmes të cilëve është bërë një 'bay pas' subordonimesh, me qëllim të shmangies elegante të ministrave shqiptarë. Politikën qeveritare të karakterit ekonomik, tash e disa vite kanalizohen sipas interesave të ngushta të një lobi politik, i udhëhequr nga politikanë e biznesmenë maqedonase, ku e kanë vështirë të kenë qasje politikanët dhe biznesmenët shqiptarë. Njëra prej ministrive që ka qenë në vazhdimësi e fokusuar nga këto lobe, e ku mbivendosija e kompetencave është bërë në emër të njëfarë koordinimi me zëvendëskryeminstri për Çështje ekonomike (që "rastësisht" qëllon të jetë biznesmen maqedonase), tash e 20 vite ka qenë ajo e Ekonomisë.

Ja disa nga sektorët që ishin nën mbikëqyrjen e kësaj ministrie, e që tani janë shkëputur dhe funksionojnë ose si të pavarur ose i janë bashkangjitur ministrive që udhëhiqen nga ministra maqedonase.

Sektori i tregtisë ndërkombëtare mbi importin e mallrave dhe shërbimeve, Doganat, Rezervat Shtetërore, të gjitha këto ishin nën kontrollin e Ministrisë së Ekonomisë, tani janë nën kontrollin e Ministrisë së Financave dhe Bujqësisë. Mjetet financiare për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme ishte në kompetencë të Ministrisë së Ekonomisë, kurse tani ka kaluar në kompetencë të zëvendëskryeminstri për Çështje ekonomike dhe Ministrisë së Financave. Po ashtu edhe IPA fondet ishin nën mbikëqyrje të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, tani i kanë kaluar institucioneve tjera. Mjetet financiare për mbështetjen e eksportit, ishin nën udhëheqjen e Ministrisë së Ekonomisë, kurse tani me këtë çështje merret Ministria e Financave. Shitja e kapitalit shtetëror, udhëhiqej nga Ministria e Ekonomisë, kurse tani - Ministria e Financave. Fusha e energjetikës menaxhohej nga Ministria e Ekonomisë, kurse tani janë zëvendëskryeminstri për Çështje ekonomike dhe Ministria e Financave që e thonë fjalën e fundit.

Mendim i përgjithshëm i komunitetit të biznesit është se ministrave shqiptarë nuk u ka munguar dija dhe profilizimi përkatës për të udhëhequr projekte të caktuara, por kjo është pamundësuar për shkak të "duarve të lidhura" që jo rrallë i kanë patur për të vendosur për projekte të rëndësishme. Ankesat e këtij komuniteti janë të shumta, kurse hartuesit e ndryshimeve të reja kushtetuese do të duhej të ulen një ditë të bukur me diell dhe bashkë me biznesmenët shqiptarë të hartojnë strategjinë e zhvillimit të ideve e projekteve me interes për komunitetin që i rrethon, duke e avancuar këtë strategji në normë kushtetuese.

Barazia duhet të jetë e prekshme, substanciale dhe sidomos aty ku luhet paraja.



METODA E RE E SOCIALDEMOKRATËVE

"Socialdemokracinë kosovare, e ushqen demonstrimi paqësorë, e jo 'shtyrja e proceseve'!

Në krejt historinë e socialdemokracisë europiane, PROTESTA PAQËSORE (e jo REVOLUCIONI!) ishte ajo LOKOMOTIVA kryesore që e 'ushqeu' NDRYSHIMIN e shoqërive me pretendime demokratike. Tash, Dardani paska 'shpikë' metodë të re...si 'SHTYRJA E PROCESEVE PARA!?'

E si doni me bë, Dardan frenimin e gjithë kësaj pabarazie, varfërie ekstreme, papunësie afrikane, krimi e korrupsioni ala latino amerikan? Si? Mos të lutem! Ti bile që i kupton më mirë se do bashibuzuka këto dukuri e fenomene sociale...Sot, në kohën e globalizimit, të shtypurve e vetmja armë impulsive e presionit, u ka mbetë PROTESTA PUBLIKE QYTETARE. Aferim! Socialdemokrat të Kosovës", shkruan në statusin e tij në Facebook, profesori universitar, Fadil Maloku.

ROSAT E THAÇIT DHE ROBERT COOPERIT

Është ajo barsolleta e vjetër e rosave që sëmuren dhe për t'i shpëtuar, fermeri dëgjon këshillat e një mjeku magjistar. E dëgjon kur i rekomandon që t'i nxjerrë rosat në ajër të freskët në netët me hënë të plotë, pastaj kur nuk funksionon kështu, që t'i lajë me ujë të vakët para se të dalë dielli, pastaj kur nuk funksionon as kjo t'i lajë me ujë të ftohtë para se të perëndojë dielli... dhe pastaj receta të tjera me radhë derisa fermeri t'i thotë: - Ti receta paske boll, por unë nuk kam më rosa për to.

Është recetë e mirë për diplomatë, në veçanti për ata që janë marrë me Kosovën dhe posaçërisht për Robert Cooper-in, ish-ndërmjetës i Bashkimit Evropian, që shkroi marrëveshjen historike mes Hashim Thaçit dhe Ivica Daçiçit, më 2013. Marrëveshja që aq e mirë dhe aq historike, sa që grupi socialist në Parlamentin Evropian nominoi Thaçin dhe Daçiçin për çmimin Nobel për paqe. Për fat të keq, rrethanat në terren qenë më kokëforte se marrëveshja historike për normalizim, dhe Thaçi me Daçiçin nuk e fituan çmimin Nobel për paqe. Rrethanat qenë po aq kokëforte, sa që nuk dëgjuan Thaçin se me këtë marrëveshje Serbia de facto e ka njohur Kosovën, Daçiçin se me këtë marrëveshje Serbia u rikthye në Kosovë dhe Robert Cooper-in se me këtë marrëveshje Serbia dhe Kosova normalizojnë marrëdhëniet e tyre.

Disa vjet pas kësaj marrëveshjeje fola në prani të Robert Cooper-it në një konferencë në Oxford, duke përsëritur pak a shumë gjërat që ia kisha thënë edhe më herët, se marrëveshja nuk do të funksiononte pa parime më të forta udhëheqëse, se nuk ka "normalizim" të këtyllë çfarë ai propozon dhe që madje, Serbia ka krijuar një avantazh të madh me Asociacionin e komunave serbe. Ai mohoi disa prej gjërave dhe pastaj mori një pozicion neutral, të ndërmjetësit: nëse palët janë dakorduar për një gjë të tillë, kush jam unë t'u them se e kanë gabim.

Në njërin anë kishte të drejtë; nëse Hashim Thaçi dhe e dërguara e tij Edita Tahiri pranonin me nënshkrim të tyre se Serbia ka të drejtë ta kontestojë pavarësinë e shpallur, pse duhet ta mbrojnë Kosovën prej tyre Robert Cooper-i?; shkruan në statusin e tij në FB, publicisti Veton Surroi.

MEDIA Citate

"ALEATI I VETËM I SHBA-ve ËSHTË DOLLARI"

Kryetari i Kuvendit të Madh Popullor të Turqisë, Binali Yildirim deklaroi se "SHBA-së të cilës në vazhdimësi po i pakësohen aleatët, tanimë e përqafojnë aleatin e fundit, dollarin. Aleati i vetëm i tyre është dollari". Yildirim në një fjalim në Takimin Koordinativ të Shoqatës Parlamentare të Organizatës së Bashkëpunimit Islamik (ISIPAB) të organizuar në Gjenevë të Zvicrës falënderoi shtetet anëtare të ISIPAB-it të cilat i ofruan mbështetje Turqisë pas tentativës për grusht shteti në Turqi. Duke rikujtuar se udhëheqësi i FETO-s ende është duke jetuar në shtetin Pensilvani të SHBA-ve, tha se "Në territorin e SHBA-ve ende edhe sot mund t'i vazhdojnë në rehati aktivitetet e tyre. Nuk është e kufizuar as me këtë, për fat të keq në më shumë se 160 shtete të botës vazhdojnë prezencën e tyre". Duke folur për luftën e brendshme në Siri që vazhdon tashmë 8 vite, ai tha se çmimin më të madh të kësaj lufte e kanë paguar shtetet fqinje si Turqia, Libani dhe Jordania.

"A ka ndonjë çmim të cilin e pagoi SHBA-ja? A ka ndonjë çmim që e paguan të tjerët? Nuk ka. Ne kemi hapur krahët për 3.5 milionë vëllezër tanë. Ne e ndajmë bukën me ta. Kemi shpenzuar 30 miliardë dollarë", tha Yildirim. Ai gjatë fjalimit të tij po ashtu rikujtoi se sirianët të cilët jetojnë në Turqi pas operacionit "Mburoja e Eufritit" dhe operacionit "Dega e Ullirit" kanë filluar të kthehen në vendet e tyre.

"Tani po përpiqemi që t'i largojmë terroristët në Munbixh. SHBA-ja po e zvarrit punën. Për fat të keq hapin hapësirë dhe u jep armë organizatave separatiste si PKK, YPG dhe PYD. Kur u themi përse e bëni këtë, ata na thonë se 'ne duhet të bashkëpunojmë me këtë organizatë terroriste për ta shkatërruar DEASH-in'. Ky nuk është partneritet strategjik, partneritet taktik. Kjo është një absurditet i plotë. Ku keni parë në botë që një organizatë terroriste shkatërrohet me një organizatë tjetër terroriste. A është e mundur një gjë e tillë? Çfarë do të bëni nesër për ta shkatërruar atë organizatë terroriste? Do të shpikni një organizatë tjetër terroriste?", tha ai. Sipas tij, "Sot SHBA-të dollarin i cili është në qarkullim ndërkombëtar po e përdorin si armë". Më tej Yildirim tha se "SHBA-së të cilës në vazhdimësi po i pakësohen aleatët, tanimë e përqafojnë aleatin e fundit, dollarin. Aleati i vetëm i tyre është dollari".

(Anadolu Agency, 14 tetor)

Se me të vërtetë VMRO nuk ka diskonim të mbështet ndryshimet kushtetuese, dëshmoi edhe hedhja poshtë e propozimeve të dy anëtarëve të Komiteti Ekzekutiv, të cilët kanë kërkuar të parashtrihen amendamente kushtetuese për Marrëveshjen e Prespës, si dhe Mickovski të bisedojë me Zaevin për amnistinë për deputetët e akuzuar për 27 prillin e përgjakshëm të vitit të kaluar

Koha

Fatos RUSHITI

Shkup, 14 tetor - Deputetët të respektuaj vullnetin e popullit në referendum. Lideri i VMRO-DPMNE, Hristijan Mickovski ka përsëritur kërkesën drejtuar deputetëve të opozitës që të mos i mbështesin sot (e hënë) ndryshimet kushtetuese të propozuara nga Qeveria e Maqedonisë javë më parë, ndërsa të miratuara të premtën pasdite nga Komisioni parlamentar për çështje kushtetuese.

Në takimin e së shtunës mbrëma të Komitetit Ekzekutiv të Partisë, Mickovski ka thënë se deputetët kanë përgjegjësi të punojnë dhe të veprojnë në pajtim me vullnetin e popullit të shprehur në referendumin e 30 shtatorit, ku nuk u arrit konsensusi për Marrëveshjen e Prespës. Se me të vërtetë VMRO nuk ka diskonim për të mbështet ndryshimet kushtetuese, dëshmoi edhe hedhja poshtë e propozimeve të dy anëtarëve të Komiteti Ekzekutiv, të cilët kanë kërkuar të parashtrihen amendamente kushtetuese. Kërkesa ishte që të garantohet gjuha maqedonase dhe identiteti, emri Maqedonia e Veriut të aplikohet menjëherë për praninë në NATO, ndërsa të shtyhet zbatimi i përdorimit të brendshëm deri në anëtarësim të vendit në Bashkimin Evropian. Nuk është miratuar as kërkesa që Mickovski të bisedojë me Zaevin për amnistinë për deputetët e akuzuar për 27 prillin e përgjakshëm të vitit të kaluar.

MICKOVSKI NUK HEQ DORË NGA ZGJEDHJE

"Edhe njëherë kujtoj se Qeveria, Parlamenti dhe secili deputet ka përgjegjësinë të punojë dhe të veprojnë në pajtim me vullnetin e popullit, ndërsa vullneti i popullit ishte i qartë dhe padyshim i shprehur në referendum", është shprehur Mickovski, ndërsa ka kërkuar sërish zgjedhje të parakohshme. "VMRO-DPMNE është kundër kësaj marrëveshje dhe ashtu do të mbetet. Burimi i krizës, e cila tani po ndodhë, nuk është marrëveshja e refuzuar me Greqinë, as edhe referendumi i dështuar, por vet Qeveria dhe Zoran

SOT DIHET FATI I MARRËVESHJES, TË PASIGURTA 80 VOTA



SHUMICA ME NJË KËMBË NË PARLAMENT

Zaev të cilët duhet të largohen që Maqedonia të fitojë", është shprehur më tej Mickovski.

Ndryshe, sot në rend dite në Parlament do të jenë ndryshimet kushtetuese, ndërkohë që merr vesh se shumicën i mungojnë edhe tri vota për të arrit numrin prej 80 deputetëve të nevojshëm për hapjen dhe ndryshimin e Kushtetutës. Të premtën pasdite, me dhjetë vota "për", shtatë "kundër" dhe asnjë abstenim, Komisioni parlamentar për çështje kushtetuese pas debatit dyditor, e ka miratuar propozimin e Qeverisë për qasje drejt ndryshimeve në Kushtetutë. Pas debatit, Komisioni i sollti dy konstatime: Komisioni e mbështet propozimin për qasje drejt ndryshimit të Kushtetutës të parashtruar nga Qeveria dhe i propozon Parlamentit në pajtim me nenin 131, paragrafi 1 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, të sjellë vendim për qasje drejt ndryshimit të Kushtetutës.

Kryetari i Parlamentit, Talat Xhaferi, ndërkohe u shpreh se në pajtim me nenin 131, paragrafi 1 i Kushtetutës, vendimin për qasje drejt ndryshimit të Kushtetutës e sjell Parlamenti me shumicë votash prej dy të tretash prej numrit të përgjithshëm të deputetëve. Ai sqaroi se të qaset drejt ndryshimit të Kushtetutës në seancën e cila duhet të mbahet sot dhe ku nevojitet shumicë prej dy të tretash.

Po të dielën ka folur edhe kryeministri Zoran Zaev, sipas të cilit, mbi 25 deputetë të opozitës janë të vetëdijshëm për përgjegjësinë dhe janë të gatshëm ta marrin përgjegjësinë.

"Në fund do të ndodhë akti i votimit. Është serioze përgjegjësi para së cilës ndodhemi dhe atë përgjegjësi duhet ta mbajmë dhe me të të jetojmë. Unë solla vendime dhe mora përgjegjësi. Unë jam i gatshëm të jetoj kështu apo ashtu me atë përgjegjësi", tha Zaev, duke u shprehur i gatshëm të bisedojë edhe me Mickovskin në drejtim të arritjes së një marrëveshje.

PENS I SHKRUAN ZAEVIT

Nënpresidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Majkell Pens, i ka dërguar letër kryetarit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë Zoran Zaev në të cilën shpreh bindje për mbështetjen e tij të vazhdueshme në këtë moment të rëndësishëm për vendin. Në letër, kumtoi pres shërbimi qeveritar, nënpresidenti Pens shkruan se ka pasur nder të takohet me kryeministrin Zaev më 20 shtator në Shtëpinë e Bardhë në Uashington dhe se e vlerëson mundësinë që bashkërisht të bisedojnë për zbatimin e marrëveshjes historike të Prespës me Republikën e Greqisë. Në letrën e tij nënpresidenti Pens e ka theksuar mirënjohjen e tij për lidhshirësinë



treguar në arritjen e marrëveshjes dhe thekson se 90 për qind e atyre që votuan në referendum e miratuan marrëveshjen e Prespës dhe me këtë e konfirmuan përkushtimin e madh për të ardhmen evropiane të Republikës së Maqedonisë.

"Shtetet e Bashkuara të Amerikës e ndajnë përkushtimin tuaj për siguri dhe stabilitet me të madh të rajonit. Jini të bindur se mbështetja ima e vazhdueshme në këtë moment të rëndësishëm për vendin tuaj", shkruan nënpresidenti i SHBA-së në letrën e tij deri te kryeministri Zaev, dhe thekson se në periudhën e ardhshme pret përfundim të mëtejshëm të miqësisë midis të dyja vendeve.

Në ndërkohë, një ditë para votimit në Parlament, ka folur edhe përfaqësuesja e lartë për Siguri dhe Politikë të Jashtme të Bashkimit Evropian, Federika Mogherini. Në një intervistë për MIA, Mogherini ka thënë se Marrëveshja e Prespës është rast unik për pajtim dhe mbyllje të kontestit dydekadësh mes Shkupit dhe Athinës dhe ky rast mund të mos përsëritet më.

"E kam pasur privilegjin të marr pjesë në firmosjen e Marrëveshjes mes kryeministrave Zoran Zaev dhe Aleksis Cipras në qershor pranë Liqenit të Prespës. Të dy palët treguan guxim politik, lidhshirësinë, përgjegjësi dhe punuan pa lodhje që t'i tejkalonin dallimet dhe problemet e vjetra dhe ta arrinin këtë marrëveshje historike të cilën tërë Evropa e përshëndeti. Tani ka procedura nacionale për implementimin e marrëveshjes që zhvillohen në të dy anët dhe kjo duhet të mbrohet dhe respektohet. I kuptoj ndjeshmëritë dhe praparinë historike komplekse të kontestit, si dhe brengat e shprehura. Kontesti nuk ka ekzistuar aq gjatë pa arsye, megjithatë siç u pamë në të kaluarën, sa më shumë kohë që kalon, aq më rëndësishëm të gjendet zgjidhje. Procesi negociues duhet të ketë qenë i dhimbshëm dhe rezultati është një kompromis. Por, është kompromis me të cilin me sukses plotësohen interesat kyçe të të dy palëve. Pozita jonë është e

qartë: BE-ja tërësisht e përkrahë marrëveshjen e arritur. Kjo është mundësi unike për pajtim të Ballkanit Perëndimor i cili mund të mos përsëritet. Shpresoj se të gjitha palët do ta kapin këtë moment dhe se do të sigurojnë të ardhme në BE për vendin, të ardhme të cilën gjithë kombi e shpreson me vite që të bëhet realitet", ka thënë Mogherini. Marrëveshja e arritur historike, ka vijuar më tej Mogherini, mund të kontribuojë për transformim të tërë rajonit të Ballkanit Perëndimor.

ZBATONI MARRËVESHJEN, NDRYSHE S'KA NATO DHE BE

"Nuk ka mundësi tjetër për të dy popujt përveç marrëveshjes së Prespës", ka deklaruar kryeministri grek Aleksis Tsipras në fjalimin e tij në Këshillin e Lartë të Partisë qeveritare Syriza vetëm një ditë para se Parlamenti i Maqedonia, të votojë për ndryshimet kushtetuese që kërkon kjo marrëveshje. "Marrëveshja e Prespës është një mundësi unike dhe e pazëvendësueshme për të dy popujt dhe për stabilitetin në Ballkan. Nëse fqinjët tanë nuk e aprovojnë atë, duhet të dinë, dhe unë them me siguri, se nuk ka alternativa të tjera", tha Tsipras. Në të njëjtën kohë, Tsipras i ka çuar mesazh të tërthortë, duke bërë të qartë se nuk ekziston ndonjë plan alternativ edhe aleatit të tij qeveritar, ministrit të Mbrojtjes, Panos Kamenos.

Ky i fundit në vizitën e tij në SHBA kishte parashtruar një plan të dytë në rast se dështon miratimi i marrëveshjes së Prespës, që parashikon një marrëveshjeje ushtarake midis Greqisë dhe gjithë fqinjëve të saj me qëllim krijimin e një barriere që do të ndalë depërtimin rus në Ballkan.

"Nëse nuk e ndryshojnë emrin e tyre kushtetues, dua të jem i qartë, edhe Greqia nuk do ta lejojë këtë. Nuk do të pranoj hyrjen e vendit fqinj në NATO, BE, ndonjë organizatë tjetër ndërkombëtare ose në ndonjë formë bashkëpunimi ushtarak me emrin kushtetues 'Republika e Maqedonisë', u shpreh Tsipras. Duke ju përgjigjur disa kritikave që përse e majta greke është kaq e lidhur me politikën e SHBA-së, Tsipras ka theksuar se Greqia ka kërkuar dhe ja ka arritur të këtë marrëdhënie të respektueshme reciproke me fuqitë e mëdha të rajonit dhe të botës, por nuk kërkon protektorë.

Në kuadër të zgjedhjeve të ardhshme për parlamentin evropian dhe atyre lokale në majin e 2019, Tsipras ka paralajmëruar grekët se nëse votojnë për konservatorët e Mitsotakis, në Evropë do të fitojë (Viktor) Orban, ndërsa programi i Demokracisë së Re që flirton me të djathtën ekstreme për Greqinë është tepër neoliberal dhe se partia e tij Syriza do t'i rezistojë këtij kanibalizmi social që ai parashikon.

PSP HETON EDHE KEQPËRDORIMET GJATË VITEVE 2001-2010

Larje parash përmes “Bankës Postare”

Shkup, 14 tetor - “Banka Postare” është hetimi i radhës të cilën Prokuroria Speciale Publike ka filluar ta procedojë. Për dallim nga rastet e detyrueshme që kryesisht lidheshin me veprimet e kundërligjshme të ish-funksionarëve nga periudha 2008-2015, PSP ka njoftuar se kjo lëndë lidhet me periudhë vjetore 2001-2010. Për keqpërdorim e detyrës zyrtare në rastin “Banka Postare”, dyshohen nëntë persona, duke filluar nga Kole Smillevski, Tome Glavçev, Ratko Dimitrovski, Vikica Popovski, Georgi Karatollis, Kiril Janevski, Zorančo Mitrovski, Risto Millov dhe Zllatko Gjorçev. Ndryshe për shkak të vjetërsimit të veprës, nga akuza janë liruar të dyshuarit Lubço Georgievski (ish-kryeministër), Marjan Gjorçev (ish-ministër i Bujqësisë) dhe Nikolla Gruovski (ish-kryeministër). Shuma e plotë e parave që është keqpërdorur në rastin “Banka Postare” arrin deri në 5 milionë euro. Në njoftimin zyrtar të PSP-së, thuhet se gjatë ditëve të para të vitit 2001, Georgievski si kryeministër, Gjorçev si zëvendëskryeministër dhe Gruovski si ministër i Financave, me qëllim kontrollimin e funksionimit faktit të “Bankës Postare”, kanë marrë pjesë në themelimin e kësaj bankës, ndonëse ka ekzistuar “Makedonska Banka”, si pronë shtetërore. Kësisoj, ato kanë ndikuar që në privatizim të marrin pjesë edhe persona juridik, të cilën ata i kanë zgjedhur - “Noell Eksport - Import” nga Koçani. Sipas hetimeve paraprake të PSP-së, pronarëve të këtyre firmave, Tome Glavçev dhe Ratko Dimitrovski, u është thënë se në themelimin e bankës nuk do të marrin pjesën me mjete të tyre, por me para që do ti sigurojnë nga kreditë. Qëllimi, siç thonë nga prokuroria speciale, ka qenë që themelimi i “Bankës Postare” të mos bëhet me mjete të të dyshuarve, por përmes burimeve tjera, që është në kundërshtim të Ligjit për banka.

Megjithë akuzat e PSP-së, pas dëgjimit të të dyshuarve, Gjykata Themelore e Shkupit nuk u ka shqiptuar paraburgim Tome Glavçev, Ratko Dimitrovskit dhe Kole Smillevskit, për të cilët PSP gjatë ditës së shtunë kërkoi shqiptimin kësaj mase të kujdesit. Gjykata Penale e Shkupit të dyshuarve në fjalë u ka marrë vetëm pasaportat, ndërkaq Tome Glavçevin dhe Ratko Dimitrovskini i ka obliguar të paraqiten çdo javë në gjykatë. (O.Xh)

QEVERIA E MIRATON, PARLAMENTI E RREZIKON REBALANCIN

BUXHET PENSIONISTËSH



Koha

Zejnulla VESELI

Shkup, 14 tetor - Së shpejti Rebalanci i buxhetit, që të shtunën u miratua nga Qeveria e Maqedonisë, pritet të diskutohet në seancën e Komisionit parlamentar për financa dhe buxhet. Sipas rregullores, seanca parashihet të zgjatë 10 ditë dhe atë 5 ditë deputetët anëtarë të Komisionit amë kanë të drejtë të diskutojnë pro apo kundër rebalancit dhe të paraqesin amendamentet e tyre, ndërkohë që pesë ditët tjera Komisioni do të shqyrtojë një për një amendamentet e dorëzuara, derisa ditën e fundit - parashihet se do të shqyrtohen ose jo të gjitha amendamentet, diskutimi mbyllet dhe rishikimi i buxheti i dorëzohet deputetëve të Parlamentit për miratim.

Përkundër paralajmërimeve të shumta nga ministri i Financave, Dragan Tevdovski, se për këtë vit nuk ka nevojë për rebalanc, pasi të hyrat në buxhet realizohen sipas parashikimeve, Qeveria e Maqedonisë të shtunën miratoi vendimin për rebalanc dhe i njëjti pasi të merr dritë jeshile nga Komisioni amë, deri më 15 nëntor duhet të miratohet edhe nga Parlamenti i Maqedonisë. Edhe me rishikimin e buxhetit, më shumë para do të shkojnë për Fondin e Sigurimeve Pensionale, Fondin për Sigurim Shëndetësor dhe Agjencinë për Punësim.

“Rishikimi i buxhetit ishte i patjetërsueshëm për shpërndarjen e mjeteve plotësuese për këto fonde që të mos kemi ndërprerje gjatë pagesave të pensioneve dhe që të mund qytetarët pa pengesa të marrin në kohë shërbimet mjekësore, si dhe të drejtën

Me rishikimit e buxhetit propozohet të zvogëlohen të hyrat për 1 miliard denarë, kurse shpenzimet për 1.2 miliard denarë. Ndryshimet dhe plotësimet e buxhetit planifikohen të jenë 192.5 miliard denarë në vend të parashikimeve të para prej 193.5 miliard denarë, ndërsa shpenzimet totale të jenë 210.5 miliard nga 211.7 miliard sa ishin parashikuar me buxhetin e vitit 2018. Megjithatë, rebalanci i miratuar dje varet nga rrjedhat e punës së Parlamentit, konkretisht nëse miratohen ndryshimet kushtetuese

e marrjes të ndihmave sociale dhe kompensim në të holla për kategorinë e personave të papunë. Qeveria procesin për ndryshimin dhe plotësimin e Buxhetit për vitin 2018 e inicioi në këtë periudhë për shkak përmbajtjes së afateve më pajtim me rregullativën ligjore për miratim në Parlament më 14 nëntor. Sidomos në rast se nuk sillet vendim për shpërbërjen e Parlamentit dhe shpalljen e zgjedhjeve të parakohshme”, thonë nga Qeveria.

Me rishikimit e buxhetit propozohet të zvogëlohen të hyrat për 1 miliard denarë, kurse shpenzimet për 1.2 miliard denarë. Ndryshimet dhe plotësimet e buxhetit planifikohen të jenë 192.5 miliard denarë në vend të parashikimeve të para prej 193.5 miliard denarë, ndërsa shpenzimet totale të

jenë 210.5 miliard nga 211.7 miliard sa ishin parashikuar me buxhetin e vitit 2018. “Në korniza buxhetore të planifikuara, rishikimi i deficitit do të jetë shumë më i ulët dhe atë 18.1 miliard denarë. Lidhur me Bruto Prodhimin Vendor, deficitit buxhetor mbetet i pandryshuar dhe është 2.7 për qind. Gjithashtu të hyrat në buxhet zvogëlohen për 0.5 për qind, gjegjësisht për 1 miliard denarë”, thonë nga Qeveria. Në kushte kur kemi të hyra të pandryshueshme në buxhetin kryesor, nga Qeveria shprehen se revidimi i projekteve të planifikuara në anën e hyrjeve në buxhet vjen si rezultat i zvogëlimit të hyrave ndaj shfrytëzuesve buxhetor në llogaritë e tyre individuale dhe realizimeve gjatë dy muajve të fundit të vitit, rritje e vogël e të hyrave sociale prej 1.5 për qind, gjegjësisht të njëjtit janë reviduar në nivelin prej 56.2 miliard denarë. Të hyrat sociale janë të hyra nga fondet për pension dhe shëndetësor dhe për Agjencinë për Punësim, për të cilat më parë mjetet ishin të planifikuara në nivelin prej 55.4 miliard denarë.

“Qeveria miratoi propozimin e Ministrisë së Financave që shpenzimet për vitin 2018 të zvogëlohen për 1.2 miliard, gjegjësisht për 0.5 për qind, kështu që pjesa me madhe e mjeteve të alokuara do të vijë midis shfrytëzuesve buxhetor, zvogëlimin e projekteve kapitale, tek të cilët kemi ngecje dinamike të realizimit, kryesisht projekte të financuara me kredi, si dhe zvogëlimin e shpenzimeve të kamatave për 897 milionë denarë për përforcimin e kapaciteteve financiare të komunave”, thonë nga Qeveria e Maqedonisë.

Mos e hidh ushqimin e tepërt, mund t’ua dhuroni të varfërve

Shkup, 14 tetor - Të gjithë qytetarët humanë dhe kompanitë mund të dhurojnë ushqim në suaza të aksionit “Ushqe 10.000” e cila do të mbahet më 16 tetor me rastin e Ditës Botërore për luftë kundër urisë, nga ora 10 deri në orën 19 në 33 lokacione në Shkup, Manastir, Kumanovë, Prilep, Strumicë, Radovish, Koçan dhe Vinicë. Qëllimi është të nxiten qytetarët të dhurojnë ushqim dhe ta ngritin nivelin e tyre të solidaritetit ndaj atyre që nuk kanë. “Në këto 33 lokacione qytetarët do të mund të dhu-

rojnë ushqim i cili do të jetë me kohë më të gjatë të afatit. Ushqimi do të vendoset në pako të cilat do të shpërndahen deri në kategoritë e ndryshme të qytetarëve të rrezikuar social në mbarë Maqedoninë”, theksoi sot në konferencën për shtyp Blazhe Josifovski, kryetar i Asociacionit “Eja Maqedoni”, i cili është udhëheqës i rrjetit “Site siti”, e cila përfshin mbi 30 organizata në mbarë Maqedoninë dhe punon në dhurimin e ushqimit. Potenco si rrjeti “Site siti” tani për tani disponon me data bazë

prej mbi 20.000 qytetarë të cilët u ndihmojnë në dhjetë qytete dhe shfaqja shpresë se do të dhurohen dhjetë tonë ushqim, që të mund të kënaqet një pjesë e nevojave mujore të qytetarëve. “Mbi 25 tonë ushqim arritëm t’i shpëtojmë, përkatësisht të mos hidhen këto muaj ose mbi 60.000 racione me ushqim. Kemi edhe ushqim organik të cilin pjesa më e madhe e qytetarëve nuk e kanë provuar, siç është qumështi nga bajamet... edhe ajo hidhet, sepse nuk është shitur”, shtoi Josifovski.

Rebalanci nuk ndikon në autostradën Shkup-Bllacë

Shkup, 14 tetor - Autostrada Shkup-Bllacë do të ndërtohet përmes Ndërmarrjes Publike për Rrugë Shtetërore (NPRR-SH) dhe Rebalanci i Buxhetit aspak nuk do të ndikojë mbi dinamikën e ndërtimit, sepse NPRRSH nga viti 2013 nuk është shfrytëzues buxhetor.

Këtë sot e theksoi ministri i Financave Dragan Tevdovski në përgjigjen e pyetjes në konferencën për shtyp në Qeveri për propozim-rebalancin

e Buxhetit për vitin 2018.

“Autostrada Shkup-Bllacë është një ndër prioritetet të cilat tentojmë t’i realizojmë si Qeveri. Për momentin përgatitet dokumentacioni teknik, ndërsa kërkua edhe financim për ndërtimin e autostradës nga ana e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim me çfarë i ndërmarrim të gjitha aktivitetet që të realizohet”, theksoi Tevdovski.

MUNGESË E HARMONIZIMIT TË TREGUT ME NEVOJAT

INDUSTRIA NË TELASHE, MUNGOJNË PUNËTORËT E KUALIFIKUAR

Kompanitë në Maqedoni vitet e fundit në vazhdimësi ankohen se nuk mund të gjejnë fuqi punëtore të kualifikuar për nevojat e tyre. Mungojnë në terren punëtorë ndërtimorë, punëtorë në industrinë e tekstilit, saldatorë, vozitës, kuzhinierë...



Koha

Fisnik PASHOLLI

Shkup, 14 tetor - Kompanitë në Maqedoni vitet e fundit në vazhdimësi ankohen se nuk mund të gjejnë fuqi punëtore të kualifikuar për nevojat e tyre. Mungojnë në terren punëtorë ndërtimorë në industrinë e tekstilit, si dhe saldatorë, vozitës, kuzhinierë, e kështu me radhë. Me fjalë të tjera, gati se nuk ekziston ndonjë degë industriale që i mungon fuqi punëtore e kualifikuar.

Gjithashtu, edhe pagat më të larta që ofrojnë investitorët e huaj ka ndikuar që punëtorët të kalojnë në punë tek punëdhënësit që ofrojnë rroga më larta.

Njohësit e tregut të punës në vend thonë se ikja e punëtorëve cilësorë jashtë shtetit pas një rrogë më të madhe, mungesa e harmonizimit midis asaj çka ofron sistemi arsimor nga njëra anë, dhe nevojat e biznesit nga ana tjetër, janë vetëm disa nga arsytet pse kompanitë kanë vështirësi të gjejnë fuqi punëtore të kualifikuar.

"Para tetë vitësh kishim 1200 punëtorë, ndërsa sot kemi 850 të punësuar, ndërsa në shpalljet tona për punë mungojnë të inte-

resuarit që do të angazhohen tek ne. Po përpqemi të plotësojmë kërkesat lidhur me pagat, megjithatë të rinjtë - të joshur nga tregimet për jetesën më të bukur jashtë shtetit, kërkojnë mënyrë që të ikin në BE. Gjithashtu, konkurrenca e jonë më e madhe jolojale janë fabrikat në Zonat e lira industriale që kanë fituar mbështetje të madhe nga shtetit dhe mund të ofrojnë paga më të larta, ndërsa ne dhe industria e tekstilit që punojmë, nuk mund rrisim më shumë pagat", thotë Naum Barzov, drejtor i fabrikës së këpucëve "Bargalla" nga Shtipi.

Nga ana tjetër, në fabrikat e tekstilit në Shtip thonë se përkundër transportit të paguar dhe pagave që janë rritur nga 12 mijë në 16 mijë denarë, megjithatë kanë problem të gjejnë punëtorë për nevojat e procesit të punës.

Konsulentët e biznesit thonë se Maqedonisë si shtet i nevojitet një zgjidhje afatgjate dhe e qëndrueshme e mungesës së fuqisë punëtore. "Na nevojitet një pro-

gram serioz ekonomik në nivel të zhvillimit afatgjatë të shtetit që do të tregojë se me çfarë kuadri disponojmë dhe nga dëshirojmë si shtet të lëvizim në aspektin ekonomik. Me fjalë të tjera, ky problem nuk mundet të zgjidhet lehtë dhe kërkon një qasje më serioze, ku një nga zgjidhjet janë edhe reformat serioze në arsim të mesëm dhe të lartë", thotë Rafajllovski.

Ndryshe, në Maqedoni mungojnë studimet afatgjate për nevojën e zanateve në tregun e punës. Anketa e Agjencisë për Punësim për kërkesat e shkathtë sive në tregun e Maqedonisë siguron tregues afatshkurtër të dobishëm për pritjet e punëdhënësve në lidhje me punësimet e reja dhe nevojat për shkathtësitë me të cilat duhet të disponojnë personat që të jenë konkurrues në tregun e punës. Sipas përfaqësuesve të sektorit të biznesit, studimet në tregun e punës për nevojën e profesioneve të ndryshme nuk janë të plota dhe u mungon qasja afatgjate e planifikimit.

Digjen mbi 12 hektarë pyll në Koçan

Koçan, 14 tetor - Më shumë se 12 hektarë pyll me pisha u janë djegur në hyrje të fshatit Presekë në Koçan, në shpatet e pyjeve të Osogovës.

Zjarri që shpërtheu mbrëmë ende nuk është shuar, ndërsa ekipet e zjarrfikësve përballesh me erë të fuqishme dhe terren të vështirë të arritshëm malor.

Sipas komandantit të Njësisë Territoriale të Zjarrfikësve, Blagoj Paunov, bëhet fjalë për zjarr të qëllimshëm për shkak të të cilit është shkaktuar dëm i madh material, ndërsa për të cilin janë njoftuar edhe organet hetuese dhe kompetente inspektuese.

Tetovë, për 9 muaj 13.268 gjoba

Tetovë, 14 tetor - Pjesëtarë të policisë nga Sektori për punë të Brendshme në Tetovë, në dhjetë muajt e kaluar të këtij viti, në rajonin më të gjerë të Tetovës gjithsej kanë zbuluar 13.268 kundërvajtje të ndryshme në komunikacion. Për shkak të kundërvajtjeve të konstatuara, nga komunikacioni janë përjashtuar 808 automjete, më shumë prej tyre me regjistrim të skaduar (646), ndërsa me defekte teknike janë kapur 157 automjete dhe me mbingarkesë 5. Në këtë periudhë, gjithashtu janë përjashtuar edhe 1911 vozitës, mes të cilëve 1009 kanë drejtuar automjete pa leje për vozitje, 722 vozitës fillestar, të cilët nuk u janë përmbajtur kufizimeve ligjore, 22 me ndalesë për vozitje, si dhe 49 me kategori jo adekuate të lejes për vozitje. Kundërvajtjet e konstatuara në këto 9 muaj në Tetovë dhe rrethinën e Tetovës janë rumbullakuar, gjegjësisht janë sanksionuar me 4731 mandate dhe 4337 urdhërpagesa për kundërvajtje, si dhe me 2085 paralajmërimë. Përveç kësaj, përkohësisht janë konfiskuar 389



leje për vozitje. Për një numër të shkelësve të rregullave në komunikacionit që numrin më të madh e përbëjnë motoçiklistët dhe këmbësorët, janë organizuar 11 ligjërata që kanë pasur të bëjnë me mesimin e rregullave në komunikacion. (U.H)

KRONIKË

Rrahje në Hasanbeg, katër të lënduar

Katër persona kanë marrë lëndime të lehta të shtunën mbrëma rreth orës 21.30 pasi që pas një aksidenti mes dy automjeteve në rrugën "Metodija Andonov Çento" në Shkup, ka ardhur deri te debati verbal dhe qërim i hesapeve fizike mes pjesëmarrësve. MPB informon se S.M.(51), S.M.(20) dhe K.M.(24), të gjithë nga Shkupi, derisa janë shtyrë pranë trotuarit të rrugës automjeti "Mercedes" me targa të Shkupit, pronësi e fjiut të tyre K.S.(33) nga Shkupi, është ndeshur me automjetin "Mercedes" me targa të Shkupit, të drejtuar nga B.M.(37) nga Shkupi, ndërsa bashkudhëtarë ishin dy fëmijë të moshës 16 dhe 12 vjet. Pas aksidentit ka ardhur deri te mosmarrëveshja verbale mes pjesëmarrësve.

Një person i panjohur, i cili është përfshirë në rrahjen, me shkop bejsbolli e ka goditur B.M. në kokë. Ai është dërguar në spitalin e përgjithshëm të qytetit "Shën Naum i Ohrit", ndërsa S.M., K.M. dhe S.M. me automjetin e Ndihmës së shpejtë janë dërguar në Qendrën urgjente pranë kompleksit të klinikave "Nëna Terezë" ku u janë konstatuar lëndimet trupore dhe janë lëshuar për kurim shtëpiak. Gjithashtu, është paraqitur se gjatë arritjes së nëpunësve policor dikush nga personat ka nxjerrë pistoletë dhe ka gjuajtur disa plumba, por gjatë kontrollit të personave dhe automjeteve nuk është gjetur armë. Ndërmerren masa për zbardhjen e plot të rastit.

Arrestohet kosovari me patentë greke të falsifikuar

Një banor pesëdhjetë e tetëvjeçar i Gjilanit, Kosovë, është arrestuar dje në vendkalimin Kufitar Aerodrom Shkup dhe i është dorëzuar inspektorit të Qendrës Rajonale për Punë Kufitare Veri për procedurë të mëtejshme për shkak të posedimit të patentë shoferit të falsifikuar grek. MPB informon se ai në orën 05.40 në Vendkalimin Kufitar Aerodrom Shkup në kontrollin e pasaportave ka dorëzuar dokument udhëtimi serb dhe patentë shoferi grek. Pas kontrolleve të kryera është konstatuar se patentë shoferi grek ka qenë i falsifikuar.

Gjobë për 25 vozitës pijanecë

Tek 25 vozitës nga gjithsej 188 prej tyre, policia zyrtare gjatë kontrollit të bërë dje në Shkup ka konfirmuar prani të alkoolit në gjak. Kontrolli është bërë nga Njësia për siguri të rrugëve në kuadër të Sektorit për Punë të Brendshme në Shkup. Nga MPB deklarohet se në lidhje me shkeljet e konstatuara të Ligjit për siguri në komunikacion dhe Ligjit për vetura, janë marrë 113 masa për vozitësit, 125 vozitës janë ç'kyçur nga komunikacioni, 19 vozitësve iu është marrë patenta e vozitjes për një kohë të caktuar. (O.XH)

Ligji i ri për Tatim Personal, i cili pritet të zbatohet nga janari i vitit 2019, i detyron të regjistrohen si tatimpagues të TVSH-së edhe qytetarët që realizojnë të hyra nga të drejtat autoriale, qytetarët që kanë të hyra nga kapitali si dividenda dhe të gjithë ata që kanë të realizuar të hyra nga shitja e pronave të patundshme. Megjithatë, janë ekspertët ekonomik ata që kundërshtojnë: "Nuk shkruan askund në ligj se të hyrat nga të drejtat autoriale janë lëndë qarkullimi vjetor, por bartës të së drejtës autoriale"

Koha Zejnulla VESELI

Shkup, 14 tetor - Nga 1 janari i vitit 2019 pritet të hyjë në fuqi Ligji i cili obligon qytetarët që kanë realizuar të hyra vjetore, përveç tatimit personal, të paguajnë dhe TVSH-në. Mirëpo, Ligji kështu i propozuar për ekspertët ekonomik është shumë i paqartë, sepse nuk precizon saktë se kush duhet të regjistrohet në Drejtorinë e të Hyrave Publike (DHP) apo cilët persona fizik duhet të regjistrohen si pagues të tatimit personal dhe pagues të TVSH-së. Profesori i ekonomisë, Marjan Petreski thotë se DHP-ja kërkon që deri në fund të këtij viti, të gjithë qytetarët që realizojnë të hyra edhe nga të drejta autoriale, të regjistrohen si obligues tatimor

EKSPERTËT KUNDËR TATIMIT PROGRESIV NGA VITI I ARDHSHËM

TË DREJTAT AUTORIALE NUK MUND TË TATIMOHEN



të TVSH-së edhe përkundër faktit se trajtimi tatimor me TVSH-në për marrëveshjet autoriale parqet problematikë të veçantë.

"Cilët persona fizik duhet të paguajnë TVSH dhe për cilat veprimtari, kjo duhet të përcaktohet me ligj. Vetëm kështu do të kemi mundësi reale të së drejtës tatimore për këtë kategori të tatimpaguesve, sidomos për marrëveshjet autoriale që paraqesin një problematikë të veçantë", thotë Petreski. Sipas tij, vite me radhë, ekspertët ekonomik kërkojnë që në mënyre precize të definohet se cila

kategori e njerëzve, përveç tatimit personal prej 10 për qind, obligohet të paguajë edhe TVSH sepse praktika e deritanishme tregon se të gjithë personat që kryejnë veprimtari të pavarur dhe realizojnë qarkullim vjetor mbi 1 milion denarë apo mbi 17 mijë euro.

"Kjo do të thotë se tatimpagues të TVSH-së, përveç tregtarëve individual që kryejnë veprimtari afariste nga vitit 2015, janë edhe anëtarët e Këshillave drejtues, Këshillat mbikëqyrës, si dhe qytetarët që japin me qira hapësirat

afariste për firmat", thotë profesori Petreski. Në anën tjetër, profesori i ekonomisë Borçe Smilevski është i mendimit se nëse DHP kërkon që edhe marrëveshjet autoriale t'i llogarit si veprimtari afariste, atëherë është mirë të jepet një definicion preciz nëse kryerja e të drejtës autoriale është qarkullim shërbimi në nivel vjetor.

"Ligji për TVSH-në thotë se tatimi i të hyrave nga të drejtat autoriale, patentave dhe licencave janë lëndë tatimore. Nuk shkruan askund në ligj se të hyrat nga të drejtat autoriale janë lëndë

qarkullimi vjetor, por bartës të së drejtës autoriale. Pra, nëse DHP kërkon të regjistrohen apo të kenë qasje në të hyrat e një personi fizik, duhet qartë të precizohet se për çka janë realizuar të hyrat nga e drejta autoriale. Nëse të hyrat janë realizuar nga të drejtat autoriale, duhet të shihet se qarkullimi i të hyrave janë të drejta autoriale apo jo, sepse marrëveshja autoriale është e drejtë e autorit dhe në asnjë mënyrë nuk paraqet qarkullim në aspektin e TVSH-së", thotë Smilevski.

Ai vlerëson se institucioni, i cili zbaton Ligjin për tatim, të ketë një integritet të mjaftueshëm për interpretimin e saktë të dispozitave ligjore. "Çdo transaksion që kryhet me kompensim, futet në termin e veprimtarisë afariste. Termi kompensim dhe të hyra kanë kuptime të njëjta, por dedikim të ndryshëm. Kompensimi është parakusht që një transaksion i caktuar të paraqitet si qarkullim dhe të hyjë në kategorinë e TVSH-së. Ndërkaq të hyrat determinohen si veprimtari afariste. Që një person fizik të futet në veprimtari afariste apo të kryejë qarkullim ditor, duhet patjetër të gjenerojë të hyra stabile në vazhdimësi duke krijuar kështu përfitime të vazhdueshme. Prandaj DHP duhet të këtë kujdes se si e definojnë këtë kategori të personave fizik", thotë Borçe Smilevski. Ndryshe të dhënat e fundit të DHP-së tregojnë se tre muaj para përfundimit të këtij viti kalendari, janë regjistruar 1600 persona fizik që deri më tani kanë realizuar të hyra mbi 1 milion denarë si tatimpagues të TVSH-së.

INDEKSI I KAPITALIT NJERËZOR NË MAQEDONI

Një fëmijë i sotëm, 53 për qind produktiv nesër

Të miturit në Maqedoni studiojnë 11.2 vjet, por dinë sikurse të mësojnë vetëm 6.8 vjet. reformat e deritanishme nuk e kanë transformuar mjaftueshëm sistemin arsimor për të ndihmuar shumicën e nxënësve që të arrijnë të paktën njohuritë bazë



cilësor dhe nëse është krejtësisht i shëndetshme. Në Maqedoni, IKNJ tek vajzat është më e lartë se tek djemtë, dmth. 0.55 krahasuar me 0.52 në një shkallë prej 0 deri në 1.

Indeksi i kapitalit njerëzor të Maqedonisë është më i ulët se mesatarja e rajonit. Fëmijët në Maqedoni, kur mbushin 18 vjeç, pritet të përfundojnë 11.2 vjet të arsimit parashkollor, fillor dhe të mesëm. Megjithatë, kur vitet e shkollimit janë të përshtatura sipas cilësisë së të mësuarit, kjo është ekuivalente me vetëm 6.8 vjet, që do të thotë se ka hendek prej 4.4 vitesh.

Në të vërtetë IKNJ thekson se një fëmijë i lindur sot në Maqedoni kur të rritet do të jetë produktiv 53 për qind nga ajo që mund të ishte nëse do të kishte arsimim të plotë dhe do të ishte krejtësisht i shëndetshëm. Sa i përket rezultateve shëndetësore, raporti tregon se 99 nga 100 fëmijë të lindur në Maqedoni përfundojnë deri në moshën 5 vjeç. "Vlera e indeksit, sidomos vlera e treguesve të arsimit tregojnë për marrjen e masa të menjëhershme. Duket se reformat e deritanishme nuk e kanë transformuar mjaftueshëm sistemin arsimor për

ADEMI: RAPORTI I BANKËS BOTËRORE DO TË ANALIZOHET HOLLËSISHT

Raporti i Bankës Botërore për gjendjen në arsimin e Maqedonisë hollësisht do të analizohet edhe me partnerët tanë ndërkombëtarë dhe me të gjitha palët e prekura në vend do të krijojmë politika për përmirësimin e gjendjes, ndërsa këtë tashmë edhe e bëjmë, porositi sot ministri i Arsimit dhe Shkencës Arbër Ademi. "Për ne janë të mirëseardhur çfarëdolloj raporti kredibil përmes të cilave e pasqyrojnë gjendjen reale në shtetin tonë dhe në sistemin tonë arsimor. Përmes tyre mund të shohim dhe të kemi fotografi të qartë deri ku jemi dhe nga ajo të varen politikat tona për përmirësimin e gjendjes në sistemin tonë arsimor, deklaroi Ademi në përgjigje në pyetjen gjatë manifestimit "Së bashku ndërtojmë ura" që sot realizohet në Guacën e parkut të qytetit në Shkup.

të ndihmuar shumicën e nxënësve që të arrijnë të paktën njohuritë bazë", theksoi Marco Mantovaneli, drejtor i Bankës Botërore në Maqedoni.

Një analizë e hollësishtme e të dhënave nga Programi i OECD për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve, është hapi i parë në përfshirjen e një diskutim serioz për veprimtarin dhe reformat e mundëshme të politikave publike të cilat në të vërtetë kanë për qëllim përmirësimin e rezultateve ar-

simore në Maqedoni. Është e rëndësishme që vendi të vazhdojë të marrë pjesë në vlerësimet ndërkombëtare të një shkalle të gjerë për të monitoruar cilësinë e sistemit arsimor. Aktualisht, Banka Botërore mbështet përpjekjet e Maqedonisë për të forcuar arsimin e mesëm teknik profesional dhe arsimin e lartë përmes Projektit për zhvillimin e aftësive dhe mbështetjen e inovacionit (me një hua në vlerë prej 24 milion dollarë).

Koha Remzije BILALLI

Shkup, 14 tetor - Të dhënat mbi Indeks të Kapitalit Njerëzor (IKNJ) të botuara nga Banka Botërore tregojnë se fëmijët e lindur në Maqedoni arrijnë 53 për qind të potencialit të tyre të kapitalit njerëzor kur rriten, krahasuar me atë që mund të arrijë nëse kanë arsim

TRYEZË E VARFËR E QYTETARËVE TË MAQEDONISË

TË NGOPESH ME BUKË DHE PATATE

Të dhënat statistikore tregojnë se 41 për qind e buxhetit mujor në Maqedoni ndahet për ushqim, e që është për dy herë e gjysmë më shumë sesa mesatarja e Bashkimit Evropian prej 15.6 për qind

Koha Fisnik PASHOLLI

Shkup, 14 tetor - Qytetarët e Maqedonisë më shumë konsumojnë bukë dhe perime, dhe më pak mish dhe peshk. Sipas publikimit të fundit të Entit të Statistikës, i ashtuquajtur "Konsumi i amvisërive në Maqedoni në vitin 2017", amvisëritë në Maqedoni mesatarisht konsumojnë 272 lloje të ndryshme të bukës, 90 kg miell dhe 21 kg makarona. Nga ana tjetër, konsumojnë edhe 103 kg patate, 26 kg oriz, 50 kg domate, 65 kg speca, 22 kg groshë, afër 38 kg lakër dhe 7 kg spinaq për person.

Nga artikujt e tjerë për konsum personal, sipas të dhënave për vitin 2017, janë konsumuar edhe 32 mish pule dhe 12 kg stek i pulës, 20 kg mish mëshqerre dhe 5 kg



mish viçi. Në konsumin e peshkut dominon ai më i liri - merluci me 17 kg në raport me 1.1 kg troftë me kosto më të shtrenjtë. Ekonomistët thotë se struktura e ushqimeve që më shpesh konsumohen në tryezat tona tregon edhe mirëqenien e ulët të qytetarëve në Maqedonisë. Njëherazi, në mesatare për person konsumohen edhe 98 litra qumësht, 51 litra jogurt dhe 18 litra kos, 22 kg djathë, 11 kg gjizë dhe 52 litra vaj.

Nga pemët konsumohen afër 40 kg mollë, afër 3 kg dardha, 17 kg rrush, 24 kg portokaj, 26 kg banane, 48 kg pjepër. Më pak konsu-

mohen pemët e tjera të shtrenjta si gështenjat me 900 gr, fiku i thatë me 600 gr, rushi i thatë me 200 gr, lajthitë me 200 gr.

Shumë pak konsumohet mjaltë dhe marmelatë me nga 2 kg dhe 300 gram për person. Çokollata konsumohen me nga 4.2 kg, ndërsa imitacioni i çokolletës me përmbajtje më të ulët të çokolletës apo krem-çokollata harxhohet me 2.7 kg për person. Harxhojmë edhe 8.3 kg kafe, 1.4 kg çaj, dhe vetëm nga 400 gr kafe instant dhe nga 200 gram kafe-kapuçinë si prodhime më të shtrenjta. Te pijet joalkoolike dominojnë

pijet e gazuara me 97 litra, uji me gaz 84, si dhe lëngjet e pemëve me 23 litra. Konsumohet edhe 153 kilogram duhan për kokë banori.

Nga ana tjetër, krahasimi se për çfarë i shpenzojnë paratë qytetarët e Maqedonisë në krahasim me mesataren e BE-së, tregon sesa më i varfër është një vend, aq më shumë shpenzon popullsia e saj për t'u ushqyer. Familjet në Maqedoni shpenzojnë gati gjysmën e buxhetit mujor për ushqime, ndërsa konsumatorët në vendet e BE-së mjaftohen me vetëm me 15.6 për qind të buxhetit për të plotësuar nevojat e tyre të përditshme e të

ushqyerit.

Të dhënat statistikore tregojnë se 41 për qind e buxhetit mujor në Maqedoni ndahet për ushqim, e që është për dy herë e gjysmë më shumë sesa mesatarja e Bashkimit Evropian prej 15.6 për qind.

Nga ana tjetër, në shekullin e 21, akoma 40 për qind e amvisërive në Maqedoni nuk janë të kyçur në kanalizim, ndërsa 20 për qind e amvisërive i derdhen ujërat e ndotur në gropat septike.

Analizat e Entit të Statistikës dhe Institutit për shëndet publik tregojnë se papastërtitë nga kuzhinat dhe banjat, derdhen lirish nga 12 për qind e shtëpive dhe banesave, ndërsa pa asnjë instalim të kanalizimit janë 7.4 për qind e amvisërive.

Gjithashtu, brengosës është fakti se vetëm 7 për qind e ujërave të ndotura pastrohen në sistemet bashkëkohore të kolektorëve para se të kthehen tek lumenjtë dhe liqenet, për dallim prej mesatares evropiane të pastrimit të 70 për qind të ujërave të ndotura. Njëherazi, 30 për qind e popullatës nuk posedojnë kompjuter, 40 për qind nuk kanë veturë në pronësinë e tyre, ndërsa 57 për qind e popullatës nuk kanë vajtur në stomatolog për shkak se nuk kanë mundësi materiale për diçka të tillë.

BUJQIT JAPIN ALARMIN PËR ÇMIMIN E ULËT BLERËS

"Këtë vit në Maqedoni për herë të parë ka prodhimtari të mjaftueshme të misrit për kënaqjen e nevojave vendore, por edhe misri e merr fatin e njëjtë si gruri. Nuk ka blerje, ndërsa atje ku ka, çmimi është 8 denarë për kilogram. Kjo do të thotë se deri për vitin e ri askush nuk do të mbjell misër", thotë kryetari i Lidhjes së Bujqve, Velo Tantarov

N'mot do mbesim pa misër dhe grurë



narë siç ka premtuar para dy muajve Ministria e Bujqësisë.

"Këtë vit në Maqedoni për herë të parë ka prodhimtari të mjaftueshme të misrit për kënaqjen e nevojave vendore, por edhe misri e merr fatin e njëjtë si gruri. Nuk ka blerje, ndërsa atje ku ka, çmimi është 8 denarë për kilogram. Kjo do të thotë se deri për vitin e ri askush nuk do të mbjell misër", thotë kryetari i Lidhjes së Bujqve, Velo Tantarov. Sasia e misrit është

rreth 60 milionë kilogramë, ndërsa edhe cilësia, sipas Tantarov është e mirë. "Ku janë tani rezervat e mallrave? Konsiderojmë se çmimi i misrit duhet të jetë sa ajo e grurit, 12 denarë për kilogramë, që të mbulohe shpenzimet prodhuese", thotë kryetari i Lidhjes.

Tani për tani, tregon Tantarov, janë mbjellë edhe shumë pak sipërfaqe me misër. Mbjellja duhet të fillojë më 27 shtator, ndërsa të përfundojë deri më 25 tetor. "Askush

nuk mbjell grurë edhe pyetja është nëse sërish do të mbillet. Problemi, sërish është çmimi blerës i ulët. Le të gjejmë një bujk i cili ka marrë 10 denarë për kilogram, thekson Tantarov. Për mbjelljen thjesht nuk ka interesim sepse kërkojmë çmim me të cilin do të vlerësohet puna jonë, do të na mbetet diçka për jetë dhe do të kemi para për mbjelljen e re. Çmimi me 12 denarë për kilogram mund ta plotësojë, por me çmimin mesatar prej tetë denarë, rëndë", thekson Tantarov. Ai konfirmoi se gruri tashmë rrallë mund të gjendet dhe se pothuajse e gjitha është blerë dhe shitur. Më së shumti është eksportuar në Shqipëri dhe Greqi, sikur që tregoi javën e kaluar kryetari i Odës së Agrobiznesit, Ognen Orovcane.

"Nëse Maqedonisë i nevojitet bukë, askush nuk duhet të tregojë se në çfarë mënyre do të sigurohet buka dhe çfarë sjellje duhet të ketë shteti ndaj bukës. Çmimi i grurit mund të jetë edhe 15-20 denarë, por nuk është. Rëndë është të mbillet edhe krahas asaj që ka subvencione", i përpiktë është Tan-

tarov. Nga kapacitetet e fermave për kultivim intensiv të shtazëve thonë se misrin e Maqedonisë nuk e refuzojnë, por shumë më cilësor dhe më më i arritshëm është ai serb. Nga Serbia munden përnjëherë t'i furnizojnë sasi të nevojshme, ndërsa te ne duhet të blejmë nga një prodhues pesë ton, nga një tjetër dhjetë, nga i treti 20.

"Çmimi i misrit serb është 118-120 euro për një ton. Në mënyrë natyrale është tharë, ka vetëm 14 për qind lagështi dhe cilësi shumë të madhe. Gjithashtu, nuk ka kurrfarë problemi me aflatoksina. Neve na duhet edhe cilësia edhe çmimi sepse shpenzojmë nga 50-75 ton në javë, ndërsa misri ynë asnjëherë nuk ka pasur cilësi të mirë. Megjithatë, e blejmë prodhimtarinë tonë, nuk e refuzojmë, por nëse bëhet dallimi, ai serb është me ekstra cilësi. Kanë edhe rendimente prej 11 deri në 12 ton për hektarë pa kurrfarë problemi për shkak të sistemeve për ujitje "pikë për pikë", ndërsa te ne rendimenti është pesë deri në gjashtë ton", thonë kultivuesit e shtazëve.

Koha Qefser ABDYLI

Shkup, 14 tetor - Maqedonia për herë të parë ka misër të mjaftueshëm që t'i kënaq nevojat vendore, por çmimi blerës mesatar është shumë i ulët, 8 denarë për kilogram. Kjo, paralajmëronë bujqit, do të reflektohet në mbjelljen e vitit 2019. Thonë se edhe mbjellja e grurit është në pyetje për shkak të çmimit të ulët blerës që arriti 7.5 - 8 denarë, ndërsa jo 10.5 de-



REPUBLIKA E MAQEDONISË
MINISTRIA E FINANCEVE
DREJTORIA DOGANORE

Në bazë të nenit 22 dhe 23 nga Ligji për marrëdhënie pune Tekst i pastruar – ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 62/05, 106/08, 114/09, 130/09, 149/09, 50/10, 124/10, 47/11, 11/12, 39/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, 113/14, 20/15, 33/15, 72/15, 129/15, 27/16 dhe 120/18) v.v. sipas nenit 14, neni 22 paragrafi 1 alineja 2, paragrafi 3, paragrafi 8, paragrafi 13 dhe paragrafi 14 nga Ligji për të punësuarit në sektorin publik (Gazeta zyrtare e RM" nr. 27/2014, 199/2014, 27/2016 dhe 35/2018), Rregullorja për organizim dhe punë të Drejtorisë doganore numër 02-14736/1 të datës 06.10.2015, numër 04-065421/15-0012 të datës 21.06.2016 dhe 01-065421 të datës 09.07.2018, Rregullorja për sistematizimin e vendeve të punës në Drejtorinë doganore numër 02-14736/1 të datës 06.10.2015, numër 01-065421/15-0007 të datës 25.02.2016 dhe numri 01-065421/15-0013 të datës 21.06.2016 dhe njoftimi nga Ministria e financave num. 18-12226/12 nga 12.10.2018 viti, Drejtoria doganore shpall:

ANKAND PUBLIK nr. 3/2018

Për punësimin e 58 (pesëdhjetë e tetë) kryerës të punës me afat të caktuar të punës, për shkak të vëllimit përkohësisht të shtuar të punës, deri në fund të vitit rrjedhës fiskal (2018)

Drejtoria doganore shpall konkurs për punësimin e 58 (pesëdhjetë e tetë) kryerës të punës me afat të caktuar të punës (2018):

- Doganier i lartë në impiantin doganor Shkup 1 në doganën në Shkup - 6 punonjës (kryerës të punëve)
- Doganier në impiantin doganor Shkup 1 në doganën në Shkup. - 2 punonjës (kryerës të punëve)
- Doganier i lartë në impiantin doganor Shkup 2 në doganën në Shkup, 1 punonjës (kryerës të punëve)
- Doganier në impiantin doganor Shkup 3 në doganën në Shkup, -1 punonjës (kryerës të punëve)
- Doganier në drejtimin për qarkullim të udhëtarëve në impiantin doganor Aeroporti Aleksandri i Madh në Shkup në doganën Shkupi - 3 punonjës (kryerës të punëve)
- Doganier i lartë në drejtimin qarkullim i mallrave në impiantin doganor Aeroporti Aleksandri i Madh në Shkup në doganën në Shkup, - 1 punonjës (kryerës të punëve)
- Drejtim doganor qarkullim i mallit në impiantin doganor Aeroporti Aleksandri i Madh në Shkup në doganën në Shkup, - 1 punonjës (kryerës të punëve)
- Doganier i lartë në drejtimin qarkullim i mallrave në impiantin doganor Bllacë në doganën Shkupi -1 punonjës (kryerës të punëve)
- Drejtim doganor qarkullim i mallit në impiantin doganor Bllacë, -1 punonjës (kryerës të punëve)
- Drejtim doganor qarkullim i mallit në impiantin doganor Bllacë në doganën në Shkup, -3 punonjës (kryerës të punëve)
- Doganier i lartë në impiantin doganor në Tetovë në doganën në Shkup, - 1 punonjës (kryerës të punëve)
- Doganier në impiantin doganor Tetovë në doganën në Shkup, - 1 punonjës (kryerës të punëve)
- Doganier i lartë në drejtimin për qarkullimin e mallrave në impiantin doganor në autostradën Tabanovc në doganën në Kumanovë, - 2 punonjës (kryerës të punëve)
- Doganier në drejtimin për qarkullim të mallrave në impiantin doganor në autostradën Tabanovc në doganën në Kumanovë, -2 punonjës (kryerës të punëve)
- Doganier në drejtimin për qarkullim të udhëtarëve në impiantin doganor autostrada Tabanovc në doganën në Kumanovë, -2 punonjës (kryerës të punëve)
- Doganier i lartë në drejtimin për qarkullimin e mallrave në impiantin doganor Deve Bair në doganën në Kumanovë, - 2 punonjës (kryerës të punëve)
- Këshilltar i pavarur për mbikëqyrje doganore në shërbimin për mbikëqyrje të lejeve personave në doganën në Shtip, - 2 punonjës (kryerës të punëve)
- Doganier i lartë në impiantin doganor Shtip në doganën në Shtip, -1 punonjës (kryerës të punëve)
- Doganier i lartë në impiantin doganor Veles në doganën në Shtip, - 1 punonjës (kryerës të punëve)
- Doganier në drejtimin për qarkullim të mallrave në impiantin doganor Dellçevë në doganën në Shtip, - 1 punonjës (kryerës të punëve)
- Doganier në drejtimin për qarkullim të udhëtarëve në impiantin doganor, -1 punonjës (kryerës të punëve),
- Doganier në impiantin doganor SH Gjevgjeli në doganën në Gjevgjeli, -2 punonjës (kryerës të punëve),
- Doganier i lartë në impiantin doganor Gjevgjeli në doganën në Gjevgjeli, -3 punonjës (kryerës të punëve),
- Doganier në impiantin doganor Dojran në doganën në Gjevgjeli, - 1 punonjës (kryerës të punëve),
- Doganier i lartë në impiantin doganor Strumicë në doganën në Gjevgjeli, - 2 punonjës (kryerës të punëve),
- Doganier në impiantin doganor Strumicë në doganën në Gjevgjeli, - 1 punonjës (kryerës të punëve),
- Doganier i lartë në impiantin doganor Kavadar në doganën në Gjevgjeli, -1 punonjës (kryerës të punëve),
- Doganier i lartë në impiantin doganor Manastir në doganën në Manastir, -1 punonjës (kryerës të punëve),
- Doganier i lartë në drejtimin për kontrollimin e mallrave në impiantin doganor Mexhitlija në doganën në Manastir, - 2 punonjës (kryerës të punëve),
- Doganier në drejtimin për qarkullimin e udhëtarëve në impiantin doganor Mexhitlija në doganën në Manastir, - 2 punonjës (kryerës të punëve),
- Doganier i lartë në impiantin doganor Prilep në doganën në Manastir, - 1 punonjës (kryerës të punëve),
- Doganier i lartë në impiantin doganor Ohër në doganën në Manastir, -1 punonjës (kryerës të punëve),
- Doganier në impiantin doganor Aeroporti Shën Apostoll Pavle Ohër në doganën në Manastir, -1 punonjës (kryerës të punëve),
- Doganier i lartë në drejtimin për qarkullimin e mallrave në impiantin doganor Qafëthanë në doganën në Manastir, - 1 punonjës (kryerës të punëve),
- Udhëheqës i ndërrimit në drejtimin e qarkullimit të udhëtarëve në impiantin doganor Qafëthanë në doganën në Manastir, - 1 punonjës (kryerës të punëve),
- Doganier në impiantin doganor Shën Naum në doganën në Manastir, - 1 punonjës (kryerës të punëve),

Kushtet e përgjithshme për të gjitha vendet e punës:

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë
- në mënyrë aktive të përdor gjuhën maqedonase,
- të jetë i moshës madhore,
- të ketë aftësi të plota shëndetësore për vendin e punës dhe
- me akt vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë të kryerjes të profesionit, veprimtarisë apo detyrës

Kushte të veçanta për vendin e punës: Doganier i lartë

- niveli i kualifikimit: të ketë mbaruar VI B sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi të fituara sipas EKTS ose të ketë mbaruar shkallën e VII/1, Shkenca ekonomike, shkenca juridike, elektroteknike, makinerisë, shkenca organizative dhe të udhëheqjes (menaxhment), rregullimin dhe të udhëheqjes me proceset teknologjike, teknologjia e prodhimeve ushqimore dhe industria e tekstilit,
- njohja aktive e programeve kompjuterike për punë në zyrë dhe të njohjes aktive të njërës nga tri gjuhët që përdoren më shpesh në Bashkimin Evropian (gjuhën angleze, franceze, gjermane);
- pa përvojë pune.

Kushte të posaçme për vendin e punës: Doganier

- niveli i kualifikimeve: arsimim të lartë ose të mesëm profesional,
- njohja aktive e programeve kompjuterike për punë në zyrë dhe të njohjes aktive të njërës gjuhë të cilat më së shpeshti përdoren në Bashkimin Evropian (gjuhën angleze, franceze, gjermane);
- pa përvojë pune.

Kushte të posaçme për vendin e punës: Udhëheqës i ndërrimit (turnit)

- niveli i kualifikimit: të ketë mbaruar VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi të fituara sipas EKTS ose të ketë mbaruar shkallën e VII/1, shkenca ekonomike, shkenca juridike, elektroteknikë, makineri, shkenca organizative dhe udhëheqjes (menaxhment), rregullimi dhe udhëheqja me procese teknologjike, teknologjia e prodhimeve ushqimore dhe teknologjia e tekstilit,
- njohja aktive e programeve kompjuterike për punë në zyrë dhe të njohjes aktive të njërës gjuhë të cilat më së shpeshti përdoren në Bashkimin Evropian (gjuhën angleze, franceze, gjermane);
- së paku 2 vjet përvojë pune në punë doganore ose në profesion.

Kushte të posaçme (veçanta) për vendin e punës. Këshilltar i pavarur të mbikëqyrjes doganore

- niveli i kualifikimit: të ketë mbaruar VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi të fituara sipas EKTS ose të ketë mbaruar shkallën e VII/1, shkenca ekonomike, shkenca juridike, elektroteknikë, makineri, shkenca organizative dhe udhëheqjes (menaxhment), rregullimi dhe udhëheqja me procese teknologjike, teknologjia e prodhimeve ushqimore dhe teknologjia e tekstilit,
- njohja aktive e programeve kompjuterike për punë në zyrë dhe të njohjes aktive të njërës gjuhë të cilat më së shpeshti përdoren në Bashkimin Evropian (gjuhën angleze, franceze, gjermane);
- të ketë së paku tri vjet përvojë pune në punë doganore në profesion.

Është e nevojshme që kandidatët t'i dorëzojnë dokumentet në vijim:

- Dëshmi për shtetësinë;
- Dëshmi se nuk i është shqiptuar masë e ndalesës për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- Dëshmi Certifikatë- diplomë për shkallën e mbaruar të arimit; (me shkallën e shprehur të kualifikimit dhe mesataren e notave të marra për të gjitha vitet/të gjitha dëftesat me mesataren e paraqitur të notave të marra për të gjitha vitet)
- Dëshmi për njohjen e programeve kompjuterike për punë në zyrë;
- Dëshmi për njohje të njërës gjuhë e cila më së shpeshti përdoret në Bashkimin Evropian (gjuhën angleze, franceze, gjermane);
- Dëshmi për përvojë pune (pasqyrë e të dhënave të regjistruara në evidencën amë të dhënë nga fondi për sigurimin pensional dhe invalidor i Maqedonisë. – Kjo vlen vetëm për vendet e punës ku kërkohet përvojë pune)

Orari i punës: Orë pune gjatë javës: 40 orë,

Orari i punës: nga e hëna deri të premten prej orës 8,30 deri në ora 16,30

Shuma e neto pagës bazë për vendin e punës doganier i lartë – 23.196,00 denar, për vendin e punës këshilltar i pavarur – 32,526,00 denar dhe për vendin e punës udhëheqës i ndërrimit (turnit) – 33,536,00 denar

Me kandidatët e zgjedhur do të kontraktohet marrëveshje për punësim me afat të caktuar deri më datën 31.12.2018.

Kandidatët janë të detyruar të paraqesin fletëparaqitje (lutje) për cilin vend të punës paraqitet kandidati, biografi të shkurt dhe dëshmi për plotësimin e kushteve të përgjithshme dhe të posaçme për vendin e punës në origjinal apo kopje të vërtetuar te noteri.

Të drejtë të pjesëmarrjes kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Maqedonisë të cilët i përmbushin kushtet për të konkurruar. Kushtet e theksuara në shpalljen, kandidatët duhet t'i plotësojnë (përmbushin) në momentin e paraqitjes.

Afati për paraqitjen e lutjeve me dokumentet e nevojshme është 3 (tri) ditë pune të llogaritur nga dita e ardhshme nga dita e shpalljes të konkursit (duke mos e llogaritur ditën e shpalljes së konkursit), përkatësisht më së voni deri më datën 18.10.2018 (e ejnte).

Zgjedhja e kandidatëve do të bëhet në afatin e paraparë në bazë të nenit 23 paragrafi 2 nga Ligji për marrëdhënie pune.

Fletëparaqitja (lutja) me dokumentacionin e nevojshëm duhet të dorëzohet në arkivin e Drejtorisë doganore ose me anë të postës në adresën në vijim: Rr. "Llazar Liçenoski" nr.13, 1000 Shkup, Arkivi i Drejtorisë doganore (me shenjë "për konkursin për punësim nr. 3/2018"). Numri kontaktues 02 3166 188 Sektori për udhëheqje me resurse njerëzore pranë Drejtorisë doganore të RM.

Fletëparaqitjet (lutjet) të pa kompletuara dhe me vonesë nuk do të jenë lëndë e shqyrtimit (nuk merren parasysh).

Drejtori
Mr. Gjoko Tanasoski
Nr. 04-083201/18-0005
Shkup, 12.10.2018

Ku do të shkojnë dizelët e vjetër që në Gjermani nuk po gjejnë më blerës? Pse të mos hidhen sytë nga Ballkani, thonë disa? A do të kthehen vërtet këto vende në vendshkarkim makinash të vjetra?

Beograd, 14 tetor - Mikro qëndron në sheshin e një firme për makinat e përdorura "S-Auto" në Beograd, ai e di çfarë do: Një automjet dizel, me kosto të ulët riparimi dhe që shpenzon pak naftë. Debatin për dizelin në Gjermani ai e ndjek me shumë vëmendje.

"E kam dëgjuar këtë dhe kam pritur që të ulen çmimet tek ne, por kjo nuk ka ndodhur deri tani. Kam qenë i duruar, kam ndjekur me vëmendje zhvillimet pas vendimit të gjermanëve, dhe kam pritur që të kemi një fluks makinash këtu. Por nuk shoh që çmimet të kenë rënë". Që në verën e kaluar mediat serbe njoftuan se do të vijin nga Gjermania rreth 300.000 automjete, raporton DW. Por kjo nuk ka ndodhur, kujton Biljana nga firma "S-Auto". "Automjetet tona vijnë nga Gjermania, Franca, Belgjika, Holanda, Zvicra. Ato blihen tek ankandet e caktuara, dhe rreth 20-30% e automjeteve tona vijnë nga tregu gjerman i automjeteve të përdorura. Kryesisht janë makina dizel me motor të vogël, dhe vit prodhimi

BALLKANI PËRMBYTET ME DIZELËT E VJETËR TË GJERMANISË



2005-2008. Ne i shesim të gjithë automobilat, nga euro 3 deri tek euro 5 e euro 6".

Euro 3, 4, 5, 6- është norma minimale e lejuar e gazrave ndotës. Në Serbi lejohen automjetet e normës euro 3, por që janë prodhuar nga viti 2000. Milosh Petroviq, presidenti i Shoqatës së Importuesve Serbë të Automjeteve, thotë se "katastrofike është - e këtë e them qëllimisht - se automjetet e përdorura në masën 80% janë më të vjetra se 10 vjet, që në vitin 2017 janë impor-

tuar 153.000 automjete të përdorura në vend".

"Në vitin 2016 ishin 120.000. Nëse shohim një periudhë prej 5 vitesh, atëherë në Serbi kanë ardhur rreth 600.000 automjete që Evropa nuk i do më. Kjo është ajo që na dhemb ne si përfaqësues të produkteve moderne teknologjike - që Serbia - kjo është e shëmtuar, por e përshtatshme është kthyer në varrezë makinash", thotë ai. Edhe në Rumani një pjesë e madhe e automjeteve të përdorura vijnë nga Gjermania,

shumë më pak nga Italia apo Austria. Në vitin 2017 erdhën 300.000 automjete, 70% dizel. Roxana Dima, zëdhënëse e autoritetit të regjistrimit të automjeteve në Bukuresht, thotë se "nëse në Gjermani ndalen automjetet e normës Euro 4, kjo do të ketë ndikim në tregun rumun, sepse automjetet që i përgjigjen kësaj norme, përbëjnë një pjesë të madhe të makinave dizel në Rumani".

"Vendet e BE-së, si Gjermania, që kërkojnë rregulla më të rrepta

kontrolli të gazrave, duhet të kujdesen që këto makina të largohen nga qarkullimi, me qëllim që të pengohet edhe eksporti i automjeteve të tilla në Evropën Juglindore", thotë zëdhënësjja Dima. "Duke pasur parasysh fuqinë e dobët blerëse, tregu rumun i makinave do të përmbijet nga automobila që nuk i përkasin më standardeve gjermane, por që mbeten në qarkullim. Aq më shumë që në Rumani nuk ka ndonjë tatim të veçantë për automobilat e vjetër ndotës të mjedisit". Edhe qeveria bullgare nuk e mbështet idenë që automjetet e vjetra që në BE nuk lejohen më për shkak të mosplotësimit të normave të gazrave ndotës të importohen në Bullgari. Ministri i Mjedisit, Neno Dimov, propozon që këto automjete të pajisen me software ndihmues për emetim të pakët të gazrave, e pastaj të vijin në Bullgari apo vendet fqinje. Ai thotë se rajoni nuk duhet të kthehet në "vendshkarkim për makina të vjetra" nga perëndimi.

Vitin e ardhshëm rifillon vendosja e orëmatësve të ujit



Tetovë, 14 tetor - Ndërmarrja Publike Komunale Tetova-Tetovë, paralajmëron vendosjen e ujëmatësve të rinj në qytet. Ky projekt do të rifillojë vitin e ardhshëm, ndërsa kishte filluar para disa viteve kur në qytet ishin vendosur 6000 matës për ujin e harxhuar.

Drejtori i kësaj ndërmarrje publike, Xhehal Ceka, thotë se qëllimi i këtij projekti është që uji të shfrytëzohet racionalisht, pasi deri më sot, siç tha ai, uji harxhohet në mënyrë joracionale ngase paguhet në mënyrë paushalle. Nga NPK-ja thonë se uji nga dy ujësjellësit e qytetit humbet nëpër qytet, për shkak të rrjetit të vjetëruar më shumë se 60 vjeçar. Ujësjellësi i vjetër nuk mund të plotë-

sonte kërkesat e qytetarëve edhe pse ka patur nga 250 deri në 400 litra ujë në sekondë.

"Kur ka mungesë të ujit në ujësjellësin e vjetër, kyçet ujësjellësi i ri me 200 litra ujë në sekondë. Nëse nuk ka keqpërdorime, edhe me sasinë e ujësjellësit të vjetër do të mund të furnizohet qyteti, por duke patur parasysh vjetërsinë e rrjetit dhe mënyrën joracionale të shfrytëzimit të ujit, kjo ka qenë e pamundur", tha Ceka. Në vitin 2014 ishin vendosur 5600 orëmatës, prej tyre 1600 digjital dhe kjo dinamikë e orëmatësve ishte premtuar se do të vazhdojë, por u ndërpre. Në ndërkohë, tashmë pritet të vendosen rreth 6000 orëmatës në pjesë të ndryshme të qytetit.

Edhe nga Qendra për Demokraci Ekologjike "Florozon", që merren me problematikën e ujit, thonë se Tetova është në mesin e qyteteve ku më së shumti uji harxhohet në mënyrë joracionale.

Ndryshe, qyteti i Tetovës ka një rrjet të vjetër të ujësjellësit më shumë se 60 vite. Sipas informacioneve zyrtare, ujësjellësi i parë për Tetovën është ndërtuar në vitin 1930 nga vendi i kaptazhit në afërsi të fshatit Shipkovicë me kapacitet prej 30 litra në sekondë.

Ujësjellësi i dytë për qytetin e Tetovës është ndërtuar në vitin 1956 në vendin e kaptazhit Kodra e Diellit në largësi prej 8 kilometra nga qyteti me kapacitet prej 36 litra në sekondë. Kaptazhi i tretë është ndërtuar në vitin 1966 në lokalitetin Kodra e Diellit me kapacitet prej 83 litra në sekondë. (U.H)

Publicitet

Në bazë të nenit 9-g të Ligjit për fluturime ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 14/2006, 24/2007, 103/2008, 67/2010, 24/2012, 80/2012, 155/2012, 42/2014, 97/2015, 152/2015, 27/2016, 31/2016 dhe 64/2018) dhe Vendimit për publikim të shpalljes publike për emërim të drejtorit të Agjencisë për fluturime civile (nr. 02-1504/1 të datës 01.10.2018) të sjellë nga Këshilli drejtues i Agjencisë për fluturime civile publikohet

SHPALLJE PUBLIKE Për zgjedhje të drejtorit të Agjencisë për fluturime civile

- I. Këshilli drejtues i Agjencisë për fluturime civile publikon shpallje publike për zgjedhje të drejtorit të Agjencisë për fluturime civile.
- II. Për drejtor të Agjencisë mund të zgjidhet personi i cili përmbushë kushtet në vijim, edhe atë:
 - 1) është shtetas i Republikës së Maqedonisë;
 - 2) në momentin e zgjedhjes me vendim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënim ose sanksion kundërvajtës ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
 - 3) ka arritur së paku 240 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar nga sfera e shkencave teknike, juridike ose ekonomike;
 - 4) ka minimum pesë vjet përvojë pune nga sfera e fluturimeve civile dhe së paku tre vjet përvojë pune në vend udhëheqës;
 - 5) posedon një prej certifikatave të njohura ndërkombëtarisht ose certifikatave për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet:
 - TOEFEL IBT së paku 74 pikë,
 - IELTS - së paku 6 pikë,
 - ILEC (Cambridge English: Legal) - së paku niveli B2,
 - FCE (Cambridge English: First) - të dhënë,
 - BULATS - së paku 60 pikë ose
 - APTIS - së paku niveli B2.

për çka duhet të parashtrijë:

1. Fletëparaqitje
2. Kopje të letërnjoftimit ose dokumentacionit të udhëtimit
3. Biografi.
4. Certifikatë të shtetësisë
5. Dëshmi se në momentin e zgjedhjes me vendim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënim ose sanksion kundërvajtës ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
6. Dëshmi se ka të arritura së paku 240 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 nga sfera e shkencave teknike, juridike ose ekonomike;
7. Dëshmi se ka minimum pesë vjet përvojë pune nga sfera e fluturimeve civile dhe së paku tri vjet përvojë pune në vend udhëheqës;
8. Dëshmi se posedon një prej certifikatave të njohura ndërkombëtarisht ose certifikatave për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet:
 - TOEFEL IBT së paku 74 pikë,
 - IELTS - së paku 6 pikë,
 - ILEC (Cambridge English: Legal) - së paku niveli B2,
 - FCE (Cambridge English: First) - të dhënë,
 - BULATS - së paku 60 pikë ose
 - APTIS - së paku niveli B2.

III. Afati për parashtrimin e fletëparaqitjeve me dokumentacion shoqëruar do të jetë pesë (5) ditë pune, duke llogaritur nga dita e parë e ardhshme e ditës së publikimit të shpalljes dhe parashtrihen në deri në Arkivin e Agjencisë për fluturime civile në adresën rr. "Dame Gruev nr. 1, 1000 Shkup, me shenjë "Deri te Këshilli Drejtuesi për Shpallje publike për zgjedhje dhe emërim të drejtorit të Agjencisë për fluturime civile", ndërsa në këndin e epërm të majtë do të shënohet "MOS HAP".

IV. Dokumentacioni i dorëzuar pas afatit dhe i pakompletuar nuk do të shqyrtohet.

V. Pas përfundimit të procedurës Këshilli drejtues do të sjellë Vendim për emërim të drejtorit të Agjencisë.

VI. Mandati i drejtorit është katër vjet me mundësi për edhe një mandat pas.

VII. Vetëm me kandidatin që do të zgjidhet dhe emërohet do të kërkohet të sillen dokumentet e nevojshme në original ose kopje të vërtetuar në noter.

Këshilli drejtues i Agjencisë për fluturime civile

Mileti dhe pseudo-retorika prej politikanësh!



Nga
Fadil LUSHI

Referendumin e paradokshëm konsultativ që u organizua në Republikën e Maqedonisë unë nuk e kuptova dot me tamam! Se ishte formë e shprehjes së mendimit të popullit për një çështje shtetërore e shoqërore me rëndësi të veçantë..., se ishte paradë mode..., se ishte një parakalim kalorësish të vonuar të lirisë së vatanit a edhe e patriotëve të heshtur..., se (nuk) ishte as peshk as mish..., se ishte tavë turlu a tavë Elbasani..., se ishte një dardhë që nuk u mor vesh se ç'bisht pati dhe në ç'pozitë e pati..., se ishte një referendum (anti)milet me brekë nëpër këmbë..., se ishte referendum me tapi partish politike (hiq mënjanë opozitën parlamentare)..., se ky referendum (nuk) e kishte kallëzuesin (e thjeshtë a të përbërë)..., se ku e kishte vendin kryefjala..., se ky referendum u përcoll a u ushqye me atë pseudo-retorikën e politikanëve njësi mendimesh, veprimesh dhe pikëpamjesh të ndryshme..., se ishte një referendum i bezdisshëm dhe i mërzitshëm..., se ishte një kampanjë për apo kundër referendumit, se ishte një fushatë më gjuhë të (pa)sinqertë, të pasinkronizuar dhe me ton a qëndrim agresiv, se ishte një shfaqje euforike a edhe një propagandë pompoze..., se votuesi a sovran (nuk) e meritoi këtë retorikë-virtuale, primitive dhe nacionaliste prej politikanësh të ashtuquajtur "zotërinj, efendinj, gospoda a edhe çavo"... , se ishte një gjullurdi fillimvjeshte..., se ishte një zgjim i vonuar i vetëdijes politike..., se ishte një lojë futbollit që më parë e kurdisur..., se ishte një lojë teatrale me personazhe tragjikomike dhe të dorës së dytë..., se ishte një karabina e ndërtuar në pronë të huaj..., se ishte një dasmë pa zakone, pa zot, pa daulle dhe pa krushqinë e dhëndrit..., se ishte një referendum ku nuk u mor vesh se kush piu uj në çezmën e dovetite kush e hëngri sapunin për djathë e shapin për sheqer..., se ishte trazim shpirtrash a e edhe fiqresh..., se ky referendum ishte si ajo meseleja e qerrexhiut që rrëmbeu nusen pa bërë as një copë rrugë..., se ky referendum ishte njësoj si ajo puna e berberit që të rruan pa lagur, ose hem të vë plak, hem të rruan mjekrën..., se ky referendum ishte aksham-pa-

zar politik..., se ishte si Ura e Gurit të Shkupit ku ca politikanë pro-lindje lozin kumar me ardhmërinë e "shtetit biblik"... e të tjerë, një dreq i mallkuar e mori vesh. Çështje e vërteta, unë që shkruaj këtë vështrim një gjë di se retorikës së partive politike si dhe kryeparëve të tyre, dedikuar referendumit, që në fillim iu anashkalluan dhe iu denigruan rregullat, parimet, stilet, mjetet, argumentet, provat bindëse, ajo forca e fjalës me vend dhe, së fundi, fryma humaniste si dhe emancipimi i institucionit-mendim ndryshe a edhe votë deliberative!

Ne, që ndërtuam paragrafin e mësipërm, do të bëjmë përpjekje që të mos i shtojmë e as të mos i heqim as një pikë a presje, jo pse (nuk) e qëlluan në shenjë, jo pse e shndërruam në një shkarravinë pa kurrfarë vlere, jo pse e shndërruam në një thes të mbushur me qymyr dushku, me kashtë dhe me lesh arapi, jo pse duam që për lexuesin ta bëjmë të kuptueshëm, jo pse duam ta kërkojmë zërin e arsyes së lexuesit tonë pa tarafe, po përkundrazi, dëshirojmë ta kuptojmë filozofinë dhe psiko-

logjinë e turmës në referendumin popullor-konsultativ pavarësisht se shumica votuan për, ca kundër, ca që bojkotuan dhe të tjerë që abstenuan për qejfin dhe inatin e tyre homerik! Në këtë referendum morën pjesë të gjithë ata që (nuk) kanë shtrirë këmbët në qymezin e këtij vendi ku mezi frymohet..., në të (nuk) morën pjesë të gjithë ata që flasin standardin dhe dialektet e shqipës, ata që llafosen shkinisht, ata që flenë shqip, shkinisht, turqisht dhe ca të tjerë evgjitërisht..., ata që (nuk) dërdëllisin jerm, para dhe pas shpinës..., ata që (nuk) pëshpëritin qosheve shqip, shkinisht, otomanisht e evgjitërisht, ata që (nuk) gënjejnë njëritjetrin politikisht, ata që (nuk) fusin duart në xhepin bosh të miletit, ata që (nuk) pështyjnë shqip, shkinisht dhe ca tjerë edhe turqisht, ata që (nuk) fyejnë njëritjetrin shqip, kaurisht dhe evgjitërisht..., ata që (nuk) shtiren si të sëmure për mend, ata që (nuk) sëmuren shqip, shkinisht, turqisht dhe ca të tjerë maxhupisht, ata që (nuk) sfidohen shqip, ata që herë pas herë kurohen sh-

Dikur moti kur ata kishin vendosur ta themelojnë qeverinë e tyre, që në fillim kishin rënë në siklet a në hall të madh. Këtë "rehati" të tyre e kishte prishur një peshkatar nga "liqeni ortak" i Ohrit, i cili kishte propozuar që të formohet flota detare. Mandatari i habitur tha: "Çka na duhet flota detare, tregtare, ushtarake dhe ajo e peshkimit, që ne nuk kemi detin!?"



qip..., ata që (nuk) urrejnë shqip, ca shkinisht e të tjerë "otomanisht"... , ata që (nuk) fantazojnë te-tovarçe, gostivarçe, dibrançe dhe strugançe për një... toptan shqip, ata që (nuk) shumohen shqip..., ata që (nuk) emocionohen shqip..., ata që nuk çoroditen shqip..., ata që (nuk) inatosen "halis arnavutçe"... , ata që (nuk) marrosen, dëshpërohen e që (nuk) mpaken shqip..., ata që (nuk) bëjnë politikë shqip..., ata që (nuk) bëjnë turizëm shqip..., ata që synetohen shqip..., ata që luajnë kumar shqip, ata që (nuk) ëndërojnë shqip, ata që (nuk) moralizojnë shqip, që vjedhin bashkë shqip, maqedonisht dhe ca të tjerë nga pakica, ata që (nuk) premtajnë shqip, që rebelohen shqip, që çmendoheshqip, ata që (nuk) vishen e zhvishen fare shqip, ata që harrojnë maqedonisht dhe shqip, ata që (nuk) filozofojnë shqip, ata që (nuk) bëjnë analiza, vështrime, kolumna dhe editoriale boshe shqip (përfshi këtu edhe autorin e kësaj shkarravine), ata që (nuk) të lënë të rrugëtosh e të mendosh shqip, ata që (nuk) socializohen shqip dhe, në instancë të fundit,

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovasja lok.14 - përdhësë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e diel 14 tetor | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006
Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

asnjeri prej nesh hiç fare nuk sikletoset e nuk s(i)këllidiset shqip sa u përket punëve që nuk na bëjnë.

E gjithë kjo zallamahirreth referendumit konsultativ, i gjithë ky fjalor që u përdor për referendumin nga organizatori, e gjitha retorika dhe të gjithë mysafirët që i grishëm nga Avropa dhe i gjithë ky rrëmujëmadh i pandreqshëm, mua m'i kujton dy mesele. E para: Mitro Çelo nga Tirana, dikur në një shkrim kishte parashtruar këtë barsoletë: "Para një ruleti, të kazinosë, qëndrojnë dy mesoburra kumarxhinj. Mbjajnë fishat e fundit në dorë. Dilemë. Ku t'i vendosin? I pari parashtron pyetjen: Sa herë në javë bën seks me gruan? Katër herë. Tjetri thotë: Unë një herë më pak. Pasi mblodhën numrat, vendosën 7-tën. Zari qëndroi te zeroja. Njëri që kinse bënte seks me mushama tha: Do të kishim fituar po të mos kishim gënjer!"...Dhe, e dyta, ky referendum toptan m'i sjell në mendje maqedonasitme moshë të shkuar, të cilët sot e gjithë ditën e Perëndisë, me shumë dashuri dhe me nostalgji, parapëlqejnëta lakojnë një barsoletë të tyre gjysmëshekullore. Dikur moti kur ata kishin vendosur ta themelojnë qeverinë e tyre, që në fillim kishin rënë në siklet a në hall të madh. Këtë "rehati" të tyre e kishte prishur një peshkatar nga "liqeni ortak" i Ohrit, i cili kishte propozuar që të formohet flota detare. Mandatari i habitur tha: "Çka na duhet flota detare, tregtare, ushtarake dhe ajo e peshkimit, që ne nuk kemi detin!?"

Një deputet shakaxhi, kishte kundërshtuar mendimin e mandatarit të harlisur, duke thënë: paçka se ne kemi Ministrinë e Kulturës, kur nuk kemi kulturë shëndetësore, muzikore e gjuhësore..., paçka se ne kemi Ministrinë e Financave kur lekë nuk kemi..., paçka se ne kemi Ministrinë e Transportit dhe Lidhjeve kur nuk i kemi rrugët si të shteteve përreth nesh..., paçka se ne kemi Ministrinë e Arsimit kur nuk e kemi me tamam shkollën tonë e nuk kemi mësuesin..., paçka se ne kemi Ministrinë e Drejtësisë kur drejtësia nuk është me ne, paçka se ne kemi Ministrinë e Ekonomisë kur nuk kemi ekonomi shtëpiake..., paçka se ne kemi Republikën e Maqedonisë, kishën e gjuhën, kur ato toptan nuk janë as për dynja e as për ahiret..., paçka se ne harxhuam kohë dhe para për referendumin..., paçka se dikur gruaja e babait tim, më thoshte: "Të ka nëna ty kapedan", kur unë sot e gjithë ditën e Perëndisë, mbeta tetar me gradë, e tjera paçka, paçka!

Të nderuar lexues, do të më ndjeni nëse unë në këtë "shkarravinë ju gënjeva", ju dëshpërova a edhe ju bezdisa me referendumin që u organizua në mëhallën e "rahmetli" Haxhi babës sonë!

Londra, parajsja për pastrimin e parave

Kur Britania e mohon se po pastron paratë e botës, është njësoj si kur Rusia mohon që helmon spiunë. Nuk i beson njeri. Po të shkoj në bankë tani e të kërkoj të depozitoj 55 milionë sterlina, do të më thonë të kontaktoj menaxherin, ndoshta edhe me policinë. Por nëse i lëviz këto shifra nga ndonjë parajsë fiskale "offshore", duke blerë ndonjë apartament në Belgravia, apo stolë në Uest End, do të më ofronin një vizë të klasit të artë e do të më nderonin me statusin e investorit të huaj. Kjo është "McMafia"! Le të plasim nga inati punëtorët e huaj e hidraulikët polakë.

Kam një farë simpatie për Zamira Haxhijevën, të cilës këtë javë iu hoq privatësia financiare nga Gjykata e Lartë. Bashkëshorti i saj, që është arrestuar në Azerbajxhan për mashtrim, u quajt nga avokati mbrojtës si "një bankier ndërkombëtar i llojit 'mace e shëndoshë", një term që përdorej dikur për të përshkruar politikanët e lartë e të përfshirë me njerëz të korrupuar. Ai e bëri me shpresën se kështu do ta prekte gjykatën.

Zamira ka dy prona që vlejné 25 milionë euro, si dhe ka shpenzuar mesatarisht 5000 euro në ditë te Harrods. Veç këtyre, ka një avion Gulfstream dhe një fushë golfi, të cilat gjenden në Guernsey dhe në Ishujt Virxhin të Britanisë. Haxhijeva ka të drejtë të protestojë e të thotë që është si çdo qytetare tjetër e shtresës së pasur, që ka jetuar historikisht në Najtsbrixh. Ky ishte urdhri i parë për shpjegim pasurie që është lëshuar nga qeveria. Me atë urdhër, ata i kërkojnë Haxhijevës të shpjegojë burimin e të ardhurave. Dyshimi është që mund të kenë ardhur nga banka e të shoqit. Avokatët e saj këmbëngulin, me të drejtë, se urdhri nuk duhet të nënkuptojë që ajo ka kryer shkelje ligji.

Para dy vitesh, kur u tha se do të zbatohet transparencja e parajsave fiskale, u hamendësua se synimi ishte të shmangej pastrimi i parave. Por u desh të ndodhte skandali i Panama Papers, në vitin 2016, që të kuptohej se deri në ç'pikë arrinte tregu i shmangies së taksave në vendet karaibiane. Kontrasti shihej në atë që ndodhi më pas. Persona nga Nju Jorku, që kishin shmangur taksat, u nxorën me pranga nga zyrrat e tyre. Gjermanët çuan 71 veta në gjyq. Spanjollët çuan edhe Lionel Mesin e Kristiano Ronaldon. Pakistanezët burgosën ish kryeministrin, dhe i dhanë jo pak, por 10 vite burg.



Për sa kohë që bankierët mund të fitojnë viza të klasit të parë, e për sa kohë që ishujt e largët të mbretërisë trajtohen me dorë të butë për ligjet mbi taksat, paratë e pista të botës do të vazhdojnë të trokasin në derën e Londrës. Nëse qeveritë refuzojnë të vendosin kufizime mbi pronat, e nëse nuk vendosin taksa realiste, paratë e pista do të vazhdojnë të vijnë



Në Britani u arrestuan vetëm katër veta dhe gjashtë u morën në pyetje. Zëvendës Drejtori i Zyrës së Taksave dhe Doganave, Richard Las, tha muajin e shkuar se anëtarët e pasur të komunitetit kalojnë shpesh pa u hetuar, pasi zyra e Taksave dhe e Doganave parapëlqen ta përdorë frikën e ndotjes së reputacionit për hetime të tjera private. Vërtet drejtësi republike bananesh.

Qeveritë kanë thënë gjithnjë se po të bëhesh vend pastrimi parash, nuk i bën dëm askujt. Britania vetëm sa përfiton dhe e quan si investim të huaj. Toni Bler dhe Devid Kamerun kanë mirëpritur haptazi oligarkët rusë, princa sauditë dhe biznesmenët nga Kina që kërkonin të blinin prona. Ekspertët thonë se paratë e pista "offshore" arrijnë deri

në 21 trilionë sterlina. 390 miliardë mendohet se janë lëvizur nga Rusia vetëm pas rënies së Murit të Berlinit. Ideja e shifrave të tilla i ka çoroditur ministrat britanikë, edhe pse buxheti nuk sheh asnjë qindarkë. Mund të mos jetë problem i Britanisë nëse vendet e tjera lejojnë t'u vidhet pasuria, por Britania kthehet në aksesort të kleptomaniisë më të madhe të shekullit. Si për autoritetet amerikane të taksave, ashtu dhe për njerëzit e thjeshtë nëpër rrugët e Moskës, Londra është kryeqyteti i oligarkëve, i veprimtarisë së "McMafias". Britani është në fakt përgjegjëse për 2/3 e parajsave fiskale të botës, kryesisht në vendet karaibiane. Ligjshmëria që ofrojnë nuk i pastron nga morali. Janë si piratë mesjetarë, një refuzim i hapur ndaj rendit ekonomik botëror. Një tjetër çështje është ajo e të qenit i drejtë. Manjati i pronave, Nik Kendi, i bëri një rivlerësim apartamentit të tij në Londër dhe arriti shifrën 160 milionë dollarë. Kjo tregon që në Londër vazhdojnë të vijnë para nga Rusia, Kina dhe vendet e Gjirit. Sipas llogaritjeve të fundit, në territorin e Londrës kanë hyrë rreth 35 miliardë para ruse. Edhe pse thuhet që ka mungesë shtëpish në tregun e pronave, ndërtesat kanë lejuar që rrugët të tëra në Uestminister, Kensington dhe Çelsi, të bëhen qytete fantazma. Ka plot shtëpi e blloqe banimi që rrinë bosh. Këto blerjet e pronave "sa për t'i pasur e për të ikur" kanë nisur të kenë një ndikim të errët në tregun e banesave. Si një person që ka jetuar gjithë jetën në Londër, më bezdis statusi si "qoshja e qejfit" për të gjithë botën. Dhe kryebashkiaku Sadik Kan rri po aq i patrazuar për këtë çështje sa dhe paraardhësi i tij, Boris Xhonson.

Vendet e tjera u kërkojnë të huajve që të paktën të paguajnë

taksa mbi të ardhurat dhe taksa prone. Oligarkët e Londrës paguajnë diku te 2000 sterlina në vit. Banorët e Manhatanit paguajnë tre deri në 10 herë më shumë. Në lagjet më të pasura u kërkohej pronarëve të huaj që të jenë zyrtarisht banorë. Qytete të tjera nëpër botë nuk i lejojnë të huajt të blejnë, të japin me qira apo të mbajnë një pronë të pabanuar. Mes këtyre qyteteve janë Berlioni, Singapori dhe Hong Kongu. Australia s'i lejon të sapoardhurit të blejnë prona në Sidnej apo Melburn, dhe nuk u janë dëmtuar ekonomitë nga këto masa. Sa për shmangien e pastër të taksave, ngaqë nuk janë banorë, kjo është diçka e pafalshme. Britania legalizon gjëra për të cilat amerikanët bëjnë burg.

A do të sjellin ndonjë ndryshim urdhrat për të shpjeguar pasuritë e pajustificuara? Është mëse e arsyeshme që një vend të përpiqet të mbajë larg hajdutët dhe mashtruesit. Por kjo s'ka vlerë nëse autoritetet nuk bëjnë gjë, përveçse të deklarojnë dikë, herë pas here, si të padëshiruar.

Për sa kohë që bankierët mund të fitojnë viza të klasit të parë, e për sa kohë që ishujt e largët të mbretërisë trajtohen me dorë të butë për ligjet mbi taksat, paratë e pista të botës do të vazhdojnë të trokasin në derën e Londrës. Nëse qeveritë refuzojnë të vendosin kufizime mbi pronat, e nëse nuk vendosin taksa realiste, paratë e pista do të vazhdojnë të vijnë. Tani kemi Brexit, e me të ndoshta do të kemi një eksod të investimeve të pastra. Të gjitha paratë, të pista e të pastra, mund të duken si lajm i mirë. Por a do vërtet Londra të kthehet në një tjetër Monako apo Makau? Një strehë për piraterinë fiskale, në mes të Europës? Nuk do të habitesha.

(The Guardian)

Nga
Simon JENKINGS



LUKAKU 'IA BËN ME SY' JUVENTUSIT

Sulmuesi i Manchester Unitedit, Romelu Lukaku ka thënë se Juventus është njëri prej klubeve më të mira në Evropë dhe e pranon se do t'i pëlqente një transferim në Serie A të ardhmen. "Juve tashmë ka një projekt të madh dhe po vazhdojnë ende. Çdo vit ata mundohen të bëhen më të mirë. Pa asnjë dyshim Juve është njëra prej dy-tre klubeve më të mira në Evropë. Ata kanë një trajner të madh në stol dhe lojtarë të jashtëzakonshëm në çdo pozicion", deklaroi Lukaku. Reprerentuesi belg u pyet edhe nëse do të ishte i interesuar që të kishte një përvojë në Serie A në të ardhmen. "Pse jo? Shpresoj që do të ndodhë", u shpreh ai.



Khaka kërkohet nga Newcastle

Mesfushori i kombëtares së Shqipërisë, Taulant Xhaka, mund të ndjek gjurmët e të vëllait, Granitit, pasi në janar mund të luajë në Premier League. Të paktën kështu raporton sot faqja "Newcastletoons", që shprehet se skuadra e Newcastle duhet të afrojë Taulant Xhakën. Skuadra e Premier League, ndodhet aktualisht në kushte të vështira në kampionat, pasi mungojnë kualitetet dhe cilësitë. Edhe pse ka një repart mesfushor me lojtarë të mirë, sërish mungon një emër që të bëjë diferencën në skuadër. Ndaj, siç raporton "Newcastletools", emri i mesfushorit të Bazelit dhe kombëtares së Shqipërisë, Taulant Xhaka, do të zgjidhte këtë problem. Ai do të formonte një dyshje të mirë me Jonjo Shelvey, duke i dhënë më shumë ritëm dhe efikasitet mesit të fushës së Newcastle. Taulant Xhaka është një emër i njohur në futbollin Evropian, jo vetëm sepse është i vëllai i Granit Xhakës, futbollistit që luan për Arsenalin dhe kombëtaren e Zvicrës. Taulanti aktualisht luan për Bazelin në Zvicër dhe për kombëtaren e Shqipërisë. Mesfushori 27-vjeçar ka bërë mbi 140 paraqitje me gjigantët zviceranë dhe është një nga lojtarët më të besueshëm të tyre. Taulanti është i njohur për futbollin agresiv në mes të fushës dhe gjithmonë i vendosur për të fituar dyluftimet. Një element tjetër që Xhaka do të sjellë në Newcastle është dhe përvoja e tij në Ligën e Kampionëve. Mesfushori ndërkombëtar i Shqipërisë, ka garuar shumë herë në Ligën e Kampionëve, dhe e di se çfarë duhet për të qenë konkurrenës në ekipet elitare të Evropës. Rafa Benitez ka nevojë për dikë që mund të konsolidojë talentin dhe inteligjencën e futbollit, duke krijuar një "çift" mes Shelvey dhe Xhakës.

MAQEDONIA SHËNON FITOREN E TRETË NË GRUPIN D

ANGELOVSKI: SHPRESOJMË TË VAZHDOJMË ME KËTË RITËM

"Jemi shumë afër që të arrijmë të ruajmë vendin e parë në grup. Ne do të vazhdojmë të luajmë me këtë ritëm, edhe ne Armeni do të japim maksimumin që të arrijmë fitore, por edhe në të gjitha takimin e radhës", deklaroi Igor Angelovski

Koha Fisnik NUHIU

Shkup, 14 tetor - Reprerentacioni i Maqedonia ka arritur të marr fitoren e tretë në tre ndeshjet e zhvilluara në Ligën e Kombeve. Në takimin e zhvilluar të shtunën në stadiumin "Filipi i Dytë", në Shkup, Maqedonia ishte më e suksesshme se Lihtenshtajni duke fituar me rezultatin e thellë 4:1. Golat për Maqedoninë u shënuan nga Trajkovski në minutën e 10 dhe të 30, ndërsa Pandev shënoi për 3:0 në minutën e 36. Mysafirët golin e vetëm të takimin e shënuar në minutën e 37 të pjesës së parë me anë të Jildiz. Në pjesën e dytë të përballjes, në minutën e 67 ishte Ezgjan Alioski që vulosi rezultatin përfundimtar 4:1. Trajneri i Maqedonisë, Igor Angelovski është i kënaqur me fito-



ren e tretë në grup, dhe se Maqedonia nuk do të ndalet këtu, por do të lufton që deri në fund ti fiton të gjitha ndeshjet. "Jam i lumtur për fitoren e arritur si dhe për futbollistët tanë. Jemi shumë afër që të arrijmë të ruajmë vendin e parë në grup. Ne do të vazhdojmë të luajmë me këtë ritëm, edhe ne Armeni do të japim maksimumin që të arrijmë fitore, por edhe në të gjitha takimin e radhës. Neve jemi duke u munduar që të bëjmë në rang më të mirë pasi kjo do të na shërbente për pozicionin e nde-

shjeve të plej-ofit në Ligën e Kombeve. E dimë të gjithë se si Maqedonia në të kaluarën kalonte me përfaqësuese të tilla. Por tani është ngritur niveli dhe kemi kualitet, me çka duhet të krenohemi", deklaroi trajneri Angelovski. Nga ana tjetër trajneri i Lihtenshtajnit, Rene Pauriç ka përgëzuar përfaqësuesen e Maqedonisë për fitoren e arritur dhe se ishin me meritore për këtë triumf. "Maqedonia ishte me kualitative se ne dhe me meritë arriti të fiton. I dinim forcat e tyre por nuk arritëm të bëjmë më të mirën për ti

ndaluar. Në pjesën e dytë ata ndaluan ritmin e lojës por edhe njëherë dëshmuar se janë më të mirë dhe për atë kryesojnë në grup. Neve na mbeten që të fokusohemi për takimin e radhës", deklaroi trajneri i Lihtenshtajnit, Rene Pauriç. Reprerentacioni i Maqedonia pas triumfit të shtunën ndaj Lihtenshtajnit, ata të dielën në mëngjes janë nisur drejt Erevanit, ku ditën e martë do të zhvillojnë takimin e katërt ndaj Armenisë. Maqedonia me 9 pikë maksimale kryeson bindshëm grupin 4 në Ligën 'D'.

Shkupi barazon në miqësoren me Borecin

Shkup, 14 tetor - Skuadra e FC Shkupi u ndal në barazim 2-2 ndaj skuadrës së Borecit nga Velesi, në takimin miqësor që u zhvillua ditën e shtunë në stadiumin e Çairit dhe në të cilin trajneri Umit Karan testoi të gjitha forcat e ekipit, duke përfshirë edhe futbollistët e rinj, të cilët ishin në fushë në pjesën e dytë të takimit. Fillimi i ndeshjes i takoi FC Shkupit, që në aksionin e parë më konkret në minutën e pestë shënoi golin e parë në këtë përballje, me anë të Blazhe Iljoskit. Me rezultatin 1:0 përfundoi pjesa e parë. Në fraksionin e dytë, trajneri Umit Karan vendosi që në terren të inkuadron tërësisht një ekip



tjetër, duke testuar të gjitha forcat nga shkolla FC Shkupit. Në aksionin e parë, pas rivënies nga këndi

nga Suhel Muharemi, në zonën e Borecit, reagoi në momentin e duhur Muharem Bajrami, i cili shë-

non për 2-0. Disa minuta më vonë, në anën tjetër, mysafirët zvogëllojnë epërsinë në 1-2. Skuadra e Shkupit pas pranimit të golit të parë pati edhe disa raste për gol po nuk i realizuan, kështu që skuadra nga Velesi në vazhdim të ndeshjes arriti që ta barazon shifrat në 2-2. Deri në fund të takimit kishim mundësi që të shohim edhe një tentim të Suhel Muharemit nga rivënia nga këndi, por që nuk arrin të mposht portierin mysafirë. Në fund, sfida miqësore u mbyll me barazim 2-2, në të cilin trajneri Umit Karan kishte mundësi që të shoh për afër edhe futbollistët e rinj të FC Shkupit.

“TRADHTARËT” E KOMBËTAREVE

Largimi i lojtarëve prej një përfaqësuese në drejtim të një tjetre nuk i ndodh vetëm Kosovës. Rastet e tilla janë të shumta në botën e futbollit. Njëri prej sulmuesve më të mirë të të gjitha kohërave - Alfredo di Stefano ka luajtur për tri përfaqësuese, ndërkohë që Diego Costa kishte braktisur Brazilin për Spanjën. Në mesin e këtyre futbollistëve gjendet edhe futbollisti shqiptar Arijan Ademi, i cili e kishte lënë Kroacinë për Maqedoninë

Lënia e një përfaqësuese të futbollit për një tjetër nuk është e pazakontë në botën e futbollit, madje ka mjaft raste të tilla. Përveç Kosovës, raste të tilla i kanë ndodhur edhe fuqive të futbollit si Brazili, Anglia e Kroacia. “Sky Sports” sjell disa prej tyre.

WILFRIED ZAHA (2 PARAQITJE PËR ANGLINË, 8 PARAQITJE PËR BREGUN E FILDISHTË)

Sulmuesi i Crystal Palacet, Zaha, ishte ftuar në ekipet e reja të Anglisë para se Roy Hodgson ta ftonte në ekipin e parë për një ndeshje miqësore ndaj Suedisë në nëntor të vitit 2012. Ai pati një paraqitje të shkurtër më pas edhe në fitoren 3:2 ndaj Skocisë, por ai nuk arriti që të paraqitej në një ndeshje garuese, kështu që Federata e Futbollit të Bregut të Fildishtë e shfrytëzoi rastin për ta rrëmbyer dhe ai shko në drejtim të tyre para Kupës së Kombeve të Afrikës në 2017-n, pavarësisht lutjeve të Gareth Southgatit.

NACER CHADLI (1 PARAQITJE PËR MAROKUN, 51 PARAQITJE PËR BELGJIKËN)

Falë luksit të të pasurit shtetësi të dyfishtë, Chadli që kishte lindur në Belgjikë ishte në një pozitë të rrallë për të zgjedhur shtetin për të cilin do të luajë dhe pas paraqitjeve të mira me Twenten, trajneri i Marokut Eric Gerets e ftoi sulmuesin në barazimin 1:1 në miqësoren ndaj Irlandës së Veriut në nëntor të 2010-s. Por pas vetëm 84 ditësh Chadli, i cili ishte transferuar te Monaco, bëri debutimin me vendin ku kishte lindur në një miqësore ndaj Finlandës. Ai ka mbetur pjesë e rëndësishme e ekipit të Roberto Martinezit dhe shënoi golin e fitores kur belgët fi-



• Arijan Ademi

tuan 3:2 ndaj Japonisë në minutat e fundit në të tetën e finales së Kupës së Botës në Rusi.

DIEGO COSTA (2 PARAQITJE PËR BRAZILIN, 24 PARAQITJE PËR SPANJËN)

Costa kishte shkaktuar zhurmë në Brazil kur kishte kërkuar leje nga Federata për të luajtur për Spanjën pasi e mori shtetësinë e këtij shteti në korrik të vitit 2013. Ai e kishte bërë para vetëm disa muajsh debutimin dhe kishte shpresa që ai të ishte pjesë e Brazilit për Kupën e Botës të vitit 2014. Kërkesa e tij u prit me përbuzje me Luis Felipe Scolari që tha: “Ai është duke ia kthyer shpinën endrës së milionave njerëzve për të përfaqësuar ekipin tonë kombëtar, pesë herë kampionin e botës në Brazil”. Costa nuk pati sukses me Spanjën dhe ishte vërshëlyer në Brazil, ndërsa arriti të shënojë tri herë në “Rusia 2018”.

ALFREDO DI STEFANO (6 PARAQITJE PËR ARGJENTINËN, 4 PARAQITJE PËR KOLUMBINË, 31 PARAQITJE PËR SPANJËN)

Legjenda e Real Madridit, Di Stefano e shijoi një karrierë ndërkombëtare të shkëlqyeshme, por edhe të çuditshme. Njëri prej sulmuesve më të mirë të viteve 50-a dhe 60-a, ka luajtur për River Platen, Millonarios dhe Real Madridin, ndërsa gjatë këtyre aventurave atij i është lejuar të luante për secilin shtet. I lirë nga rregullat moderne të FIFA-s, Di Stefano luajti për Argjentinën, për Kolumbinë dhe për Spanjën. Sidoqoftë, pas dështimit të Argjentinës për t'u kualifikuar në Botërorin e viteve 1950 dhe 1954 dhe moskualifikimit të Spanjës në Botërorin e vitit 1958, atij i është mohuar mundësia për të luajtur në këtë kompeticion.

ALEX BRUCE (2 PARAQITJE PËR IRLANDËN, 2 PARAQITJE PËR IRLANDËN E VERIUT)

Një veteran i kategorisë së dytë angleze, duke luajtur në 10 klube poshtë Premierligës, qendërbrojtësi mori vëmendjen e medieve në vitin 2011 pasi u largua nga përfaqësuesja e Republikës së Irlandës për Irlandën e Veriut. Kjo ndodhi për shkak të lidhjes së gjyshes së babait të tij dhe faktit se ishte paraqitur në vetëm një ndeshje miqësore për Irlandën. Atij i është dashur të priste deri në shkurt të 2013-s për të bërë paraqitjen e dytë ndërkombëtare, ndaj Maltës.

JERMAINE JONES (3 PARAQITJE PËR GJERMANINË, 69 PARAQITJE PËR SHBA-NË)

I lindur në Frankfurt nga një nënë gjermane dhe një baba afrikano-amerikan, Jones kaloi 15 vjetet e para të karrierës së tij në Gjermani, me një huazim të shkurtër te Blackburni në vitin 2011. Pavarësisht se ishte favoriti i tifozëve te Frankforti dhe i ekipit U-21 të Gjermanisë, ai deklaroi se është i lirë për SHBA-në në vitin 2009, për shkak se nuk bënte pjesë në planet e Joachim Lowit. Edhe pres mungoi në Kupën e Botës të vitit 2010 për shkak të një lëndimi, Jones ka hyrë në histori të ekipit amerikan duke realizuar një gol të bukur në barazimin ndaj Portugalisë në 2014-n. Mesfushori ishte zgjedhur si “Lojtari më i Mirë i Amerikës”, derisa përfunduan në vendin e katërt të Copa America Centenario, ndërsa vitet e fundit i kaloi duke bërë karrierë në ligën amerikane të futbollit.

JOSIP WEBER (3 PARAQITJE PËR KROACINË, 8 PARAQITJE PËR BELGJIKËN)

I lindur në Slavoniski Brod të Jugosllavisë, Weber bëri emër falë golave të realizuar gjatë tre vjetëve me klubin e vendlindjes, duke shënuar 130 gola në 240 ndeshje. Ai e vazhdoi këtë formë kur iu ba-

shkua Cercle Brugget në vitin 1988, duke shënuar edhe 136 gola në 204 ndeshje, por ishte vetëm gjatë gjysmës së rrugës së tij në Brugge kur ai u ftua nga Kroacia. Ai shënoi një herë në tri ndeshje miqësore në vitin 1992, por më pas u lejua që të luajë për Belgjikën për shkak të gjyshit belg dhe faktit që Kroacia nuk u pranua nga FIFA deri në vitin 1993. Weber ishte pjesë e skuadrës belge në Botërorin e vitit 1994 dhe gjithashtu shënoi pesë prej gjashtë golave të tij në arenën ndërkombëtare në fitoren 9:0 ndaj Zambisë në një miqësore.

ARIJAN ADEMI (3 PARAQITJE PËR KROACINË, 6 PARAQITJE PËR MAQEDONINË)

Pasi ishte paraqitur për Kroacinë në çdo ekip të të rinjve prej U-18 deri në U-21, paraqitja e parë për ekipin senior erdhi ndaj Koresë së Jugut në shkurt të vitit 2013 dhe më pas pasuan edhe dy ndeshje të tjera. Por, pasi Niko Kovac nuk e ftoi atë në Botëror të vitit 2014, Ademi, i cili është shqiptar nga Maqedonia, deklaroi që do të luajë për Maqedoninë. Pasi që ishte dënuar për katër vjet për shkak të dopingut, ai mbeti në Dinamo dhe është lejuar që të luajë gjatë 12 muajve të fundit.

HEINZ BARMETTLER (1 PARAQITJE PËR ZVICRËN, 11 PARAQITJE PËR REPUBLIKËN DOMINIKANE)

Së fundmi ishte parë duke luajtur për SC Freiburgun II, qendërbrojtësi Barmettler e bëri debutimin me Zvicrën në vitin 2009, derisa ishte në Zurich. Mbrojtësi ishte i rregullt në skuadrën U-21 gjatë periudhës 2006-2009, por pasi luajti 90 minuta në humbjen 1:0 ndaj Norvegjisë shërbimet e tij nuk u kërkuar më dhe në vitin 2012 ai e mori vendimin për të përfaqësuar shtetin e nënës së tij, Republikën Dominikane dhe më vonë u bë kapiten i ekipit.



• Wilfried Zaha



• Nacer Chadli



• Diego Costa



• Alfredo di Stefano



• Alex Bruce



• Jermaine Jones



• Josip Weber



• Heinz Barmettler

Në bazë të nenit 156, 157, 158, 159, 160 dhe 161 të Ligjit për mbrojtje shëndetësore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 43/12, 145/12, 87/13, 39/14, 43/14, 10/15, 154/15, 192/15, 17/16 dhe 37/16), nenit 22 dhe nenit 23 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 74 të datës 08.05.2015), nenit 20-g të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 27/14, 199/14 dhe 27/16), Pëlqimit për punësim nga Ministria e financave nr. 18-11834/2 të datës 08.10.2018, Vendimit për publikim të shpalljes publike nr. 03-2822/1 të datës 12.10.2018 nga U.D Drejtori i IPSH Institutit për shëndet publik i Republikës së Maqedonisë – Shkup publikohet

SHPALLJE PUBLIKE

për punësimin e 26 personave për kohë të pacaktuar

1. IPSH Institutit për shëndet publik e Republikës së Maqedonisë – Shkup ka nevojë për punësim të:

- 1.1 Ficzient i diplomuar ----- 2 realizues
- 1.2 Farmaceut i diplomuar ----- 2 realizues
- 1.3 Laborant me PLP ----- 1 realizues
- 1.4 Laborant me PMP ----- 4 realizues
- 1.5 Motra medicinale ----- 3 realizues
- 1.6 Inxhinier i diplomuar i teknologjisë ushqimore dhe bioteknologjisë ----- 1 realizues
- 1.7 Inxhinier i diplomuar i teknologjisë ushqimore dhe sigurisë së ushqimit ----- 1 realizues
- 1.8 Inxhinier i diplomuar i kimisë ----- 3 realizues
- 1.9 Doktor i diplomuar i medicinës veterinare ----- 1 realizues
- 1.10 Biolog i diplomuar ----- 1 realizues
- 1.11 Rrobalarëse ----- 1 realizues
- 1.12 Ekonomist me PMP ----- 1 realizues
- 1.13 Ekonomist i diplomuar ----- 2 realizues
- 1.14 Jurist i diplomuar ----- 2 realizues
- 1.15 Vozitës ----- 1 realizues

2. Kandidatët duhet ti plotësojnë **kushtet e përgjithshme** të vërtetuara me Ligjin për mbrojtje shëndetësore

- të jetë shtetas i RM,
- të jetë i moshës së rritur,
- të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore, dhe
- të mos je të shqiptuar me vendim të plotfuqishëm ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës

3. Përveç kushteve të përgjithshme të vërtetuara me ligji kandidatët duhet ti plotësojnë edhe kushtet e **posaçme në vijim:**

Për kandidatët nën pikën 1.1

- arsim sipëror të mbaruar me së paku 180 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar – FMN grupi fizikë, grupi fizikë-kimi

Për kandidatët nën pikën 1.2

- arsim sipëror të mbaruar me së paku 240 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar – Fakulteti i farmacisë

- licencë për punë
- me ose pa përvojë pune.

Për kandidatët nën pikën 1.3

- Shkollë e lartë e medicinës – laborant

- certifikatë për provim të dhënë profesional
- me ose pa përvojë pune.

Për kandidatët nën pikën 1.4

- arsim të mbaruar të mesëm profesional – laborant i medicinës

- provim të dhënë profesional
- me ose pa përvojë pune.

Për kandidatët nën pikën 1.5

- arsim të mbaruar të mesëm profesional – motër medicinale

- me ose pa përvojë pune.

Për kandidatët nën pikën 1.6

- arsim sipëror të mbaruar me së paku 240 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar – Fakulteti teknik-teknologjik – teknologjia ushqimore dhe bioteknologjia

- me ose pa përvojë pune.

Për kandidatët nën pikën 1.7

- arsim sipëror të mbaruar me së paku 180 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar – fakulteti për menaxhment dhe resurse ekologjike – siguria e ushqimit

- me ose pa përvojë pune.

Për kandidatët nën pikën 1.8

- arsim sipëror të mbaruar me së paku 240 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar – Fakulteti teknologjik, FMN – grupi kimi

- me ose pa përvojë pune.

Për kandidatët nën pikën 1.9

- arsim sipëror të mbaruar me së paku 240 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar – Fakulteti për mjekësi të veterinarisë

- me ose pa përvojë pune.

Për kandidatët nën pikën 1.10

- arsim sipëror të mbaruar me së paku 240 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar – FMN, drejtimi biokimi – fiziologji

- me ose pa përvojë pune.

Për kandidatët nën pikën 1.11

- arsim fillor të mbaruar

- me ose pa përvojë pune.

Për kandidatët nën pikën 1.12

- arsim të mesëm të mbaruar profesional – drejtimi ekonomik – juridik

- me ose pa përvojë pune.

Për kandidatët nën pikën 1.13

- arsim sipëror të mbaruar me së paku 180 kredi sipas SETK – Fakulteti ekonomik ose Fakulteti për turizëm dhe menaxhment.

- me ose pa përvojë pune.

Për kandidatët nën pikën 1.14

- arsim sipëror të mbaruar me së paku 180 kredi sipas SETK – Fakulteti juridik

- me ose pa përvojë pune.

Për kandidatët nën pikën 1.15

- arsim të mesëm të mbaruar

- leje të vozitjes të kategorisë B ose C ose D ose E
- me ose pa përvojë pune.

4. Orari javor i punës është 40 orë.

5. Me fletëparaqitjen kandidatët janë të obliguar ti dorëzojnë dokumentet në vijim

Për kandidatët prej 1.1 deri 1.10

- fletëparaqitje me të dhëna për kontakt

- biografi të shkurtë (CV)

-diplomë për arsimin e mbaruar në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter

- dëshmi për njohje të gjuhës së huaj (angleze, frënge ose gjermane).
- certifikatë të shtetësisë së Republikës së Maqedonisë, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
- certifikatë të mjekut jo më të vjetër se 6 muaj, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
- certifikatë se nuk është shqiptuar ndalesë e plotfuqishme për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter

Për kandidatët nga 1.2 duhet të parashtrijnë dokumente shtesë si

- certifikatë për provim të dhënë profesional, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter

- licencë për punë, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter.

Për kandidatët nga 1.3-1.4 duhet të parashtrijnë dokumente shtesë si

- certifikatë për provim të dhënë profesional, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter

Për kandidatët prej 1.12 deri 1.14

- fletëparaqitje me të dhëna për kontakt

- biografi të shkurtë (CV)
- diplomë për arsimin e mbaruar në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
- dëshmi për njohje të gjuhës së huaj (angleze, frënge ose gjermane).
- certifikatë të shtetësisë së Republikës së Maqedonisë, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
- certifikatë të mjekut jo më të vjetër se 6 muaj, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
- certifikatë se nuk është shqiptuar ndalesë e plotfuqishme për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter

Për kandidatët nga 1.11 dhe 1.15

- fletëparaqitje me të dhëna për kontakt

- biografi të shkurtë (CV)
- diplomë për arsimin e mbaruar në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
- certifikatë të shtetësisë së Republikës së Maqedonisë, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
- certifikatë të mjekut jo më të vjetër se 6 muaj, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter

6. Afati për paraqitje në shpalljen publike është 7 (shtatë) ditë pune nga dita e publikimit.

7. Fletëparaqitja së bashku me dokumentacionin e tërësishëm të nevojshëm dhe telefoni për kontakt të dorëzohen deri në IPSH Institutit për shëndet publik të Republikës së Maqedonisë – Shkup rr. 50 Divizija nr. 6, përmes postës ose në arkivin e IPSH Qendra për shëndet publik të Republikës së Maqedonisë – Shkup me shenjë për Shpallje publike për punësim.

IPSH Institutit për shëndet publik i republikës së Maqedonisë – Shkup
Ass. D-r Shaban Memeti

Në bazë të nenit 22 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e RM nr. 62/2005, 106/2008, 161/2008, 114/2009, 130/2009, 50/2010, 52/2010, 124/2010, 47/2011, 11/2012, 39/2012, 13/2013, 25/2013, 170/2013, 187/2013, 113/2014, 20/2015, 33/2015, 72/2015, 129/2015, 27/2016 dhe 120/2018), Drejtori i IPKÇF "Veseli Cvetovi" Komuna e Kisella Vodës në Qytetin e Shkupit, publikon

SHPALLJE PUBLIKE

për punësim për kohë të pacaktuar

1. 2 (dy) edukatorë, Profesor i diplomuar në edukimin parashkollor, edukator i diplomuar për fëmijët parashkollor dhe pedagog i diplomuar për arsimin parashkollor me 240 kredi të fituara sipas SETK ose arsim sipëror të mbaruar shkalla VII / 1 ose të kanë të përfunduar arsimin përkatës të lartë për edukatorë dhe me licencë valide për edukator, me ose pa përvojë pune.
2. 2 (dy) përkëdhelës, të kenë të mbaruar arsim katërvjeçar të mesëm dhe licencë valide për përkëdhelës, me dhe pa përvojë pune
3. 1 (një) mirëmbajtës të higjienës, të kenë të mbaruar arsimin fillor ose të mesëm, me dhe pa përvojë pune.
4. 1 (një) gjellëbërës, me PMP shkalla e III ose IV të përgatitjes profesionale – arsim i mesëm i hotelierisë.
5. 1 (një) enëlarës, të kenë të mbaruar arsimin fillor ose të mesëm

Me fletëparaqitjen në të cilën duhet të ceket numri rendor dhe emri i vendit të punës për të cilën konkurrohet kandidatët duhet të dorëzojnë:

- Diplomë (certifikatë) ose dëftesa për shkallën e arsimit të mbaruar e cila kërkohet (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter)
- Certifikate nga mjeku
- Certifikatë të shtetësisë (kopje)
- Vërtetim se njih gjuhën maqedonase dhe alfabetin cirilik
- Dëshmi që nuk i është shqiptuar dënim ose sanksion kundërvajtjeje ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.
- Dëshmi që nuk i është shqiptuar dënim me vendim të plotfuqishëm gjyqësor me të cilën është dënuar për veprë penale për dhunë familjare, marrje të personit të mitur, moskujdes dhe keqtrajtim të personit të mitur ose abuzim farefisnor, për veprë penale nga grupi i veprave kundër lirisë gjinore, pavarësisht të sanksionit të shqiptuar dhe tek i cili në pajtim me ligjin është caktuar sjellje diskriminuese;

Afati për dorëzimin e dokumenteve është 5 ditë pune, duke llogaritur nga dita e ardhshme e publikimit të shpalljes.

Zgjedhja do të realizohet në afat prej 45 ditë pune pas përfundimit të afatit për paraqitje.

Orari i punës së:

- Orari i punës për vendin e punës edukator është 40 orë në javë (e hënë-e premte), ndërsa orar ditor i punës është 8 orë dhe i njëjti është prej ora 07.00 deri në ora 15.00
- Orari i punës për vendin e punës përkëdhelës dhe mirëmbajtës të higjienës është 40 orë në javë (hënë deri - premte), ndërsa orari ditor i punës është në mënyrë shkallore në periudhën prej orës 06,00 deri në ora 18,00 dhe
- Orari i punës për vendin e punës gjellëbërës është 40 orë në javë (e hënë-e premte), ndërsa orar ditor i punës është 8 orë dhe i njëjti është prej ora 06.00 deri në ora 14.00

Neto roga bazë për vendin e punës:

- edukator është 20.524,00 denarë
- përkëdhelës është 15.477,00 denarë
- mirëmbajtës të higjienës është 12.572,00 denarë
- gjellëbërës është 14.369,00 denarë
- enëlarës është 12.572,00 denarë

Dokumentacioni i pakompletuar, jo në kohe dhe pa rregulluar nuk do të shqyrtohet.

Dokumentacioni duhet të dorëzohet deri te:

IPKÇF "Veseli Cvetovi" Komuna e Kisella Vodës në Qytetin e Shkupit
rr."Gjorgji Sugare" nr.2
tel: 2776-236
1000 Shkup.



Republic of Macedonia
Ministry of finance

THIRRJE PËR PARASHTRIMIN E OFERTAVE

REPUBLIKA E MAQEDONISË PROJEKTI PËR PËRMIRËSIM TË KUSHTEVE KOMUNALE (MSIP) EU IPA GRANT:TF018812

Projektim dhe ndërtim të sistemeve solare fotovoltaike në komunat rurale

MSIP-MF-IPA-NCB-001-18

1. Kjo Thirrje për parashtrimin e ofertave e përcjellë shpalljen e përgjithshme për furnizime për këtë projekt të publikuar në edicionin e UN Development Business me nr. 767 nga 31 janari, 2010 (edicioni i shtypur) dhe të publikuar në mënyrë elektronike më 06 janar, 2010.

2. Republika e Maqedonisë ka fituar grant mjete nga Komisioni Evropian në kuadër të IPA fondit për investime rurale të Komisionit Evropian për rekonstrukcion dhe zhvillim për Projektin për përmirësim të shërbimeve komunale (MSIP) dhe ka për qëllim që një pjesë të mjeteve të fituara të këtij granti t'i shfrytëzojë për pagesë të marrëveshjes për furnizim të: Projektimit dhe ndërtimit të sistemeve solare fotovoltaike në komunat rurale.

3. Parashtrimi i ofertave do të realizohet përmes procedurave për ankand nacional konkurrues siç është specifikuar në Udhëzimin e Bankës Botërore: Furnizim me mjetet e fituara nga IBRD Huat dhe IDA Kreditë (prej muajit maj 2004, të reviduar në muajin tetor 2006 dhe maj 2010), dhe është e hapur për të gjithë Ofertuesit e shteteve të kualifikuara siç është definuar në Udhëzimin për furnizime të Bankës Botërore. Në mënyrë shtesë, Ju lutemi të thirrni në paragrafët 1.6 dhe 1.7 ku theksohet politika e Bankës Botërore për konflikt të interesave.

4. Ofertuesit e volitshëm të interesuar mund të marrin informata plotësuese në Ministrinë e financave, personi për kontakt: Aleksandar Najdovski, posta elektronike: aleksandar.najdovski@finance.gov.mk dhe të shqyrtojnë dokumentacionin tenderues në kuadër të orarit të punës prej ora 08:30 deri në ora 16:30 në adresën si vijon: Ministria e financave, rruga Dame Gruev, numër 12, kati VII, 1000, Republika e Maqedonisë.

5. Dokumentacionin e kompletuar tenderues në gjuhën maqedonase ofertuesit e interesuar mund ta marrin pa pagesë të kompensimit në të holla, por vetëm me parashtrimin e aplikacionit me shkrim në adresën si në vijim: Aleksandar Najdovski, Ministria e financave, rruga Dame Gruev, numër 12, kati VII, 1000, Republika e Maqedonisë.

6. Ofertat duhet të parashtrihen në adresën si në vijim: Ministria e financave, rruga Dame Gruev, numër 12, ARKIVI, 1000, Republika e Maqedonisë, më së voni deri më **15.11.2018, në ora 12:00**. Parashtrimi elektronik i ofertave nuk është i lejuar. Ofertat e vonuara do të refuzohen.

Ofertat do të hapen në mënyrë fizike në prezencë të përfaqësuesve të ofertuesve që do të zgjedhin të marrin pjesë personalisht në adresën si në vijim: Ministria e financave, rruga Dame Gruev, numër 12, kati VII, Salla e konferencave, 1000, Republika e Maqedonisë më datë **15.11.2018, në ora 12:30**.

7. Të gjitha ofertat duhet të shoqërohen me Garanci bankare për ofertë si në vijim:

Për LOT 1: 750,000.00 MKD

Për LOT 2: 650,000.00 MKD

Për LOT 3: 600,000.00 MKD

Për LOT 4: 400,000.00 MKD

Derbi është një rast për të lënë shenjë dhe për të përmbysur hierarkitë. Kjo është ajo që shpreson të bëjë mesfushori i Inter, Roberto Gagliardini, i cili mund të jetë titullar në ndeshjen e ardhshme të kampionatit kundër Milanit

SPALLETTI KA GATI SURPRIZËN PËR DERBIN NDAJ MILANIT



ekip një lojtar si Gaglia, që lufton dhe djersitet sa për tre, pa u ankuar kurrë. Dhe që, në fund, është i aftë të jetë kërcënues edhe para portës së kundërshtarit duke shfrytëzuar gjatësinë e tij në lojën në ajër dhe një goditje të mirë nga distanca. Kohët e fundit, në rrjetet sociale ka marrë shumë klikime një video e tij në stërvitje e publikuar nga Inter, me lojtarin që ka hënuar një gol "alla Hollywood&Benjy". Nëse do ta bënte një gjë të tillë në derbi, "San Siro" zikaltër do të çmendej. Sigurisht, Gagliardini do të kënaqej edhe me më pak: një vend në formacionin titullar dhe një paraqitje të mirë. Më pas, natyrisht, që të bëjë festë në fund të ndeshjes para tifozerisë ultras të Interit.

Trajneri Spalletti ka dy arsye për t'i besuar atij nga minuta e parë kundër "Djallit". E para: nuk është në listën e Champions League dhe, për rrjedhojë, nuk do të jetë në dispozicion për transfertën në Barcelonë. E dyta: Matias Vecino është i grumbulluar dhe do të shkojë në Milano të enjten. Përveç këtyre arsyeve, duhet patur para-

sysh edhe rritja fizike e ish-mesfushorit të Atalanta-s, i cili është shumë i vlerësuar nga trajneri zikaltër dhe ai i Italisë, Roberto Mancini. Deri tani, Gagliardini ka luajtur pesë ndeshje, tri prej të ci-

lave si titullar. Kanë qenë paraqitje me ulje-ngritje, por ai mbetet një lojtar shumë i rëndësishëm për ekuilibrat e skuadrës së Mancini-t. Është një "xhol" taktik si pak të tjerë, shpesh thelbësor

në fazën e lojës pa top falë zgjuarsisë së tij si futbollist. Problemi kryesor, ndoshta, ka të bëjë me ambientin, sepse tifozët mbajnë mend vetëm gjestin teknik, golin. Por çdo trajner do të donte në

Malcom mund të huazohet në janar

Është lojtari më i përfolur gjatë afatit kalendarik të verës pasi futi në sherr Romën dhe Barcelonën. Sulmuesi brazilian Malcom filimisht kishte pranuar transferimin tek klubi italian, por në momentin e fundit ndryshoi mendje dhe iu bashkua Barcelonës. E duket se gjërat për anësin nuk kanë shkuar siç i kishte menduar pasi tek Barcelona nuk po luan thujt fare. Malcom deri më tani ka pasur vetëm dy paraqitje në La Liga, duke luajtur gjashtë minuta ndaj Valladolidit në udhëtim dhe 19 të tjera ndaj Leganesit. E kjo nuk po i pëlqen sulmuesit brazilian dhe agjentit të lojtarit. "Malcom nuk është i kënaqur me atë që po ndodh momentalisht në Barcelonë. Nuk po luan dhe natyrisht që kjo gjë nuk i pëlqen atij. Çdo lojtar kalon nëpër një fazë që duhet të përshtatet me ekipin dhe këtë po e kalon edhe Malcom. Ai ka nevojë për kohë për të treguar më të mirën", ka thënë agjenti i lojtarit, Junior Minguella. Por sipas mediave spanjolle, Barcelona gjatë janarit do të shikojë mundësinë e huazimit të lojtarit, pasi nuk po



pëlqehet nga trajneri Ernesto Valverde. Kampioni në fuqi i La Ligas, po shikon ndonjë skuadër spanjolle ku mund ta huazojë brazilianin për ta rikthyer besimin dhe për të pasur më shumë minuta. Real Sociedad, Betis dhe Valencia janë tri skuadrat që kanë shprehur interesim për ta huazuar 21 vjeçarin. Barcelona iu bashkua Barcelonës nga skuadra franceze Bordeaux për një shumë prej 41 milionë eurove.

Publicitet

Në përputhje me nenin 1, paragrafin 2 të Ligjit për Letra me Vlerë (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë 95/2005, 25/2007, 7/2008, 57/2010, 135/2011, 13/2013, 188/2013, 43/2014, 15/2015, 154/2015, 192/2015, 23/2016 dhe nr. 83/2018), neni 73 dhe neni 84 nga Ligji për Procedurë të përgjithshme administrative (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 124/2015), Komisioni për Letra me Vlerë i Republikës së Maqedonisë lëshon si vijon:

NJOFTIM

Komisioni i Letrave me Vlerë i Republikës së Maqedonisë kryen dorëzim me botim publik të akteve si vijon:

1. Konkluzioni nr. PRK UP 03-4 nga 21.09.2018 për Veles tabak ShA Veles me adresë në rr. "Aleksio Demnievski - Bauman" nr. 63, Veles dhe
2. Konkluzioni nr. PRK UP 03-7 nga 21.09.2018 për Luiza Janeva me adresë në rr. „Solunska, 29, Veles, si person përgjegjës i shoqërisë Veles tabak ShA Veles.

Ftohen persona të autorizuar nga shoqëria e lartpërmendur që në afat prej 10 (dhjetë) ditë nga botimi i këtij njoftimi të lajmërohen në hapësirat e Komisionit të letrave me vlerë të Republikës së Maqedonisë dhe t'i marrin aktet e lartpërmendura.

VËREJTJE: Pala paralajmërohet që kjo mënyrë e dorëzimit konsiderohet si dorëzim i rregullt dhe çdo pasojë e mundshme negative që mund të ndodh do të bartet nga vet pala.

Nr 03-807/1
09.10.2018
Shkup

Komisioni i letrave me vlerë
i Republikës së Maqedonisë
Kryetar
Mr.Sc. Nora Aliti

Juventus do të ketë probleme, ne do të jemi gati

Dries Mertens, sulmuesi i Napolit, ka folur për "Gazzetta dello Sport" në lidhje me luftën për titull në Serinë A me Juventusin. "Kemi qenë të pafat në ndeshjen që kemi humbur kundër tyre, por Napoli ka treguar se është në formë. Ata kanë bërë blerje të mëdha dhe ndoshta janë më të fortë se më parë, por unë nuk jam plotësisht i bindur. Në Torino kemi provuar të fitojmë pa patur frikë", ka thënë Mertens. "Objektivat? Luaj për të fituar gjithçka. Jam ndier gjithmonë mirë te Napoli, këtë e kam thënë gjithmonë. Shpesh është folur për një largim timin, por jam akoma këtu. Kam akoma shumë objektiva për të arritur përpara". "Titulli? Napoli është në garë. Edhe Juventus do të ketë vë-



shtirësi dhe ne do të kërkojmë të përfitojmë. Edhe rivalët e tjerë janë të fortë, kryesisht mendoj për Interin. Champions? Është një grup i vështirë, por ne duam të kualifikohemi. Fitorja ndaj Liverpool na ka kthyer në garë", ka përfunduar belgu.

Oblak në ndjekje të rekordit të Valdesit



Jan Oblak ka pranuar katër gola në katër ndeshjet e para të La Liga-s, por portieri sloven është në rrugën e duhur për të arritur rekordin e ish-portierit të Barcelonës, Victor Valdes, i cili katër herë ka fituar çmimin Zamora. Oblak ka qenë njeriu që ka mbrojtur portën e Atletico Madridit në sezonet e fundit, megjithëse nuk u paraqit deri në ndeshjen e 28-të në sezonin e tij të parë me Los Rojiblanos. Ai është portieri që ka mbajtur të paprekur portën në katër nga tetë ndeshjet e ligës në sezonin 2018/19. Porta e pa-

prekur ka qëndruar kundër Getafes (2-0), Huescas (3-0), Real Madrid (0-0) dhe Real Betis (1-0). Kjo i dha atij një bilanc prej 0.5 golave të lejuar për ndeshje dhe ndiqet vetëm nga Jordi Masip i Real Valladolid, i cili ka pranuar gjashtë gola në tetë ndeshje (0.75 gola), ndërsa pas tij vjen David Soria i Getafes me shtatë gola (0.88 gola për lojë). Ka mbetur shumë nga ky sezon, por Oblak është i gatshëm të arrijë një rekord që vetëm Valdes arriti në mes të viteve 2008 dhe 2012. Ish-portieri i Barcelonës pranoi 31 gola në 35 ndeshje në sezonin e parë; 24 në 38 në sezonin vijues; 16 në 32 në 2010-11 dhe 28 në 35 në sezonin e fundit. Portieri sloven i Atletico në sezonin e fundit pranoi 22 gola, në sezonin 2016/17 pranoi 21 sosh, ndërsa në sezonin 2015/16 pranoi 18 gola në 31 ndeshje. Këtë sezon, Oblak synon t'i pranojë më pak se 16 gola për të arritur rekordin e Valdesit, ndërsa nëse arrin të jetë portieri me më së paku gola të pranuar në La Liga, do të fitojë për të katërtin vit radhazi çmimin Zamora.

Në bazë të nenit 14 paragrafi 1, nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e RM nr. 167/2015-teksti i pastruar) dhe nenit 142 paragrafi 1 të Ligjit për mbrojtje të fëmijëve (Gazeta Zyrtare e RM nr. 23/2013), Drejtori i IPKÇF "Majski Cvet" Manastir publikon

SHPALLJE PUBLIKE Për punësim për kohë të pacaktuar

1. Eduktor për fëmijët e moshës prej 2-6 vjeç – dy (2) realizues për kohë të pacaktuar

- Kushtet e posaçme të nevojshme

-Profesor i diplomuar i lartë/sipëror për edukim parashkollor, edukator i diplomuar për fëmijë të moshës parashkollore dhe pedagog i diplomuar për edukim parashkollor – me 240 kredi të arritura sipas SETK ose arsim sipëror të mbaruar të shkallës VII/1 ose me arsim të lartë të mbaruar përkatës për edukatorë dhe me licencë valide për edukator.

- pa përvojë pune
- licencë valide për edukatorë

Orari i punës është 40 orë në javë, të cilat ndahen në 30 orë për punë të drejtpërdrejtë me fëmijë, dhe koha e mbetur për aktivitete të tjera, prej ditës së hënë deri ditën e premte; orari i kohës së punës caktohet në mënyrë të shkallëzuar në kuadër të orarit të punës prej ora 5:30 deri në ora 18:00.

Neto pagesa bazë është 20.524,00 denarë për përgatitje sipërore profesionale ose 19.399,00 për përgatitje të lartë profesionale.

Krahas kushteve të posaçme të theksuara kandidatët duhet të përmbushin edhe kushtet e përgjithshme ligjore.

Kandidatët duhet të dorëzojnë:

- Lutje
- Diplomë (Certifikatë), Dëftesë për arsimin e mbaruar përkatës (origjinal ose kopje të vërtetuar);
- Licencë valide (për edukator)
- Certifikatë të shtetësisë së RM (jo më të vjetër se gjashtë muaj);
- Certifikatë të lindjes
- Certifikatë se nuk i është shqiptuar ndalesë ose sanksion për kundërvajtje ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës (jo më të vjetër se gjashtë muaj).
- Certifikatë se nuk i është shqiptuar dënim me vendim të plotfuqishëm gjyqësor me të cilën do dënohet për veprë penale dhunë familjare, marrje të personit të mitur, moskujdesë dhe keqtrajtim të personit të mitur ose abuzim farefisnor, për veprë penale të grupit të veprave kundër lirisë gjinore (jo më të vjetër se gjashtë muaj).

Shpallja zgjatë tre (3) ditë pune nga dita e publikimit të saj.

Zgjedhja do të realizohet në afat prej dyzetepesë (45) ditëve, pas kalimit të afatit për paraqitje.

Dokumentacioni i kompletuar të dorëzohet në adresën: IPKÇF "Majski Cvet" – Manastir, rr. "Smilevski Kongres" pn, Manastir.

Dokumentet e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të merren parasysh gjatë shqyrtimit.

**IPKÇF "MAJSKI CVET"
MANASTIR**

Në bazë të nenit 14 paragrafi 1, nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e RM nr. 167/2015-teksti i pastruar) dhe nenit 142 paragrafi 1 të Ligjit për mbrojtje të fëmijëve (Gazeta Zyrtare e RM nr. 23/2013), Drejtori i IPKÇF "Estreja Ovalija – Mara" Manastir publikon:

SHPALLJE PUBLIKE nr. 6/2018 Për punësim për kohë të pacaktuar

1. Edukator për fëmijët e moshës prej 2-6 vjeç – 2 (dy) persona për kohë të pacaktuar
- Kushtet e posaçme të nevojshme

-Profesor i diplomuar i lartë/sipëror për edukim parashkollor, edukator i diplomuar për fëmijë të moshës parashkollore dhe pedagog i diplomuar për edukim parashkollor – me 240 kredi të arritura sipas SETK ose arsim sipëror të mbaruar të shkallës VII/1 ose me arsim të lartë të mbaruar përkatës për edukatorë

- pa përvojë pune
- licencë valide për edukatorë
Orari i punës është 40 orë në javë, të cilat ndahen në 30 orë për punë të drejtpërdrejtë me fëmijë, dhe koha e mbetur për aktivitete të tjera, prej ditës së hënë deri ditën e premte; orari i kohës së punës caktohet në mënyrë të shkallëzuar në kuadër të orarit të punës prej ora 5:30 deri në ora 18:00.
Neto pagesa bazë është 20.524 denarë për përgatitje sipërore profesionale ose 19.400 denarë për përgatitje të lartë profesionale.

2. Përkëdhelës - 3 (tre) persona për kohë të pacaktuar

- Kushtet e posaçme të nevojshme
- PMP – arsim të mesëm katërvjeçar dhe licencë valide për përkëdhelës
- pa përvojë pune
- licencë valide për përkëdhelës

Orari i punës është 40 orë në javë, të cilat janë të shpërndara në 35 orë për punë drejtpërdrejtë me fëmijë, ndërsa koha tjetër për aktivitete të tjera prej ditës së hënë deri ditën e premte; orari i punës është me shkallë në kuadër të orarit të punës prej ora 5:30 deri në ora 18:30.
Neto pagesa bazë është 15.477 denarë.

3. Enëlarës -1 (një) person për kohë të pacaktuar

- Kushtet e posaçme të nevojshme
- arsim fillor
- pa përvojë pune

Orari i punës është 40 orë në javë, prej ditës së hënë deri ditën e premte prej ora 8:30 deri në ora 16:30.
Neto pagesa bazë është 12.572 denarë.

4. Mirëmbajtës të higjienës – dy (2) persona për kohë të pacaktuar

- Kushtet e posaçme të nevojshme
- arsim fillor
- pa përvojë pune

Orari i punës është 40 orë në javë, prej ditës së hënë deri ditën e premte prej ora 8:30 deri në ora 16:30.
Neto pagesa bazë është 12.572 denarë.

5. Mjeshër i përgjithshëm – një (1) person për kohë të pacaktuar

- Kushtet e posaçme të nevojshme
- arsimi i mesëm katërvjeçar – drejtimi teknik
- pa përvojë pune

Orari i punës është 40 orë në javë, prej ditës së hënë deri ditën e premte prej ora 8:30 deri në ora 16:30.
Neto pagesa bazë është 13.803 denarë.

Krahas kushteve të posaçme të theksuara kandidatët duhet të përmbushin edhe kushtet e përgjithshme ligjore.

Së bashku me lutjen kandidatët duhet të dorëzojnë:

- Diplomë (Certifikatë), Dëftesë për arsimin e mbaruar përkatës (origjinal ose kopje të vërtetuar);
- Licencë valide (për edukator dhe përkëdhelës)
- Certifikatë të shtetësisë së RM (jo më të vjetër se gjashtë muaj);
- Certifikatë të lindjes (jo më të vjetër se gjashtë muaj)
- Certifikatë se nuk i është shqiptuar ndalesë ose sanksion për kundërvajtje ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës (jo më të vjetër se gjashtë muaj).
- Certifikatë se nuk i është shqiptuar dënim me vendim të plotfuqishëm gjyqësor me të cilën do dënohet për veprë penale dhunë familjare, marrje të personit të mitur, moskujdesë dhe keqtrajtim të personit të mitur ose abuzim farefisnor, për veprë penale të grupit të veprave kundër lirisë gjinore (jo më të vjetër se gjashtë muaj).

Shpallja zgjatë tre (3) ditë pune nga dita e publikimit të saj.

Zgjedhja do të realizohet në afat prej dyzetepesë (45) ditëve, pas kalimit të afatit për paraqitje.

Dokumentacioni i kompletuar të dorëzohet në adresën: IPKÇF "Estreja Ovalija – Mara" – Manastir, rr. "Naum Naumovski Borçe" pn, Manastir.

Dokumentet e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të merren parasysh gjatë shqyrtimit.

**Drejtor
Lidija Tfirst Mitrevska
IPKÇF "Estreja Ovalija – Mara"
MANASTIR**

Në bazë të nenit 22 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 62/2005, 106/2008, 161/2008, 114/2009, 130/2009, 50/2010, 52/2010, 124/2010, 47/2011, 11/2012, 39/2012, 13/2013, 25/2013, 170/2013, 187/2013, 113/2014, 20/2015, 33/2015, 72/2015, 129/2015 dhe 27/2016), Drejtori i ÇPF "8 Mart" – të komunës së Kisella Vodës në Qytetin e Shkupit, publikon

SHPALLJE Për punësim të

-2 (dy) përkëdhelës për kohë të pacaktuar, me arsim të mesëm të mbaruar katërvjeçar dhe licencë valide për përkëdhelës, me dhe pa përvojë pune

-1 (një) përkëdhelës për kohë të caktuar deri më 31.12.2018, me arsim të mesëm të mbaruar katërvjeçar dhe licencë valide për përkëdhelës, me dhe pa përvojë pune

-1 (një) logoped për kohë të caktuar deri më 31.12.2018, logoped i diplomuar me 240 kredi të arritura sipas SETK, ose arsim sipëror të mbaruar shkalla e VII/1 dhe licencë valide për punëtor profesional, me dhe pa përvojë pune

-2 (dy) mirëmbajtës të higjienës për kohë të pacaktuar, me arsim fillor ose të mesëm të mbaruar, me dhe pa përvojë pune

-1 (një) kopshtar për kohë të pacaktuar, me arsim fillor ose të mesëm të mbaruar, me dhe pa përvojë pune

-1 (një) ndihmës gjellëbërës për kohë të pacaktuar, me arsim të mesëm të mbaruar shkalla III ose IV – shkolla e hotelierisë, me dhe pa përvojë pune

-1 (një) enëlarës për kohë të pacaktuar, me arsim fillor ose të mesëm të mbaruar, me dhe pa përvojë pune

-1 (një) rrobalarës – hekurosës për kohë të pacaktuar, me arsim fillor ose të mesëm të mbaruar, me dhe pa përvojë pune

-1 (një) defektolog me kohë të pacaktuar, defektolog i diplomuar me 240 kredi të arritura sipas SETK, ose arsim sipëror të mbaruar shkalla VII/1 dhe licencë valide për punëtor profesional, me dhe pa përvojë pune.

Së bashku me fletëparaqitjen kandidatët duhet të parashtrojnë:

- dëshmi për arsim përkatës të mbaruar (dëftesë, diplomë, certifikatë – origjinal ose kopje të vërtetuar në noter),
- certifikatë të shtetësisë,
- certifikatë të mjekut,
- dëshmi për njohje të gjuhës maqedonase dhe alfabetit cirilik;
- Certifikatë se nuk i është shqiptuar ndalesë ose sanksion për kundërvajtje ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- Dëshmi se nuk i është shqiptuar dënim me vendim të plotfuqishëm me çka është i dënuar për veprë penale për dhunë familjare, marrje të personit të mitur, moskujdesë ose keqtrajtim të personit të mitur ose abuzim farefisnor, për veprë penale nga grupi i veprave kundër lirisë gjinore, pavarësisht sanksionit të shqiptuar dhe tek i cili në pajtim me ligjin është caktuar shtetësi diskriminuese.

Afati për parashtimin e dokumenteve është 5 ditë pune, duke konsideruar nga dita e ardhshme e ditës së publikimit të shpalljes.

Zgjedhja do të realizohet në afat prej 45 ditëve të punës pas kalimit të afatit për paraqitje.

Orari i punës për vendet e punës:

- përkëdhelës, mirëmbajtës të higjienës, kopshtar, ndihmës gjellëbërës, enëlarës dhe rrobalarës-hekurosës është 40 orë në javë (prej ditës së hënë deri ditën e premte), ndërsa orari ditor i punës është 8 orë dhe i njëjti është i shkallëzuar në periudhë prej ora 06,00 deri në ora 18,00
- logoped dhe defektolog është 40 orë në javë (prej ditës së hënë deri ditën e premte), ndërsa orari ditor i punës është 8 orë dhe i njëjti është me fillim mes orës 07:30 dhe 08:30 dhe mbaron mes orës 15:30 dhe 16:30.

Neto pagesa fillestare për vendin e punës:

- përkëdhelës është 15.477,00denarë,
- logoped është 21.025,00 denarë
- mirëmbajtës të higjienës është 12.571,00 denarë
- kopshtar është 12.571,00 denarë
- ndihmës gjellëbërës është 12.571,00 denarë
- enëlarës është 12.571,00 denarë
- rrobalarës-hekurosës është 12.571,00 denarë
- defektolog është 21.025,00 denarë.

Dokumentacioni i dorëzuar pas afatit, jo i kompletuar dhe i parregulluar nuk do të shqyrtohet. Fletëparaqitja së bashku me dokumentet e nevojshme të parashtrohet deri në:

ÇPF "8 Mart" e komunës së Kisella Vodës në Qytetin e Shkupit
rr. "Hristo Tatarçev" nr. 45
tel: 02/2779-229
1000 Shkup

Në bazë të nenit 17 paragrafi 1 i Rregullores për mënyrën e realizimit të ekskursioneve për nxënës dhe aktiviteteve tjera të lira të nxënësve të shkollave fillore nr. 07-9992/2 të datës 05.06.2014, të sjellë nga MASH, SHF "Zhviko Brajkovski" Butel Shkup, publikon

SHPALLJE PUBLIKE Për grumbullimin e ofertave

SHF "Zhviko Brajkovski" Butel Shkup, rr. Ho Shi Min pn, tel. 2621-412 organizon ekskursione dhe aktivitete tjera të lira për nxënësit për vitin shkollor 2018/19 në pajtim me Programin për aktivitetet e theksuara, edhe atë:

- piknik njëditor vjeshtor dhe pranveror për nxënësit prej klasës së I deri klasën e IX;
- ekskursion njëditor shkencor-rekreativ për nxënësit e klasës së III;
- mësim në natyrë për nxënësit e klasës së V;
- ekskursion dyditor shkencor për nxënësit e klasës së VI;
- ekskursion treditor shkencor për nxënësit e klasës së IX;
- transport për aktivitete tjera të lira për nxënësit

Kushtet minimale që duhet të përmbushë ofertuesi janë:

- Të jetë i regjistruar në pajtim me dispozitat pozitive në Republikën e Maqedonisë për kryerje të veprimtarisë përkatëse turistike.
- Të ketë të realizuara në mënyrë të suksesshme së paku 3 ekskursione shkollore dhe aktivitete tjera të lira në 3 vitet e fundit.

- Të përmbushë kushtet për transport të grupit të nxënësve në pajtim me Ligjin për siguri në komunikacion rrugor dhe Rregulloren për kërkesat e posaçme teknike të makinave me të cilët transportohen grupet e fëmijëve.

Në ditën e nënshkrimit të marrëveshjes, ofertuesi i zgjedhur parashton garanci bankare për realizim kualitativ të ekskursionit dhe aktiviteteve tjera të lira në shumë prej 5% të vlerës së marrëveshjes.

Ftohen ofertuesit e interesuar të parashtrojnë oferta sipas dokumentacionit që mund të merret në shkollë çdo ditë pune prej ora 8,00 deri në ora 12,00 në objektin e shkollës.

Të gjithë ofertuesit e interesuar të parashtrojnë ofertë në origjinal, të nënshkruar dhe të vërtetuar nga personi përgjegjës i ofertuesit me dokumentacion të bashkëngjitur të vërtetuar dhe të nënshkruar nga organi kontraktues, në zarf të mbyllur me shenjë **MOS HAP** në këndin e epërm të djathtë, deri te komisioni për organizim të ekskursioneve për nxënës dhe aktiviteteve tjera të lira për nxënësit në adresën SHF "Zhviko Brajkovski" – Butel, Shkup rr. "Ho Shi Min" pn, ose në arkivin e shkollës.

Oferta e ofertuesit që nuk përmbushë kushtet minimale do të refuzohet nga ana e komisionit.

Shpallja zgjatë 5 (pesë) ditë pune.

Ofertat të cilat do të arrihen më vonë se afati i caktuar nuk do të shqyrtohen.

**SHF "Zhviko Brajkovski" – Butel, Shkup
Komisioni për ekskursione të nxënësve dhe aktiviteteve tjera
për nxënësit**

**Tel: 02 3179 - 904, Fax: 3118 - 060
marketing@koha.com.mk**

Nënkryetarja e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), Fatmire Kollçaku, tha se akuzat e kryeministrit dhe presidentit ndaj njëri-tjetrit janë paralajmërim për zgjedhje, derisa shtoi se zgjedhjet janë mundësia e vetme që vendi të zhbllloket

Partitë opozitare vazhdojnë të kërkojnë zgjedhje të parakohshme pasi që, sipas tyre, Qeveria aktuale nuk mund t'i sigurojë votat e nevojshme në Kuvend që të kalojë çështjet me rëndësi për vendin, e lërë më të marrë vendime të mëdha. Nënkryetarja e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), Fatmire Kollçaku, tha se akuzat e kryeministrit dhe presidentit ndaj njëri-tjetrit janë paralajmërim për zgjedhje, derisa shtoi se zgjedhjet janë mundësia e vetme që vendi të zhbllloket.

"Ne si opozite e kemi vlerësuar qysh moti që ka nevojë për zgjedhje sepse kjo Qeveri tashme nuk e ka shumicën. Ju po e shihni që edhe në Kuvend nuk po kanë mundësi asnjë iniciative mos të them që asnjë projektligj ta shtyjnë pa prezencën e opozitës. Mirëpo tashmë kjo siç e cekët edhe ju, jo serioziteti i dy njerëzve siç janë kryeministri dhe presidenti me akuza dhe kundër akuza të cilat me të vërtetë nuk janë asgjë tjetër, por janë paralajmërim që

ZGJEDHJET E PARAKOHSHME, TË PASHMANGSHME



mund të ketë vërtet zgjedhje. Prandaj duke e parë këtë situatë, e vetmja zgjedhje e duhur janë zgjedhjet të parakohshme të cilat duhet ta prodhonin një Qeveri legjitime një Qeveri që do ta ketë shumicën, që do ta ketë një shumicë edhe në Kuvend për t'i shtyrë proceset përpara", tha Kollçaku.

Edhe Deputetja e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Besa Gaxherri, thotë se situata në vend është e ndërlikuar prandaj sipas saj, shkuarja në zgjedhje është e domosdoshme. "Jo vetëm që LDK është e gatshme dhe këtë po e thonë edhe sondazhet, por nuk duhet të diskutohet se cili subjekt është i gatshëm dhe cili nuk është. Nuk ka rëndësi cilido subjekt që do të legjitimohet nga qytetarët e

vendit duhet të marr përgjegjësit dhe nuk duhet të ndodhë çfarë po ndodhë. Prandaj LDK-së i përforcohet për çdo dite mendimi dhe qëndrimi i saj që ky vend duhet të shkoj urgjentisht në zgjedhje sepse zgjidhja e këtyre problemeve behet vetëm përmes zgjedhjeve duke u ofruar tek sovranit dhe ai të jap besimin atij subjekti politik i cili mendon që do ta përfaqësoj siç duhet".

Për kryetaren Alternativës, Mimoza Kusari, vendi është në bllokim të tërësishëm, derisa sa ka theksuar se partitë që drejton është e gatshme të hyj në zgjedhje, raporton EO. "Ajo çka po shohim është një rrezikim i vazhdueshëm i pushteteve të njëri-tjetrit. Nëse kemi bllokim të tërësishëm të Ku-

vendit në vazhdimësi, mos-performancë dhe neglizhencë dhe gjithashtu praktika të korruptuara të qeverisë në vazhdimësi atëherë ndryshimi është i domosdoshëm".

"Natyrisht që i marrim përgjegjësit dhe obligimet shtetërore. Ne në vazhdimësi kemi bërë thirrje që për proces të dialogut të ketë konsensus, të gjitha palët të ulën dhe të vijnë më një platformë të përbashkët dhe natyrisht pasi që të gjenden zgjidhjet për këtë temë kaq të madhe dhe me rëndësi për Kosovën, pastaj të përcaktohet bashkërisht dhe data e zgjedhjeve, sepse në këtë konglomerat politik dhe strukturën se si është krijuar sot në Kosovë nuk do të ketë mundësi që të ecim shumë përpara", tha ajo.



Vrasja e gazetarit saudit, torturat janë regjistruar nga Apple Watch i tij

Gazetari saudit Jamal Khashoggi, i cili vdiq më 2 tetor, pas hyrjes në konsullatën e vendit të tij në Stamboll, mund të ketë regjistruar me Apple Watch momentin e torturimit dhe vrasjes së tij. Gazeta turke "Sabah" shkruan se pajisja është sinkronizuar me smartfonin e gazetarit, që e posedon gruaja e tij. Khashoggi ka aktivizuar funksionin e regjistrimit në telefon para se të hynin zyrtarët sauditë. Edhe burime nga hetuesit kanë konfirmuar për Reuters se gazetari kishte një Apple Watch të zi kur ai hyri në konsullatë. Ndërkohë "Sabah", që citoi "burime të besueshme" ka rindërtuar veprimet e agjentëve të inteligjencës saudite. "Agjentët e Rijad, e kanë kuptuar pas vdekjes së Khashoggi se ora kishte regjistruar vrasjen dhe ata janë përpjekur për të hyrë në qarkun e saj dhe për këtë përdorën shenjat e gishtave të tij. Ata donin të zhbllokonin dhe fshinin disa fotografi, por jo të gjitha", shkruan media turke. Por, rindërtimi nuk merr parasysh faktin se Apple Watch, ndryshe nga iPhone, nuk e ka funksionin e zhbllokimit me shenjat e gishtave dhe këtu Rijadi zyrtar ka gjetur alibinë për t'u mbrojtur duke i cilësuar mashtrimet ato çka publikohen në mediat turke. Ministri i Brendshëm saudit, Abdulaziz bin Saud bin Naif bin Abdulaziz, hodhi poshtë si "gënjeshtra të pabaza" rindërtimin e zhdukjes së Jamal Khashoggi, sipas të cilit gazetari saudit u vra nga agjentët e shërbimeve sekrete të Riadit në konsullatën e Mbretërisë në Stamboll.

Papa shkarkon dy priftërinj pedofilë

Papa Françesku ka shkarkuar nga detyra dy peshkopë në Kili për shkak të akuzave për abuzim seksual ndaj të miturve. Vatikani bëri publik njoftimin për peshkopët Francisco Jose Cox Huneeus dhe Marco Antonio Ordenes Fernandez pas takimit me presidentin e Kilit. "Nuk mund të bëhet ankesë

mbi këtë vendim", u tha në njoftim. Më shumë se 100 klerikë katolikë po hetohen në Kili pasi akuzohen për abuzime seksuale. Të 34 priftërinjtë e Kilit kishin ofruar dorëheqjen në maj pas skandalit. Në shtator Papa shkarkoi nga detyra priftin Fernando Karadima, 88 vjeç për abuzim me të mitur.



Kosova vë në lëvizje Vuçiçin, paralajmërohet ofensivë diplomatike

Çështja e arritjes së marrëveshjes finale me Kosovën e ka vënë në lëvizje presidentin serb, Aleksander Vuçiç. Siç raportojnë mediat e Beogradit, Vuçiç deri në fund të këtij viti pritet që të takohet me figura të larta të shteteve të ndryshme për të kërkuar mbështetjen në lidhje me çështjen e Kosovës.

Ashtu siç bëhet e ditur, javën e ardhshme presidenti austriak, Alexander Van Der Belen, do të qëndrojë për një vizitë zyrtare në Serbi ku do të takohet me homolo-

gun serb, Aleksander Vuçiç. Austria njihet si përkrahje e fuqishme e pavarësisë së Kosovës. Vuçiç pritët që në janar të takohet edhe me homologun e tij rus, Vladimir Putin. Brenda kësaj periudhe, sipas raportimeve ai pritët që në Beograd të takohet edhe presidentin francez, Emanuel Macron. Presidenti serb në lidhje me çështjen e Kosovës, ekonomisë dhe interesave tjera të përbashkëta shtetërore, pritët që të takohet edhe me presidentin turk, Tayyip Erdogan. E

në bazë të raportimeve të mediave serbe, takim pritët të zhvillohet edhe me kancelarin austriak, Sebastian Kurz. Kujtojmë se në takimin e kaluar mes Vuçiç dhe Putin, temë diskutimi ishte edhe çështja e Kosovës.

Ndërkaq, si temë më e përfolur e ditëve të fundit është edhe mundësia e korrigjimit të kufijve si pjesë e marrëveshjes finale mes Kosovës dhe Serbisë, si dhe qëndrimet e fuqive botërore në lidhje me këtë.



ÇFARË U THA NË GJYQIN DISAMINUTËSH TË ELENA DHE NIKOLAE ÇAUSHESKUT

PAK PARA EKZEKUTIMIT

Elena dhe Nikolae Çausheku u larguan nga Bukureshti me helikopter në 22 dhjetor të vitit 1989, pasi tubimi i thirrur nga regjimi u shndërrua shpejt në një revoltë të hapur kundër diktatorit komunist të Rumanisë. Por piloti u ul shpejt, duke pretenduar se ata rrezikonin të qëllueshin dhe rrëzoheshin. Çifti më pas rrëmbeu një makinë, por shpejt u njohën, ndoqën dhe u kapën nga policia lokale në Tërgovishte. Një gjyq i shkurtër u zhvillua në 24 dhjetor ndërsa në fund të tij Elena dhe Nikolae Çausheku u ekzekutuan. Më poshtë është një përmbledhje e transkriptit të gjyqit të shkurtër.

Nikolae Çausheku: Unë njoh vetëm Asamblenë e Madhe Kombëtare. Do të flas vetëm para saj.

Prokurori: Në të njëjtën mënyrë që refuzoi të mbajë një dialog me popullin, nuk do të flasë me ne. Ai pohonte gjithmonë se vepronte dhe fliste në emër të popullit, por në fakt vetëm sa e ka tiranizuar popullin gjatë gjithë kohës. Ju ballafaqoheni me akuzat e festimeve tepër kush-tueshme në shtëpinë tuaj. Këta dy të pandehur, blinin ushqime dhe rrobat më të shtrenjta jashtë vendit. Ata ishin edhe më keq se mbreti i mëparshëm të Rumanisë. Njerëzit merrnin vetëm 200 gramë bukë në ditë.

Kryeprokurori: Të pandehurit Nikolae dhe Elena Çausheku kanë kryer veprat e mëposhtme: krime kundër popullit. Ata kanë ndër-marrë akte, që janë të papajtuësme me dinjitetin njerëzor dhe të menduarit social; ata vepruan në mënyrë despotike dhe penale; ata shkatërruan njerëzit, liderët e të cilëve pretendonin se ishin. Për shkak të krimeve kundër popullit, unë kërkoj në emër të viktimave, që këta dy tiranë të dënohet me vdekje.

Prokurori: A i dëgjuat akuzat?

Nikolae Çausheku: Unë do të përgjigjem vetëm përpara Asamblesë së Madhe Kombëtare. Nuk e njoh këtë gjykatë.

Prokurori: Kjo situatë është e njohur. Gjendja katastrofike e vendit është e njohur në të gjithë botën. Çdo qytetar i ndershëm që ka punuar shumë deri në 22 dhjetor e di se ne nuk kemi ilaçe, se ju të dy keni vrarë fëmijë dhe njerëz të tjerë në këtë mënyrë, se nuk ka asgjë për të ngrënë, nuk ka ngrohje, as energji elektrike.

Prokurori: Kush e dha urdhrin për të shtënë në Bukuresht?

Çausheku: Unë nuk përgjigjem.

Prokurori: Kush urdhëroi të shtënë ndaj turmës? Flisni!

Në atë moment Elena i thotë Nikolaes: Harrojini ata. E shikon, nuk ka asnjë vlerë për të biseduar me këta njerëz.

Prokurori: Nuk dini asgjë rreth urdhrin për të qëlluar?

Nikolae reagon me habi: Unë s'do t'i përgjigjem çdo pyetje. Nuk pati asnjë të shtënë të vetme në Sheshin e Pallatit. Askush nuk u qëllua.

Prokurori: Deri tani ka patur 34



Ishte ngjarja që me siguri shërbeu si orteku që vuri përpara regjimet komunistë dhe përshpejtoi ndryshimet e regjimeve në Europën juglindore. Shumëkush ia atribuon pikërisht kësaj ngjarjeve, edhe ndryshimin e butë në Shqipëri, mospërdorimin e dhunës nga krerët e regjimit, të cilët druhashin se mos pësonin fundin e Nikolae Çaushekut në Rumani

viktima.

Elena thotë: Esheh, dhe këtë ata e quajnë gjenocid.

Prokurori: Në të gjitha lagjet e kryeqytetit, të shtënë vazhdojnë ende. Njerëzit ishin skllevër. E gjithë inteligjenca e vendit u largua. Askush nuk donte të kishte të bënte me ju.

Nikolae Çausheku: Unë do të përgjigjem për çdo pyetje, por vetëm para Asamblesë së Madhe Kombëtare dhe përfaqësuesve të klasës punëtore.

Prokurori: Bota tashmë e di se çfarë ka ndodhur këtu.

Çausheku: Unë nuk do t'iu përgjigjem puçistëve.

Prokurori: Asambleja e re Kombëtare është zgjedhur.

Çausheku: Kjo s'është e mundur. Askush nuk mund ta shpërndajë Kuvendin Kombëtar.

Prokurori: Ne tani kemi një tjetër organ udhëheqës. Fronti i Shpëtimit Kombëtar, është tani organi ynë suprem.

Çausheku: Askush nuk e pranon atë. Kjo është arsyeja pse njerëzit janë duke luftuar në të gjithë vendin. Kjo bandë do të shkatërron. Ata organizuan puçin.

Prokurori: Populli po lufton kundër jush, jo kundër organeve të reja.

Çausheku: Jo, njerëzit po luftojnë për lirinë dhe kundër organeve të reja. Unë nuk e njoh këtë gjykatë.

Prokurori kërkon nga avokatët të pyesin Çaushekun, nëse e di që nuk është më presidenti i vendit, dhe se edhe Elena Çausheku i ka humbur të gjitha funksionet e saj zyrtare, ndërsa qeveria komuniste është shpërbërë.

Çausheku: Unë jam presidenti i Rumanisë, dhe komandant suprem i ushtrisë rumune. Askush nuk mund të më privojë nga këto funksione.

Prokurori: Por jo i ushtrisë sonë.

Çausheku: Po e përsëris: Unë nuk flas me provokatorë, organizatorët e puçit dhe me mercenarët. Unë nuk kam të bëj me ta.

Prokurori: Ju keni folur gjithmonë mbi barazinë. Tani së fundmi pamë vilën tuaj në televizion, pjatat e arta ku ju hanit, ushqimet që kishit importuar nga jashtë, festimet luksoze, foto nga festimet tuaj luksoze.

Elena Çausheku: E pabesueshme! Ne jetojmë në një apartament normal, ashtu si çdo qytetar tjetër.

Prokurori: Le të flasim për llogaritë bankare në Zvicër, zoti Çausheku...

Çausheku: Ne nuk kishim llo-

gari në Zvicër. Kjo tregon edhe një herë se sa të rreme janë akuzat. Çfarë shpifjesh, çfarë provokimesh! Ky është një grusht shteti.

Prokurori: E pra, nëse nuk keni llogari në Zvicër, do të nënshkruani një deklaratë që konfirmon se paratë që mund të jenë në Zvicër, duhet të transferohen në Rumani tek Banka e Shtetit.

Çausheku: Jo, jo. Unë s'kam asnjë deklaratë për të bërë, dhe unë nuk do të nënshkruaj asgjë të tillë.

Prokurori i kthehet Elenës: Ju keni qenë gjithmonë më e mençur dhe më e gatshme për të folur, një shkencëtare. Ju keni qenë ndihmë-sja më e rëndësishme, numri dy në qeveri. A dini gjë mbi gjenocidin në Timisoara?

Elena Çausheku: Çfarë gjenocidi? Meqë ra fjala, unë nuk do t'i përgjigjem më asnjë pyetje.

Prokurori: A keni dijeni mbi gjenocidin, apo si një kimiste merreni vetëm me polimere?

Këtu Nikolae Çausheku ngrihet në këmbë dhe e mbron: Artikujt e saj shkencorë janë botuar jashtë vendit!

Prokurori: Dhe kush i shkruante artikujt për ju Elena?

Elena Çausheku: Ç'janë këto paturpësi! Unë jam anëtare dhe kryetare e Akademisë së Shkencave. Ju s'mund të bisedoni me mua në këtë mënyrë!

Prokurori: Kjo do të thotë, se si zëvendëskryeministre nuk dini gjë në lidhje me gjenocidin?

Nikolae Çausheku: Ju si oficerë duhet të dini se qeveria nuk mund të japë urdhra për të qëlluar. Por ata që qëlluan mbi të rinjtë ishin njerëzit e sigurisë, terroristët.

Elena Çausheku: Terroristët janë nga Securitate.

Prokurori: Dhe kush e drejtonte Securitate-n? Një pyetje tjetër. Ju lutem avokat, e pyesni Nikolae dhe Elena Çaushekun nëse kanë patur ndonjëherë ndonjë sëmundje mendore.

Çausheku: Ky është një provokim i turpshëm.

Prokurori: Kjo do t'i shërbente mbrojtjes tuaj. Nëse ju keni patur një sëmundje mendore dhe e pranoi këtë, nuk do të jeni përgjegjës për veprimet tuaja.

Çausheku: Unë nuk e njoh këtë gjykatë.

Prokurori: Ju nuk keni qenë kurrë i aftë të zhvilloni një dialog me popullin. Ju s'keni folur kurrë me njerëzit. Ju mbanit monologje dhe njerëzit detyroheshin t'iu duartrokisnin, si në ritualet e popujve fisnorë. Dhe sot po veproni me të njëjtën mënyrë megalomaniake.

Gjykata mbyll gjykimin dhe më pas lexohet aktakuza.





KOMUNA E SARAJIT
SH.PALLJE nr. 4/2018

për tjetërsim të tokës ndërtimore pronësi e Republikës së Maqedonisë të ankandit publik elektronik në Komunën e Sarajit

LËNDA E ANKANDIT PUBLIK ELEKTRONIK

Lënda e ankandit publik elektronik është toka ndërtimore e pa ndërtuar, pronësi e Republikës së Maqedonisë, e paraparë me DOKUMENTACION TË PLANIT LOKAL URBANISTIK për pjesë nga PK 10466, PIJES NGA PK 10468, pjesë nga 10469, pjesë nga PK 10470, PK 10471, PK 10472 dhe pjesë nga PK 10473/1, me dedikim: Industria e lehtë (G2) me objekte përcjellëse – Prodhimtari të mjeteve për industri ekologjike KK Saraj Komuna e Sarajit, e miratuar me vendim nga Kryetari i komunës së Sarajit nr. 08-813/16 nga 08.11.2016, me dedikim të ndërtimit G2 – industri e lehtë dhe e pa ndotshme, me klasë kompatible të dedikuar B1 deri 30%, B2 deri 30%, B4 deri 10%, D3 deri 30%, G3 deri 30% dhe G4 deri 30% - në pajtim me kontrollin tabelarik në të cilin janë të dhënat: numri i parcelës ndërtimore, dedikimi i parcelës ndërtimore, numri i parcelave kadastrale të përmbyllura me parcelë kadastrale, sipërfaqja e përgjithshme e parcelës kadastrale, sipërfaqja e ndërtimit, sipërfaqja e zhvilluar bruto, lartësia maksimale deri në kurorën dhe katet, çmimi fillestar në m2, çmimi fillestar i përgjithshëm dhe depozitimi për pjesëmarrje të ankandit publik.

Rishikimi Tabelarë:

Numri i parcelës ndërtimore.	Dedikimi i ndërtimit në parcelën ndërtimore	Nr i parcelës kadastrale KK Saraj	Sipërf. E parc.ndërtimore (m ²)	Sipërfaqja e ndërtimit (m ²)	Përq. E ndërtimit (%)	Koefic. i shfrytëzimit.	Sipërf.bruto e zhvilluar (M ²)	Lartësia maksimale për ndërtimin nga niveli i trotuari mbrojtës deri në kurorë	çmimi fillestarë në m2 në denarë	Çmimi fillestar i përgjithshëm	Garancioni banker për seriozitetin e ofertës
P.N nr.1	G2	PK 10467/1 PK 10468/1 PK 10469/1 PK 10471/1 PK 10466/1 PK 10466/2 PK 10470/1 PK 10473/1 PK 10472/1 PK 13617/7	15004	6373	42,05	0,49	7300	TP,P+1	61.00	915.244,00	1.065.284,00

TË DREJTË PËR PJESEMARRJE

Të drejtë për pjesëmarrje kanë:

1. Personat fizik: shtetas të Republikës së Maqedonisë, shtetas të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian dhe në OECD, si dhe shtetas të cilat nuk janë anëtare të bashkimit Evropian dhe në OECD a në kushte të reciprocitetit mund të arin të drejtë të pronësisë në tokë ndërtimore në territorin e Republikës së Maqedonisë.
2. Personat juridik:personi juridik vendor, personi juridik në pronësi të përzier, personi juridik i themeluar nga personi fizik dhe juridik i jashtëm, të regjistruar në regjistrin Qendrorë në Republikën e Maqedonisë, Personat juridik të huaj rezident të shteteve anëtare të bashkimit Evropian dhe në OECD, Si dhe persona juridik të huaj rezident të cilat nuk janë anëtare të shteteve të Bashkimit Evropian dhe në OECD të cilat në kushte të reciprocitetit mund të arin të drejtë të pronësisë në tokë ndërtimore në territorin e Republikës së Maqedonisë.

KUSHTET PËR PJESEMARRJE NË ANKANDIN PUBLIK ELEKTRONIK

Personat e interesuar fizik dhe juridik parashtrojnë paraqitjen për pjesëmarrje të ankandit publik (në formë elektronike, në www.gradezno-zemiiste.mk në të cilën është e potencuar se në cilën parcelë ndërtimore drejtohet paraqitja dhe cilat dokumentacione janë pjesë përbërëse të paraqitjes.) dëshmitë vijuese të kompletuara:

1. Paraqitja nga dorëzuesi, nga të cilat janë të potencuara të dhënat për dorëzuesin e paraqitjes;
2. Garancion Bankar për seriozitet të ofertës (garancioni bankarë për pjesëmarrje në ankandin publik elektronik për parcelat ndërtimore dorëzohet edhe në formë të shkruar në original deri te Komuna e Sarajit – rr.„Qendra rekreative” nr. 5, Shkup, më së vonti deri në kalimin e afatit për dorëzim të paraqitjes për pjesëmarrje në ankand publik. Dorëzuesve të paraqitjes për pjesëmarrje në ankand publik të cilët nuk do të dorëzojnë garancion bankarë në formë të shkruar në original nuk do të lejohet pjesëmarrje në ankand publik.).
3. persona fizik vërtetim për nënshtetësinë;
4. Për persona juridik dëshmi për regjistrim të personit juridik nga regjistri kompetent;
5. E –mail adresë të dorëzuesit të paraqitjes, përmes së cilës do të kryhet procedura e regjistrimit për pjesëmarrje në ankand publik elektronik, respektivisht do t'ju dorëzohen emri i shfrytëzimit dhe shifra për qasje në faqen e internetit në të cilën do të zhvillohet ankand publik elektronik. (Për dorëzues të paraqitjeve të cilët do të dorëzojnë e-mail adresë të gabuar, Komuna e Sarajit nuk ka obligim të pranojë dhe kryejë korrigjim të së njëjtës).
6. Ofertuesi më i volitshëm i zgjedhur obligohet që t' mbulojë edhe harxhimet e veçanta të procedurës edhe atë:
 - Harxhime për sigurim të dëshmitë për tokën ndërtimore lëndë e ankandit publik;
 - Harxhime për shpallje në medime dhe gazetatat publike;
 - Harxhime për këqyrje në vend ngjarje dhe konstatimin e gjendjes faktike dhe për fillimin e pronësisë të tokës ndërtimore.
 Lartësia harxhimet e lartpërmendura është 10% nga vlera e garancionit bankarë për seriozitetin e ofertës dhe e njëjta paguhet me virman ose përmes postës në Komunën e Sarajit, llogaria depozitare 781014116569614, shifra e të ardhurave 733111 programi 00 me mbishkrim " harxhime të veçanta të procedurës për ankand publik për tjetërsim të tokës ndërtimore ", për parcelën ndërtimore nr. PN1.

Paraqitjet të cilat nuk janë të kompletuara me këto dëshmi nuk do të marrin pjesë në ankandin publik elektronik për çka parashtroesit e paraqitjeve jo të kompletuara do të njoftohen në formë elektronike.

KUSHTET E VEÇANTA PLOTËSUESE

1. Shuma minimale nga të ardhurat e përgjithshme në vitin financiar të personit fizik të cilët do të paraqiten për pjesëmarrje në ankandin publik, respektivisht të themeluesit të personit juridik, përderisa personi juridik i cili do të paraqitet për pjesëmarrje në ankandin publik është person juridik i regjistruar në Republikën e Maqedonisë, themeluar nga ana e personit juridik të huaj, të jetë mbi 400.000.000 denarë. Për dëshminë e këtij kushti dorëzohet bilanc i gjendjes dhe bilanc i suksesit dhëtur nga organi kompetent ose bilanc i revidues në sukses i vërtetuar nga shtëpia e revizionit të autorizuar.
2. Minimum 50 persona të punësuar në personin juridik i cili do të marrë pjesë në ankandin publik, respektivisht të themeluesit të personit juridik, përderisa personi juridik i cili do të paraqitet për pjesëmarrje në ankandin publik është person juridik i regjistruar në Republikën e Maqedonisë, themeluar nga personi juridik i jashtëm. Për dëshminë e këtij kushti dorëzohet dëshmi për numrin e të punësuarve i dhënë nga organi kompetent.
3. Numri i personave të cilët do të punësohen pas mbarimit të objektit afaristë është minimum 20.

ÇMIMI FILLESTAR

Çmimi fillestar në ankandin publik elektronik për parcelat ndërtimore është e theksuar në kontrollin tabelorë dhe përbëhet prej 61 denarë në metër katrorë.

AFATET PËR PARASHTRIMIN E FLETËPARAQITJEVE

Fletëparaqitjet për pjesëmarrje në ankandin publik mund të dorëzohen deri më 13.11.2018, në formë elektronike në adresë vijuese: www.gradezno-zemiiste.mk
Ankandit publik do të mbahet në formë elektronike në faqen vijuese të internetit www.gradezno-zemiiste.mk

Ankandit publik për PN1 do të fillon në 16.11.2018, në ora 09.30
Dhe i njëjti do të zgjatë 15 minuta.

Ankandit publik për çdo parcelë ndërtimore nga rishikimi i njëanshëm tabelarë , vazhdojnë për 2 minuta deri atëherë kur në 2 minutat e fundit nga ankandit ka ofertë të re.
Një ofertues mund të jetë pjesëmarrës me ofertë në një ose më shumë parcela, ose në të gjitha parcelat nga shpallja.

PROCEDURA

1. Komisioni i njofton parashtroesit e fletëparaqitjeve për kompletimin e të njëjtave në formë elektronike, në afat prej 24 orë pas mbarimit të afatit për parashttrimin e të njëjtave, nga çka parashtroesve të fletëparaqitjeve që kanë dorëzuar dokumentacion të kompletuar ju dorëzohet edhe emër shfrytëzimi dhe shifër për pjesëmarrje në ankand publik elektronik, parashtroesve të fletëparaqitjeve që nuk kanë dorëzuar dokumentacion të kompletuar ju dorëzohet njoftim me arsyetim se të njëjtit nuk do të marrin pjesë në ankandin publik;
2. Në ditën e mbajtur të ankandit publik elektronik pjesëmarrësit kanë qasje në faqen elektronike me emrin shfrytëzues dhe shifër të cilën e marrin në e-mail adresën, e dorëzuar në shtojcë të paraqitjes për pjesëmarrje në ankandin publik;
3. Ankandit publik elektronik mund të fillon me më pak një pjesëmarrës në ankandin publik, për çdo parcelë ndërtimore në veçanti;
4. Ankandit publik elektronik e ndjek Komisioni, i formuar nga Kryetari i komunës së Sarajit;

5. Ankandit publik elektronik fillon me shpallje të çmimit fillestar të tokës me metër katrorë, a miratohet në mënyrë të ankandit nga ana e pjesëmarrësve;
6. Ankandit kryhet " hap pas hapi" me rritje të vlerës për çdo "hap" dhe atë:
 - për parcelat ndërtimore me dedikim G2- Industri e lehtë jo më pak se 10,0 denarë/m2;
7. Ankandit publik elektronik llogaritet si l kryer në momentin e kalimit të kohës l përcaktuar me këtë shpallje, me çka derisa në kalimin e 2 minutave të fundit nga ana e paraqitësve është dhënë ofertë, afati i fundit për kryerje të ankandit publik vazhdohet edhe për di minuta a do të mbaroj kur në periudhë nga di minutat e ardhshme nuk ka ofertë të re të ofruar. Ankandit publik vazhdon pakufi deri atëherë kur në intervallin kohorë pre di minutave ka ofertë të re.
8. Për ofertues më të volitshëm për metër katror llogaritet pjesëmarrësi i cili në ankandin publik ka dhënë ofertë me çmimin e fundit, i cili paraqet çmimin më të lartë për tjetërsim të tokës ndërtimore;
9. Komisioni pas mbarimit të ankandit publik përgatitë procesverbal për ankandin publik që është zhvilluar dhe në mënyrë elektronike e dërgon tek të gjithë pjesëmarrësit në ankandin publik;
10. Pas mbarimit të procedurës së ankandit publik Komisioni është l obliguar në afat prej tre ditë pune të dorëzojë kërkesë për mendim deri tek Prokuroria e përgjithshme shtetërore e Republikës së Maqedonisë në lidhje me draft-tekstin për marrëveshjen për tjetërsim të tokës ndërtimore në pronësi të Republikës së Maqedonisë Në afat prej 30(tridhjetë) ditësh nga dita e arritjes së kërkesës për mendim. Në rast se në afat prej 30(tridhjetë) ditësh Prokuroria e përgjithshme shtetërore e Republikës së Maqedonisë nuk na dorëzon mendim, do të llogaritet për pozitive;
12. Pas marrjes së mendimit pozitiv nga Prokuroria e përgjithshme shtetërore e Republikës së Maqedonisë, Komisioni në afat prej tre ditësh deri tek ofertuesi më o volitshëm dërgon informim me shkrim për zgjedhje të ofertuesit më të volitshëm;
13. Ofertuesi më l volitshëm në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga marrja e informimit për zgjedhje të ofertuesit më të volitshëm është l obliguar që të bëjë pagesën e mjeteve dhe deri tek Komisioni të dorëzojë dëshmi për pagesën e realizuar me tërë dokumentacionin e nevojshëm për pjesëmarrje në ankandin publik;
14. Ofertuesi më l volitshëm në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga pranimi l informimit për zgjedhje të ofertuesit më të volitshëm është l obliguar të bëjë pagesën e mjeteve për shpenzime të veçanta në procedure e tjetërsimit të tokës ndërtimore nëpërmjet ankandit publik, në lartësi prej 10% nga vlera e provizionit banker për seriozitet të ofertës;
15. Në rast se ofertuesi më i volitshëm nuk e bën pagesën e mjeteve në afatin e caktuar, do të llogaritet se toka ndërtimore nuk është tjetërsuar, nuk do të kalohet në përfundim të marrëveshjes dhe garancia bankare për seriozitet të ofertës do të aktivizohet dhe i njëjti nuk do të mund të marrë pjesë në çdo ankand publik tjetër në të ardhmen për parcelën ndërtimore në fjalë;
16. Në qoftë se ofertuesi më i volitshëm e bën pagesën e mjeteve në përfundim të çmimit e fundit të ankandit në afatin e caktuar dhe në bazë të dokumentacionit të dorzuar nuk mund të arrihet marrëveshje, mjetet e paguara për tjetërsim të tokës ndërtimore ofertuesit më të volitshëm nuk i kthehen, garanca bankare për seriozitet të ofertës aktivizohet dhe nuk do të ketë qasje në arritjen e marrëveshjes;
17. Në afat prej 5 (pesë) ditë pune pas dorëzimit të dëshmisë për pagesën e bërë dhe dorëzimit të dokumentacionit të përgjithshëm i nevojshëm për pjesëmarrje në ankand, Kryetari i komunës së Sarajit në emër të Republikës së Maqedonisë arrinë marrëveshje për tjetërsim të tokës ndërtimore në pronësi të Republikës së Maqedonisë;
18. Pas arritjes së marrëveshjes, komuna e Sarajit në afat prej një dite, në mënyrë elektronike e dorëzon kontratën deri tek Njësia për tatime lokale dhe taksa për caktim të tatimit të fitimit të patundshmëri. Blerësi është l obliguar që në afat prej 15(pesëmbëdhjetë) ditësh nga marrja e vendimit për caktim të tatimit të fitimit të patundshmëri që ta paguaj tatimin dhe të dorëzojë dëshmi për pagesën e realizuar;
19. Pas dorëzimit të dëshmisë për pagesën e realizuar të tatimit të fitimit të patundshmëri, blerësi në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh marrëveshjen në mënyrë elektronike e dorëzon tek noter i autorizuar për ta bërë solemnizimin. Blerësi është l obliguar solemnizimin ta bëjë në afat prej 30(tridhjetë) ditësh nga dorëzimi i kontratës tek noter i autorizuar;
20. Mos plotësimi i obligimeve nga pika 17, 18 dhe 19 nga kjo shpallje me faj të blerësit paraqet bazë për prishje të kontratës së njëanshme për çka 80% nga shuma e përgjithshme e tjetërsimit nuk l kthehet blerësit;
21. Me marrëveshjen ofruesi më i volitshëm(blerësi) obligohet të sigurojë leje për ndërtim të objektit të paraparë në afat prej 12(dymbëdhjetë) muajve nga realizimi i solemnizimit të po të njëjtit ku si mjet l kontratës është parcela ndërtimore me hapësirë mbi 5000 m2 dhe është l obliguar që ta ndërtojë objektin në pajtim me planin urbanistik nëpërmjet të cilit toka është tjetërsuar, në afat jo më gjatë se 2(dy) vjet nga marrja e lejes së plotfuqishme për ndërtim të objektit me bruto hapësirë të ndërtuar deri 1000m2 në pajtim me lejen e marrur për ndërtim, respektivisht në afat jo më gjatë se 4(katër) vjet nga marrja e lejes së plotfuqishme për ndërtim të objekteve me hapësirë bruto për ndërtim mbi 1000 m2 në pajtim me lejen e fituar për ndërtim. Në të kundërtën, në rast se blerësi nuk nxjerr leje për ndërtim në afatin e paraparë, respektivisht në rast se objekti nuk është ndërtuar në afatin e paraparë me faj të blerësit, i njëjti do të ketë obligim të paguaj dënimin e caktuar prej 1.5% të çmimit të arritur në ankandin publike tokës në fjalë për secilin muaj të kaluar në vitin e pare nga kalimi i afatit , respektivisht 3% nga çmimi l arritur në ankandin publik të tokës në fjalë për secilin muaj të kaluar në vitin e dytë nga afati l kaluar, respektivisht 4,5% nga shuma e përgjithshme e çmimit e arritur në ankandin publik e tokës në fjalë për secilin muaj të kaluar në vitin e tretë dhe secilit vit me radhë nga skadimi i afatit. Mosplotësimi i këtyre obligimeve, respektivisht pas rënies së blerësit në vonesë të plotësimit të këtyre obligimeve tre muaj me radhë, paraqet bazë që tjetërsuesi pas tre muajve thirrje të njëpasnjëshme për realizim, si kreditor me deklaratë për mosplotsim të obligimeve nga kontrata të kërkojë vërtetim për realizim të kontratës , respektivisht të kërkojë pagesën e dënimit kontraktues i cili paraqet edhe bazë për prishje të njëanshme të kontratës , prej çka 80% nga shuma e përgjithshme e tjetërsimit nuk l kthehen blerësit;
22. Përqindja minimale e cila duhet të ndërtohet nga gjithsej hapësira e zhvilluar për ndërtim e paraparë me planin urbanistik për lëndën e parcelës ndërtimore, nuk duhet të jetë më e vogël se 30%;
23. Ofertuesi më i volitshëm është l obliguar që ta paguaj tatimin e fitimit i cili do të del si obligim pas marrëveshjes së arritur për tjetërsim të tokës ndërtimore;
24. Në çmimin e tokës ndërtimore nuk është përfshirë kompensimi për rregullim të tokës ndërtimore;
25. Shpenzimet për procedurën materiale dhe paraqitjen në evidencën e patundshmërive në Agjencionin për kadastrë të patundshmërive bien në ngarkesë të blerësit të tokës ndërtimore.
26. Pronari i tokës ndërtimore të fituar në procedure për tjetërsim nëpërmjet ankandit publik nuk i lejohet të njëjtin që ta transferojë në persona të tretë, para plotësimit të obligimeve të kontraktuara për tjetërsim të së njëjtës. Ndaleza për transferim tek persona të tretë regjistrohet në librin publik për regjistrim e të drejtave të patundshmërisë;
27. Pjesëmarrësit e pakënaqur në ankandin publik mund të deklarojnë kundërshtim deri tek Komisioni në afat prej 3(tre) ditësh nga dita e mbajtjes së ankandit publik në mënyrë elektronike. Kundërshtimi dorëzohet në formë të shkruar deri tek Komisioni i cili vendosë për kundërshtimin me vendim. Komisioni është l obliguar të vendosë për kundërshtimin në afat prej pesë ditë pune nga pranimi i të njëjtit.
28. Kundër vendimit të sjellë nga ana e komisionit, me të cilin vendoset për kundërshtimin e paraqitur, pala ka të drejtë të paraqesë ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të vendimit deri tek Komisioni shtetëror që vendosë për procedurë administrative dhe procedurë për marrëdhënie pune në shkallë të dytë.

[Kjo shpallje do të jetë e publikuar edhe në WEB faqen e Komunës së Sarajit ww.sara.gov.mk](http://www.sara.gov.mk)

Komisioni për realizim të procedurës për ankand publik të tokës ndërtimore në pronësi të Republikës së Maqedonisë

Komuna e Sarajit



REPUBLIKA E MAQEDONISË
AGJENCIA E ADMINISTRATËS

Në bazë të nenit 35 të Ligjit të Nëpunësve Administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/14, 199/14, 48/15, 154/15, 5/16, 142/16 dhe 11/18) dhe Rregullores së mënyrës së zbatimit të procedurës për punësim të nëpunësve administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/18), lidhur me nenin 20-g të Ligjit të punësuarve në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/14, 199/14, 27/16 dhe 35/18) dhe Rregullores së elementeve të obligueshme të shpalljes publike të plotësimit të vendit të punës në sektorin publik përmes punësimit dhe fletëparaqitjes për punësim, si dhe të formës, përmbajtjes dhe mënyrës së mbajtjes së regjistrit të personave që kanë dhënë të dhëna të rrejshme gjatë punësimit në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 34/15), Agjencia e Administratës publikon

SHPALLJE PUBLIKE NUMËR – 211/2018

për punësimin e 6 nëpunësve shtetëror nga grupi I, nëngrupi I në „Komunën e Kërçovës” për vendet e punës në vijim:

1. UPR0101V04000 Bashkëpunëtor më i ri për sigurimin e dokumentacionit teknik dhe të tjerë për furnizime publike, Njësia për furnizime publike I realizues(ë)
- Kushtet e posaçme:**
- niveli i kualifikimeve VI B sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, informatikë
 - me ose pa përvojë pune
- Kompetencat e përgjithshme:**
- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
 - mësim dhe zhvillim
 - komunikim
 - arritje të rezultateve
 - puna me të tjerë/puna ekipore
 - ndërgjegjësim strategjik
 - orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
 - menaxhim financiar
- Kompetenca të posaçme:**
- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
 - njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)
- Orari i punës :**
- Ditët e punës e hënë - e premte
 - Orët javore të punës 40
 - Orari ditor i punës 08:00 - 16:00
 - Rroga neto: 19.725,00 denarë
- VËREJTJE:** Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Shqiptar(e) 1.
2. UPR0101V04000 Bashkëpunëtor më i ri - administrator IT, Njësia për urbanizëm dhe planifikim hapsinor, Sektori për urbanizëm dhe planifikim hapësinor, zhvillim ekonomik lokal dhe mbrojtje të mjedisit jetësor I realizues(ë)
- Kushtet e përgjithshme:**
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
 - Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
 - Të jetë i moshës madhore,
 - Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
 - Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.
- Kushtet e posaçme:**
- niveli i kualifikimeve VI B sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, shkencat ekonomike, shkencat juridike ose administrim publik dhe administratë
 - me ose pa përvojë pune
- Kompetencat e përgjithshme:**
- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
 - mësim dhe zhvillim
 - komunikim
 - arritje të rezultateve
 - puna me të tjerë/puna ekipore
 - ndërgjegjësim strategjik
 - orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
 - menaxhim financiar
- Kompetenca të posaçme:**
- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
 - njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)
- Orari i punës :**
- Ditët e punës e hënë - e premte
 - Orët javore të punës 40
 - Orari ditor i punës 08:00 - 16:00
 - Rroga neto: 19.725,00 denarë
- VËREJTJE:** Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Shqiptar(e) 1.
3. INS0101V001000 Këshilltar për inspektor të autorizuar të ndërtimit, Njësia për mbikëqyrjen e Inspektimit - Inspektorati Komunal I realizues(ë)
- Kushtet e përgjithshme:**
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
 - Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
 - Të jetë i moshës madhore,
 - Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
 - Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.
- Kushtet e posaçme:**
- niveli i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi sipas ECTS, ose të kryer shkallën VII/1, arkitekturë, urbanizëm dhe planifikim ose ndërtimtari dhe ekonomia e ujit
 - së paku 3 (tre) vjet përvojë pune në profesion
- Kompetencat e përgjithshme:**
- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
 - mësim dhe zhvillim
 - komunikim
 - arritje të rezultateve
 - puna me të tjerë/puna ekipore
 - ndërgjegjësim strategjik
 - orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
 - menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)

Kushtet shtesë:

- Licencë për mbikëqyrje inspektimi

Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 08:00 - 16:00
- Rroga neto: 25.865,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Shqiptar(e) 1.

4. UPR0101G01000 Referent i pavarur - Roje Komunale, Njësia për mbikëqyrjen e inspektimit - Inspektorati Komunal 3 realizues(ë)

Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:

- niveli i kualifikimeve VA ose niveli i kualifikimeve IV, sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 ose 240 kredi sipas ECVET ose SMKAP ose së paku arsim të lartë ose të mesëm, gjimnaz, teknik elektrik ose teknik marketing komercial
- së paku 3 (tre) vjet përvojë pune në profesion

Kompetencat e përgjithshme:

- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- puna me të tjerë/puna ekipore
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)

Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 08:00 - 16:00
- Rroga neto: 15.181,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1, Shqiptar(e) 1, Rom(e) 1.

Kushtet e lartpërmendura në shpallje kandidatët duhet t'i plotësojnë në momentin e aplikimit në formë elektronike nëpërmjet profilit të përdoruesit të krijuar në faqen e internetit të Agjencisë së Administratës.

Afati i aplikimit zgjatë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e publikimit të shpalljes. Pas mbarimit të afatit për aplikim, shpallja do të jetë e larguar nga faqja e internetit e Agjencisë.

Pas kalimit të afatit të aplikimit, shpallja do të jetë e hequr nga faqja e internetit e Agjencisë.

Kandidatëve u kërkohet fletëparaqitjen ta plotësojnë në tërësi, të jenë precizë dhe të japin të dhëna të sakta. Kandidatët e paraqitur në shpalljen publike në faqen e internetit të Agjencisë së administratës do të informohen, për kohën dhe vendin e mbajtjes së çdo faze të ardhshme të procedurës për selektim të nëpunësit administrativ.

Faza e 1 – rë: selektimi administrativ realizohet në një afat prej 15 ditësh pas mbarimit të shpalljes së publikuar.

Faza e 2 – të: provimi i nëpunësit administrativ realizohet në një afat jo më të shkurtër se 10, dhe jo më të gjatë se 30 ditë pas mbarimit të fazës së 1 – rë. Ai incizohet dhe emetohet drejtpërdrejtë në faqen e internetit të Agjencisë së administratës.

Faza e 3 – të: kontrollimi i vërtetësisë së provave dhe intervista realizohet në një afat prej 10 ditësh pas mbarimit të fazës së 2 – të.



Në bazë të nenit 110, 114, 166, 172, 173, 174, 175, 176 dhe 182 të Ligjit për arsim sipëror, nenit 22 paragrafi 3 dhe nenit 23 të Ligjit për marrëdhënie pune dhe në bazë të Vendimeve të Këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit për shkencë të medicinës, Fakultetit filologjik, Fakultetit për turizëm dhe biznes logjistikë dhe Fakultetit të shkencave arsimore

UNIVERSITETI "GOCE DELLÇEV" SHTIP

Publikon
KONKURS

Për zgjedhje të mësimdhënësve të njësive në përbërje të Universitetit

1. FAKULTETI I SHKENCAVE TË MEDICINËS

1.1 Mësimdhënës në titullin titullar Docent titullar/profesor titullar me korrespondencë për sferën mësimore-shkencore:

-Fiziologjia - (1 realizues)

1.2 Mësimdhënës në titullin titullar Docent titullar/profesor titullar me korrespondencë për sferën mësimore-shkencore:

- Gjinekologjia dhe obstetrika - (1 realizues)

1.3 Mësimdhënës në titullin titullar Docent titullar/profesor titullar me korrespondencë për sferën mësimore-shkencore:

-Oftalmologjia - (1 realizues)

2. FAKULTETI FILOLOGJIK

2.1 Mësimdhënës në titullin titullar Profesor titullar me korrespondencë për sferën mësimore-shkencore:

- Makedonistika - (1 realizues)

3. FAKULTETI PËR TURIZËM DHE BIZNES LOGJISTIKË

3.1 Mësimdhënës në të gjitha titujt për sferën mësimore-shkencore:

- Ekonomika e sipërmarrjeve dhe Sipërmarrësi - (1 realizues)

3.2 Mësimdhënës në titullin titullar Docent titullar për sferën mësimore-shkencore:

-Ekonomika e turizmit dhe hotelierisë - (1 realizues)

4. FAKULTETI I SHKENCAVE ARSIMORE

4.1 Mësimdhënës në të gjitha titujt për sferën mësimore-shkencore:

- Pedagogjia dhe Arsimimi i mësimdhënësve - (2 realizues)

Kriteret për zgjedhje:

-në titullin mësimor-shkencor docent mund të zgjidhet personi i cili: 1. Ka realizuar sukses mesatar prej së paku 8,00 (tetë) në studimet e ciklit të parë dhe të dytë, për secilin cikël veç e veç, gjegjësisht ka realizuar sukses mesatar prej së paku 8,00 (tetë) në studimet e integruara të ciklit të parë dhe të dytë, 2. Ka shkallë shkencore doktor shkence nga sfera shkencore për të cilën zgjidhet, 3. Ka të publikuara së paku katër punime shkencore në publikim referent shkencor në pajtim me këtë ligj në pesë vitet e fundit para publikimit të shpalljes për zgjedhje, 4. Ka njohuri të së paku një gjuhe të huaj, të përcaktuar me aktin e përgjithshëm të universitetit, gjegjësisht të shkollës së lartë të pavarur profesionale dhe 5. Ka aftësi për realizimin e veprimtarisë për arsim sipëror. Kandidatët duhet të përmbushin edhe kushtet e përgjithshme të përcaktuara me Ligjin për marrëdhënie pune dhe kushtet e posaçme nga Rregullorja për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor dhe mësimor të Universitetit "Goce Dellçev" – Shtip.

-në titullin mësimor-shkencor profesor me korrespondencë mund të zgjidhet personi i cili: 1. Ka realizuar sukses mesatar prej së paku 8,00 (tetë) në studimet e ciklit të parë dhe të dytë, për secilin cikël veç e veç, gjegjësisht ka realizuar sukses mesatar prej së paku 8,00 (tetë) në studimet e integruara të ciklit të parë dhe të dytë, 2. Ka shkallë shkencore doktor shkence nga sfera shkencore për të cilën zgjidhet, 3. Ka të publikuar së paku pesë punime të recensuara shkencore në publikim referent shkencor, në pajtim me Ligjin për arsim sipëror në pesë vitet e fundit para publikimit të shpalljes për zgjedhje, 4. Ka qenë i zgjedhur më herët në titullin mësimor-shkencor docent dhe 5. Ka aftësi për realizimin e veprimtarisë për arsim sipëror. Kandidatët duhet të përmbushin edhe kushtet e përgjithshme të përcaktuara me Ligjin për marrëdhënie pune dhe kushtet e posaçme nga Rregullorja për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor dhe mësimor të Universitetit "Goce Dellçev" – Shtip.

-në titullin mësimor-shkencor profesor i rregullt mund të zgjidhet personi i cili: 1. Ka realizuar sukses mesatar prej së paku 8,00 (tetë) në studimet e ciklit të parë dhe të dytë, për secilin cikël veç e veç, gjegjësisht ka realizuar sukses mesatar prej së paku 8,00 (tetë) në studimet e integruara të ciklit të parë dhe të dytë, 2. Ka shkallë shkencore doktor shkence nga sfera shkencore përkatëse, 3. Ka të publikuar së paku gjashtë punime të recensuara shkencore në publikim referent shkencor, në pajtim me Ligjin për arsim sipëror në pesë vitet e fundit para publikimit të shpalljes për zgjedhje, 4. Ka qenë më herët i zgjedhur në titullin profesor

me korrespondencë dhe 5. Ka aftësi për realizimin e veprimtarisë për arsim sipëror. Kandidatët duhet të përmbushin edhe kushtet e përgjithshme të përcaktuara me Ligjin për marrëdhënie pune dhe kushtet e posaçme nga Rregullorja për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor dhe mësimor të Universitetit "Goce Dellçev" – Shtip.

-Shkencëtarët e afirmuar, profesionistët e praktikës dhe artistët të institucionit për arsim sipëror, të cilët i plotësojnë kushtet për zgjedhje në titull, ndërsa për të cilin nuk ka vend të lirë për zgjedhje në titullin mësimor-shkencor, gjegjësisht mësimdhënës mund të zgjidhen në titullin docent titullar dhe profesor titullar me korrespondencë, sipas kushteve dhe procedurave të përcaktuara me Ligjin për arsim sipëror. Kandidatët duhet të plotësojnë edhe kushtet e përgjithshme të përcaktuara me Ligjin për marrëdhënie pune dhe Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor dhe mësimor të Universitetit "Goce Dellçev" – Shtip.

- Kandidati i cili do të zgjidhet për mësimdhënës në Fakultetin e shkencave të medicinës (nga pika 1.1 deri në pikën 1.3) do të mbajë vendin e punës në institucionin shëndetësor ku është i punësuar, ndërsa në pajtim me marrëveshjen do të realizojë mësimdhënie në Universitetin "Goce Dellçev" – Shtip (neni 174 të Ligjit për arsim sipëror).

-Personave të cilët kanë themeluar marrëdhënie pune (deri më 15.05.2018) si docent, profesor me korrespondencë, asistent doktorant ose asistent i ri në ndonjërin prej universiteteve në Republikën e Maqedonisë, nuk do të aplikohen kushtet nën pikën 1 (për zgjedhje të profesorit me korrespondencë dhe profesorit të rregullt) gjatë zgjedhjes së tyre në titullin e njëjtë ose më të lartë mësimor-shkencor.

-Docenti dhe profesori me korrespondencë të fakultetit, gjegjësisht akademisë artistike zgjidhen gjatë kohës për pesë vjet (themelohet marrëdhënie pune për kohë të pacaktuar), ndërsa profesori i rregullt në fakultet, gjegjësisht në akademinë artistike me zgjedhjen themelohet marrëdhënie të punës për kohë të pacaktuar dhe e mban titullin profesor i rregullt deri në fund të jetës.

- Orari i kohës së punës dhe pagesa:

- Orari ditor i punës me fillim mes ora 7:30 dhe 08:30 dhe mbarim mes ora 15:30 dhe 16:30.

- Orari javor i punës – 40 orë punë (prej ditës së hënë deri në ditën e premte)

- Neto paga themelore për: Docent -38.143,00 den.; Profesor me korrespondencë - 43.660,00 den.; Profesor i rregullt -50.311,00 den; Docent titullar -700, 00 den/orë; Profesor titullar me korrespondencë - 800,00 den/orë;

Dokumentet e nevojshme për kandidatët për zgjedhje në titujt mësimor, mësimor – shkencor:

- fletëparaqitje;

- diplomë për arsim të mbaruar përkatës – për punim të mbrojtur të magistraturës/doktoraturës (një kopje të diplomës në origjinal dhe tre kopje të vërtetuara në noter; diplomat e huaja të jenë të nostrifikuara dhe të plotësuara me ekuivalencë të notave);

- certifikatë për provimet e dhëna të ciklit të parë dhe të dytë të studimeve

- biografi të shkurtër (në katër kopje);

- listë të punimeve të publikuara shkencore dhe profesionale

- nga një kopje të punimeve;

- vërtetim se një prej gjuhëve të huaja

- rekomandim prej së paku 2 (dy) profesorëve (me korrespondencë/ rregullt) nga sfera përkatëse shkencore për të cilin bëhet zgjedhja - për kandidatët për docent;

- rekomandim nga punëdhënësi paraparak (nëse kandidati ka qenë i punësuar) - për kandidatët për zgjedhje docent;

- një kopje të punimit të doktoratës;

- certifikatë të shtetësisë;

Konkursi zgjatë 8 ditë pune nga dita e publikimit.

Zgjedhja do të realizohet në afatin e paraparë në nenin 172 të Ligjit për arsim sipëror (deri në 6 muaj nga publikimi i konkursit).

Dokumentet të dorëzohen në arkivin e:

1. Fakulteti i shkencave të medicinës – Spitali Klinik Shtip rr. "Luben Ivanov" nr. 25 (Departamenti për pediatri); tel. 032-550-400;

2. Fakulteti filologjik – rr. "Zheleznička" pn, Shtip; tel. 032-550-180;

3. Fakulteti për turizëm dhe biznes logjistikë – rr. "7-mi Noemvri" pn, Gjevgjeli; tel. 032-550-350;

4. Fakulteti i shkencave arsimore - rr. "Krstê Misirkov" nr. 10A Shtip, tel. 032-550-500;



Konsumimi i cigareve plakë lëkurën

Tymi është shkak për zverdhjen e gishtave dhe thonjve, plakjes së lëkurës dhe rrudhave të rritura. Shumë duhanpirës kanë thonjtë dhe lëkurën që i rrethojnë me një ngjyrë të verdhë. Kjo është në përgjithësi për shkak të akumulimit të katanit dhe nikotinës në zonat e gishtave ku mbahet cigarja. Çdo herë që thithni një frymë nga një cigare enët e vogla të gjakut tkurren dhe zvogëlohet përqendrimi i oksigjenit në gjak. Kjo gjithashtu ka një efekt të drejtpërdrejtë në lëkurën e cila, e privuar nga oksigjeni, tenton të duket e shurdhër dhe e errët. Tymi gjithashtu shkakton lirim të radikaleve të lira në trup që pengojnë prodhimin e kolagenit dhe dëmtojnë proteinat që kontribuojnë në strukturën e lëkurës. Së bashku, këto dy fenomene favorizojnë plakjen e lëkurës me humbjen e elasticitetit, shfaqjen e njollave të lëkurës dhe formimin e rrudhave, veçanërisht në zonën rreth buzëve. Pirja e duhanit gjithashtu shkakton një rritje në hirsutism (ritjen e flokëve) të fytyrës.



Një përqafim ju bën të ndjeheni më mirë

Një përqafim me të vërtet mund t'ju bëjë të ndjeheni më mirë pas një përlëshje, është thënë në një studim të realizuar së fundmi. Mbatja e duarve gjithashtu mund të përmirësojë disponimin e një personi pas ndonjë konflikti, dhe ky efekt mund të zgjasë tërë ditën. Ekipi nga Universiteti Carnegie Mellon ka studiuar 400 persona dhe ka gjetur që ata të cilët janë përqafuar me personin që janë përlëshur kishin më pak ndjenja negative në ditën në vijim. Sipas tyre, ky studim sh-ton peshën e hulumtimeve paraprake që kanë treguar se prekja njerëzore ka një efekt qetësues në nerva.

Ibuprofeni po i bën meshkujt steril!

Një përdorim i tepruar dhe i gjatë i ibuprofenit, një prej ilaçeve kundër dhimbjes të përdorur gjerësisht nga të gjithë, mund t'i bëjë meshkujt steril. Është kjo ajo që ka zbuluar një ekip studiuesish danezë të Universitetit të Kopenhagen, pas një studimi të kryer. Më konkretisht ibuprofeni, shkakton një mbiprodhim të testosteronit, hormoni kryesor mashkullor, çka bën që testikujt të kenë vështirësi në funksionim dhe për rrjedhojë rrezikohet pjelloria.



Fatmirësisht bëhet fjalë për një gjendje të përkohshme, efektet negative të të cilit zhduken menjëherë pasi ndërpritet marrja

e ilaçit. Drejtuesi i studimit David Møbjerg Kristensen thotë se përdorimi i ibuprofenit për një kohë të gjatë mund të shkaktojë dëme

të parikuperueshme. Për të arritur në këtë përfundim u mbajtën në studim 31 meshkuj, me moshë nga 18 deri në 35 vjeç. 17 prej tyre iu dha një kokërr në gjashtë javë, 14 të tjerë doza maksimale e ibuprofenit ose thënë ndryshe 600 miligramë dy herë në ditë. U vu re se kush pinte rregullisht ibuprofen dhe për një kohë të gjatë, kishin probleme me pjellorinë. Në mënyrë më të detajuar detajet e studimit, u publikuan në revistën shkencore "PNAS".

KËSHTU NDIKOJNË PARATË NË MARRJEN E VENDIMEVE

Rezultatet treguan se njerëzit u bënë shumë të sigurt kur iu buzëqeshi shpërblimi. Për dallim nga kjo, nëse kërcënoheshin me humbje, vetëbesimi zvogëlohej. Paraja ka ndihmuar njerëzit të marrin vendime

Sipas një studimi të ri nga Universiteti i Amsterdimit, njerëzit që kanë shumë para janë shpesh të bindur se ata kanë të drejtë në çdo gjë dhe nuk duan të dëgjojnë këshillat e njerëzve të tjerë. Një shembull banal i një vetëbesimi të tillë është se shumë njerëz të famshëm janë të veshur shumë keq, pavarësisht faktit se ata mund të përballojnë rrobat e krijuara nga projektuesit më të famshëm të modës.

Shkencëtarët besojnë se kjo ndodh, pasi ndihen shumë të sigurt. Një sasi e madhe parash u jep atyre disa siguri, besim dhe për këtë arsye marrin vendime dhe vlerësime të rreme. Ata bëhen aq të sigurt për atë që nuk duan të dëgjojnë dikë që dëshiron të nxjerrë në pah gabimet e tyre.



Kjo lloj sjelljeje mund të kalojë përmes tepihut të kuq, por në fusha të tjera si spitalet apo institucionet financiare, mund të lindin probleme serioze. Shkencëtarët e udhëhequr nga dr. Mael Lebreton studiuan 104 të anketuar. Ata morën pjesë në testet vizuale me filtrat Gabor. Këta filtra mund të jenë monokromatikë ose me mostra. Ata përdoren shpesh në testet e perceptimit.

Në eksperiment, të anketuarit duhej të vendosnin se cila prej dy imazheve kishte një kontrast më të lartë. Në një shkallë prej 50% deri 100% treguan se sa të sigurt janë në vendimin e tyre. Atyre iu tha se do të fitonin ose humbnin paratë, varësisht se sa ishin të saktë. Ishte rreth dhjetë dollarë. Rezultatet treguan se njerëzit u bënë shumë të sigurt kur iu buzëqeshi shpërblimi. Për dallim nga

kjo, nëse kërcënoheshin me humbje, vetëbesimi zvogëlohej. Paraja ka ndihmuar njerëzit të marrin vendime.

Megjithatë, ata njerëz që ishin të sigurt për vendimin e tyre për para, u bënë edhe më të sigurt. Mundësia e shpërblimit monetar, sipas shkencëtarëve, mund të ndryshojë gjendjen psikologjike. Ndryshe, hulumtimi u botua në revistën 'Advances Science'.

Mjafton vetëm një minutë vrapim për shëndetin e mirë të kockave

Një hulumtim i fundit tregon se aktiviteti fizik i shkurtër dhe intensiv zvogëlon rrezikun e humbjes së kockave dhe se vetëm disa minuta vrapim mund të forcojnë kockat tuaja. Shkencëtarët britanikë kanë gjetur se gratë që janë të angazhuara në "aktivitet të shkurtër fizik" me intensitet të lartë, kanë një peshë më të lartë të kockave për 4% sesa ato më pak aktive. "Ende nuk e dimë nëse është më mirë të kryejmë një ushtrim të vogël gjatë gjithë ditës ose në një kohë dhe nëse ushtrimet më të gjata gjatë javës janë po aq të mira sa edhe ato që bëhen një ose dy minuta në ditë", tha autorja



e studimit Victoria Stiles, ligjëruese e Lartë për Sport dhe Shëndetësi në Universitetin Exeter.

Studiuesit krahasuan të dhënat me më shumë se 2.500 gra.

Gjatë studimit, u analizua nëse intensitetet e shkurtra të intensitetit të lartë janë më të dobishme për shëndetin e kockave sesa për aktivitetet e gjata dhe të vazhduesh-

me. Duke vepruar kështu, aktivitetet e zakonshme të shkurtra gjatë ditës u injoruan. Gratë që kanë ushtruar intensivisht më shumë se dy minuta çdo ditë kanë shëndet më të mirë të kockave 6 për qind.

Meqenëse ajo është e bazuar në një grup të caktuar të grave në një pikë të caktuar, është e paqartë nëse aktiviteti fizik i fortë ka përmirësuar shëndetin e kockave te gratë me kocka më të forta që ushtrorjnë më shumë. Pavarësisht nga çdo gjë, të paktën një deri në dy minuta stërvitje në ditë ose vrapim intensiv është i mirë për shëndetin e kockave.

DASHI 21. mars - 20. prill
Dashuria: Sot, lidhjet e rëndësishme janë në fokus të tensioneve. Venusi është neutral dhe prandaj nuk ka dashuri të re, por yjet janë në favor të atyre që tashmë janë në një lidhje të konsoliduar. Beqarët do të duhet të përpqen për të pushuar pas një sezoni mjaft të zënë me takime. Puna: Është i mundur një transferim për ata që kanë një punë në lëvizje, sukseset do të vijnë shpejt, ju duhet të dini si t'i prisni.

DEMI 21. prill - 21. maj
Dashuria: Çiftet së bashku për një kohë të gjatë mund të kenë disa probleme komunikimi. Nëse dikush është tallur me ju, mund të mendoni edhe të largoheni. Dita premtuese për beqarët, parashikohen takime të reja. Puna: Saturni do t'ju japë një pasuri të madhe, edhe nëse nuk është një periudhë në të cilën gjithçka shkon me të vërtetë mirë.

BINJAKET 22. maj - 21. qershor
Dashuria: Dielli i favorshëm do t'ju japë më të mirën. Ju do të jeni ambicioz dhe të pasionuar dhe do arrini të merrni nga partneri/ja ato që do kërkonte. Aventurat nuk do të mungojnë as për ata që janë vetëm. Puna: Në punë do të bëheni revolucionarë, do ta përmbysni metodën që keni adoptuar me vite dhe do të rizbuloni një pasion.

GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik
Dashuria: Dashuria nuk do të jetë protagoniste, sot do të ketë shumë angazhime që sjellin ndryshime, çiftet e konsoliduara mund të mendojnë edhe për një fëmijë. Lajme të për zemrat e vetmuara, sot mijëra rrugë hapen para jush, qielli ju favorizon. Puna: Ekonomia e shkëlqyeshme, ju do të jeni të ashpër në punë dhe në çdo industri atmosferë do të jetë e këndshme.

LUANI 23. korrik - 22. gusht
Dashuria: Dashuria po lulëzon, vendosni se çfarë doni nga jeta juaj. Kush është në çift është duke jetuar një moment të paharrueshëm! Beqarët do të jenë në gjendje të rishikojnë një vendim për të cilin ata nuk ishin të bindur. Puna: Ju jeni duke u përpjekur për një projekt që po kryeni, ndoshta do të duhet të ndryshoni rrjedhën.

VIRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator
Dashuria: Nuk do të jetë një ditë e lehtë, Venusi dhe Marsi nuk do t'ju japin paqen që ju bën të ndiheni mirë në jetën tuaj si çift. Ju shpesh do të jeni shumë konfrontues! Edhe beqarët do të fillojnë të tregojnë shenja të padurimit në takime. Puna: Kontaktet me figurat autoritare shpallin një periudhë të favorshme për tregtinë. Biznesi gjithashtu është i favorizuar.

PESHORJA 24. shtator - 23. tetor
Dashuria: Dielli dhe Marsi favorizojnë histori të reja me ngjyra të ndezura. Për shumë prej jush zemra fillon të rrahë përsëri dhe do të jetë momenti i duhur! Beqarët do të shohin shfaqjen e historive të forta dhe të qëndrueshme, të cilat paralajmërojnë ndryshime rrënjësore. Puna: Çdo vështirësi me të cilën jeni përballur deri tani do kalojë, ka ardhur koha për të ngritur dollin e suksesit.

AKREPI 24. tetor - 22. nëntor
Dashuria: Saturni sjell ashpërsi por edhe një dozë të mirë të drejtësisë. Filloni të vendosni rendin në jetën tuaj dhe të eliminoni historitë që janë vetëm një pengesë në këmbët tuaja. Beqarët do të duhet të shmangin ato miqësi që nuk bëjnë asgjë, por vetëm kritikojnë dhe kritikojnë... Puna: Plutoni dhe Jupiteri do të punojnë së bashku për të promovuar idetë e shkëlqyera që do të vijnë, në të vërtetë ata do të jenë vendimtarë dhe të vendosur.

SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor
Dashuria: Dita zbulon një vëmendje të veçantë në fushën e dashurisë, e cila do të mbajë vargjet e disponimit tuaj. Partneri/ja do t'ju mbajë me kënaqësi në krye! Beqarët do të jenë në gjendje për të thelluar disa miqësi që janë me vlerë. Puna: Urani do të vendosë shkopinj nën rrota, por ju nuk duhet të ndaleni duke luftuar.

BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar
Dashuria: Dashuria është e luhatshme, do të ketë probleme te çiftet e martuara, duhet të jenë të kujdesshëm për t'i zgjidhur ato, përndryshe marrëdhënia do të ketë tendencë të konsumohet me kalimin e kohës. Beqarët do të shtyen nga Jupiteri të mos heqin dorë deri sa të arrijnë qëllimet e tyre. Puna: Ju do të filloni javën me hënën e shtrëmbëruar, Plutoni dhe Saturnin, por ato do t'ju bëjnë luftues dhe gati për për të mbështetur idetë tuaja.

UJORI 21. janar - 19. shkurt
Dashuria: Një emarrëdhënie romantike mund të prishet nga kundërshtimi i Marsit. Një vendim i papritur mund të ndodhë, nuk do të jetë drastik. Nëse jeni vetëm, disponimi nuk do të jetë i favorshëm për aventurat, por dikush mund t'ju bindë... Puna: Hëna do të favorizojë projekte, energjia mendore nuk do t'ju dështojë, do ta përqendroni vëmendjen tuaj në sektorin praktik dhe profesional.

PESHQIT 20. shkurt - 20. mars
Dashuria: Në dashuri ju do të jeni të pavendosur. Dikush mund të vendosë të marrë një hap prapa në lidhjet sentimentale. Beqarët do të ketë ndjenjën e të qënurit në një qiell të zbehur, r takime. Puna: Në punë ju do të lehtësoheni nga një atmosferë e veçantë që do t'ju bëjë kreativë dhe të shkëlqyer.

Mensur Mamuti	LUMË I MADH NË EVROPE	D	FILOZOFI GJERMAN, JOHAN KËNGËTARJA NIMANI	D	BASTARDIM
HALL I MADH, FATKEQESI (BISED.)	QYTETI I LINDJES SË FUTBOLLISTIT NË FOTO				
PARAARDHËS TË ENAKTIVEVE (BIBLA)					
HËNOR					
NDRIT, NDRIÇOJ					
ENVER IDRIZI			TORONTO NJË NGA KLUBET E FUTBOLLISTIT NË FOTO		
AZOTI	RADIO INFORMATION SERVICE KËNGËTARJA JPONEZE, JOKO				
ISH VRAPUESI NGLËZ, SEBASTIAN				JODI SHKRONJË GREKE	
KRYENEQËSI (SH. PASHQ.)					
PJESËMARRJET NË FILM					MBRETËRËSHA E ILIRISË
HIDROGJENI	ITRIUMI STINAT E FTOHTA			LLOJ ËMBËLSIRE (SH.) SHITËT NË AZINË JUGLINDORE	BOKSIERI KUBANEZ, LUIS SPECIALIST I SEMUNDJEVE TË TUMOREVE
ELVIRA DONES			QYTET NË AUSTRI		0
KLUMË I MADH NË AFRIKË			AKTORI AMERIKAN, NILSEN		USHQEN
KOHA	FUTBOLLISTI TURKO-GJERMAN NË FOTO DASHURI, AFSH				BRITMË FETARE JUDAISTE
NJË NGA KLUBET E FUTBOLLISTIT NË FOTO					DY (ANG.) MOLIBDENI
NJË NGA KLUBET E FUTBOLLISTIT NË FOTO					NJËSI E REZISTENCËS ELEKTRIKE
FSHAT NË STRUGË					XHULI METRI
0					RROTA PREJ LASTIKU



NE KETE DATE

ZGJIDHJET: D, D, GAZER, ENAKË, LUNAR, ZBARDH, EI, TO, N, RIS, KOE, J, INATE, ROLET, O, H, IT, TORTA, ED, ABENTAL, NIL, RUKIJE, MESUT OZIL, ARSENAL, TU, SHAKKE, OM, J, OKTISI, GOMA

Shumë i lehtë **Sudoku** mesatar

6		1			2					8	5				2	9	
					6	9	5		9				8				5
		8	3					6		4		5				8	
4								3	8			6	3				
8					4	6	9		7					6			2
		2			7										1	4	
2				7				4	5		3		1			4	
				5						5				3			8
			5			3					1	7				3	2

Shumë i lehtë: 691352487, 742816953, 583479261, 419265738, 857134692, 326987514, 268793145, 934521876, 175648329. Mesatar: 685713294, 973482615, 142596783, 496327851, 751864932, 328951467, 239178546, 564239178, 817645329.

Gratë do bëjnë fëmijë pa pasur nevojë për meshkujt!



Ekspertët e fertilitetit në Australi theksuan se brenda dy dekadave femrat do mund të bëjnë fëmijë pa pasur nevojë për meshkujt. Doktor David Molloy tha se nuk do të ketë më nevojë për kontributin

e meshkujve në të ardhmen, falë avancimeve në teknologjinë e fertilitetit. Deklarata e tij vjen pas suksesit në Kinë, ku minjtë lindën nga dy nëna. Ai shton se një sukses i tillë mund të arrihet edhe në

riprodhimin njerëzor. Aktualisht në Australi një eksperiment i tillë të njerëzit kundërshtohet, por doktor Molloy shprehet se qëndrimet do të ndryshojnë me kalimin e kohës.



Transgjinatori futet në burg femrash dhe nis sulmet seksuale!

Një i dënuar transgjinator ka sulmuar seksualisht dy të dënuara të tjera, ndërkohë që ishte në pritje të ndërhyrjes kirurgjikale që do ta bënte femër. Ai gjendej në një qeli femrash për disa vepra penale. Karen White kishte kryer disa sulme seksuale, por kur ishte identifikuar si femër, autoritetet e futën në burg grash. Ndërkohë që ishte aty, sulmoi edhe dy gra të tjera. White, tani që është transferuar në një burg meshkujsh dhe ka për të kryer edhe 9.5 vite të tjera burg. Gjykata e përcaktoi 52-vjeçarin si një njeri të rrezikshëm për femra dhe fëmijë, pasi ka pasur precedentë të ngjashëm penalë edhe më herët. Fushata e sulmeve ka nisur që kur ai ishte i njohur si Stephen Wood dhe jetonte në Manchester.

Nuk është e qartë nëse gjykata do ta lërë tashmë në një burg femrash apo meshkujsh, por ai duhet të bëjë edhe 9.5 vite burg përpara se të fitojë lirinë.



Mbron me shpinë vajzën, breshëri i shkakton plagë serioze

Një nënë ka mbetur e mbuluar me plagë dhe gërvishje pas përpljekjeve për të mbrojtur vajzën e saj të vogël, kur ato ishin kapur në befasi nga një tornado i rrezikshëm.

Stuhia masive ndodhi në juglindje të Queensland, duke sjellë rënie të breshrit të një madhësi e sa topi i tenisit. Banorët e Tansey, një qytet i vogël 250 km në veri të Brisbanit, u zgjuan të premtën nga stuhia e frikshme, e cila shkatërroi shtëpitë dhe fer-

mat. Fiona Simpson po shëtiste me gjyshen dhe foshnjën e saj gjatë stuhisë, kur copëzat e akullit ranë mbi trupin e tyre. Gruaja ka pësuar prerje në fytyrë dhe shpinë, ndërkohë që vajza e saj e vogël është goditur nga një kokërr e madhe breshëri në kokë, pavarësisht përpljekjeve të dëshpëruara të nënës për të mbrojtur fëmijën me trupin e saj. Gruaja i ka postuar fotot në Facebook duke shkruar: "Mësova se kurrë nuk do të shëtis apo drejtoj makinën në kohë të keqe".



Telefoni i palosshëm i Samsungut, tablet që mund të futet në xhep

Njëri prej shefave të Samsungut, DJ Koh ka treguar detaje për telefonin e palosshëm që pritet të lansohet nga kompania që ai drejton. Ai ka thënë se telefoni i palosshëm do të jetë një tablet që mund të futet në xhep nga përdoruesit

edhe pse pritet të ketë ekran të madh. "Kur të lansojmë telefonin e palosshëm, do t'i hyjë në punë përdoruesve tanë", ka thënë ai. Pajisja e palosshme pritet të lansohet në muajin nëntor, por nuk pritet të dalë në shitje deri më 2019.



1522 - Perandori Karli I emëron Hernan Cortes guvernator të Meksikos.

1582 - Shumë shtete të krishtera kalojnë në kalendarin gregorian, lëvizin 10 ditë.

1655 - Hebrenjtë e Lublinit masakrohen.

1756 - Ushtria saksone i dorëzohet Prusisë.

1789 - Turi i parë presidencial i Xhorxh Uashingtonit në New England.

1815 - Ekzili i Napoleon Bonapartës në Ishullin Shën Elena.

1878 - Inkorporohet Kompania e dritës elektrike Edison.

1880 - Përfundon ndërtimi i Katedrales së Kelnit, 663 pas fillimit të saj.

1914 - Fillon Beteja e Varshavës.

1948 - Ushtria e Kuqe kineze okupon Çinkovën.

1958 - Tunizia ndërpret marrëdhëniet diplomatike me Egjiptin.

1970 - Anwar Sadat zgjidhet president i Egjiptit.

1990 - Presidenti sovjetik Mikhail Gorbachev fiton Çmimin Nobel për Paqe.

KALENDARI HISTORIK 15 TETOR

KRIJIMI I TRËNDAFILAVE BLU

Të ndërhysh në ADN-në e luleve duke bërë modifikime sipas shijes estetike të njerëzve, është sfida e re florikulturës moderne. Kështu është krijuar trëndafili i parë blu, i cili këtë ngjyrë e mori nga dy baktere që ju injektuan nga kërkuesit kinezë. Sipas simbologjisë bashkëkohore, trëndafili blu përfaqëson të paarritshmen, ëndrrën e pamundur dhe kjo është një nga arsytet që në tregun botëror është shumë i kërkuar. Por në natyrë nuk ekziston, dhe trëndafilat blu që gjejmë në dyqanet e luleve në fakt janë të bardhë, të cilët janë spërkatur me ngjyruer blu. Por sot falë bioteknologjisë duket se kjo lule më në fund mund të përfitohet, me anë të injektimit të disa enzimave bakteriale në petale



PLAKU DHE TAKSISTI

Njëherë, një plak i cili i kishte dy valixhe të rënda në dorë, shkon e pyet një taksist se sa kushtonte për ta dërguar atë deri në vendin e caktuar!
- 10 euro - i thotë taksisti.
- Po valixhet?! - pyet plakun
- Valixhet janë pa pagesë - përgjigjet taksisti.
- Mirë, merri t'i valixhet se unë vij në këmbë! - ia kthen plakun!



Jeta është ajo që të ndodh përdërisa je i zënë duke bërë plane tjera.

(John Lennon)

A E DINI SE...

BARSOLETA

THËNIA E DITËS